“TEK ZOTI PASH VENDIN TIM” - Dhimitër Kamarda

Besimi dhe Atdeu, ka qënë zanafilla e lëvizjes më të fuqishme ideore dhe kulturore e elitës shqiptare të shekullit 17-19, që në historinë botërore njihet me emrin e përgjithshëm RILINDJE. Ajo që e bashkonte lëvizjen shqiptare me atë europiane ishte fakti se:

- Frymëzuesit dhe veprimtarët e saj, kanë qënë nga rradha e figurave të shquara intelektuale.

- Synimi për të zbuluar dhe mbledhur pasurinë e traditës (folklorike-besimtare) dhe historike të Kombit shqiptar, e cila do të dëshmonte karakterin e ndryshëm etnik me popujt e tjerë dhe origjinën e lashtë.

- Përkushtimi ndaj çështjes kombëtare.

Por, kjo lëvizje kulturore në fillim, dhe çlirimtare më vonë (shk19-20), tek shqiptaro-arbërit kishte shumë dallime nga lëvizja europiane, si për shkaqet e lindjes, ashtu edhe rugën e ndjekur dhe autorët kryesor të saj. Një prej këtyre dallimeve ka qënë fakti, se zuri fill në shk17 në «shtëpinë e Zotit» në gjirin e eruditëve kishtar, jashtë trullit të saj natyror, e pafinancuar dmth vullnetare dhe shkaku, ishte i natyrës fetare. Siç dihet mbas vdekjes së Skënderbeut (1467) dhe pushtimit Osman, së bashku me familjet shqiptare, u larguan drejt Gadishullit italik edhe përfaqësuesit e besimit të krishterë lindor të shqiptarëve. Përveç vështirësive që gjetën në tokën e Papatit katolik për pranimin dhe ushtrimin e riteve të besimit të tyre ortodoks bizantin, një problem i madh shpirtëror ishte trajtimi i tyre, si etni dhe besimtar të Kishës Greke. U pa e domosdoshme të dëshmohej në «atdheun e dytë» karakteristikat etnike dhe Historia e vërtetë e Kombit shqiptar. At Nikoll Keta ju mësonte nxënësve të tij se: «Studimi i historisë së paraardhësve, buronte nga një kureshtje e ligjshme vetjake, si kërkesë e vetë natyrës njerëzore, meqënëse ky veprim ishte shprehje e vullnetit dhe dashurisë Hyjnore».

Siç pohon studiuesi Matteo Mandala, At Gjergj Guxeta dhe veçanrisht bashkëpunatori i tij, At Pal M. Parrino e kuptuan se për të treguar dallimin midis besimeve të etnisë greke dhe asaj arbërore (shqiptare), do të ishte më e frytshme të rindërtohej identiteti historik, kulturor dhe besimtar i shqiptarëve, se sa ajo e debateve shtërpe teologjike. Të dëshmohej origjina dmth se shqiptarët formojnë një etni autoktone që zë një trevë të caktuar ballkanike, duke zhvilluar një qytetrim dhe kulturë të veten, si besimtare dhe shoqërore, që flisnin një gjuhë të ndryshme nga ajo e popujve fqinj, me të cilët nuk i bashkonte asnjë tipar i përbashkët (...) Për këtë qëllim, përveç filozofisë dhe teologjisë duhej të përfshihesh edhe historia (...) Vetëm në këtë mënyrë bëhej e mundur të hidheshin poshtë shpifjet «dhe të korrigjohesh gabimi i madh popullor që i njësonte Shqiptarët me Grekët». Kjo ishte edhe arsëya, shkruante At V.Dorsa, që më detyroi t'i rikthehem të famshmes Lashtësi, (...) për ta ndarë historinë e grekëve, nga historia e popujve (...) që nga autorët e lashtë përcaktohen Pellazgë, Epirotë, Maqedonëe nganjëherë lliër dhe nga autorët modernë, Kombi Shqiptar.

Do të përqëndrohem tek përfaqësuesit e rritit ortodoks bizantin, (pa mohuar kontributin edhe të etërve të besimeve të tjera) për faktin se puna e tyre shkencore formoi SHKOLLEN E PARË të studimeve Albanologjike, pothuaj në të njëjtën kohë me ato europiane. Përpjekjet e Gj.Guxetës, P.M.Parrinit, V.Dorsës dhe Xh.Krispit, në krahasimin e gjuhës shqipe me greqishten, latinishten dhe gjuhët e tjera të lashta, ishin disa dhjetvjeçar më të hershme se ato të gjermanit Franz Bopp (1791-1867) («Das Albanesische in seinen Verwandtschaftlichen Beziehungen», 1855) themeluesit të gjuhësisë krahasuese nga lindi edhe shkencë e gjuhësisë. Duhet theksuar se studiuesit e huaj për t'u njohur me gjuhën shqipe, rruga e parë që shkelën ishte ajo drejt «burimit» arbëresh në Itali, ku u njohën me shkrimet mbi folklorin dhe traditat zakonore, të mbledhura nga etërit fetar dhe intelektualët. Kështu psh monografia e parë për gjuhën shqipe e Conrad Malte-Brun (1775 – 1826) tek Gjeografia Universale (L.119) ka të përfshirë studimin e priftit Angelo Masci, «Mbi origjinën dhe zakonet e Shqiptarëve» shtypur në Napoli më 1807. (4)Gjithashtu, shumë studiues janë mbështetur tek veprat e De Radës si: Hyjni pellazge (1840), Identiteti i pellazgëve me shqiptarët (1846), Lashtësia e kombit shqiptar dhe afri e tij me helenët dhe latinët (1864), Pellazgët dhe helenët (1885), Konferenca mbi lashtësinë e gjuhës shqipe (1893), Pellazgo-shqiptarët (1897), Tiparet e

gjuhës shqipe dhe përmendoret e saj në periudhën parahistorike (1899), të panjohura edhe sot nga lexuesit shqip-folës.

Studiuesit e huaj si Niebhur, Gioberti gjuhëtarët e njohur Max-Müller, Schleicher, Curtins, Benlow dhe Graziadio Isaia Ascoli (1829-1907) pohon At Dhimitër Kamarda që kishin shkruar për origjinën e popullit dhe gjuhës së shqiptarëve «por, asnjëri prej tyre nuk e trajtoi me thellesi, punë që në të vërtetë ishte bërë më përpara, sidomos për sa i përket emrave nga Z.Krispi dhe V.Dorsa. Të huajt që merreshin me temën shqipëtare, e kuptonin rëndësinë e madhe të njohurive që studiuesit arbëresh kishin mbi gjuhën, historinë dhe traditat e tyre. Kjo i shtynte t'u bënin hirje «që në ndihmë të shkencës, ata duhet të afroheshin për të zhvilluar një bashkëbisedim të hapur mbi natyrën e gjuhës së tyre». (Pr Domenico Comparetti «Notizie ed osservazioni in proposito degli Studii Critici del Pr. Ascoli (estratto dalla Revista Italiana n. 126, 134,140, 1863) Pisa1865).

Gjuhëtarët arbëresh me veprat e tyre të shkruara në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht, dhanë ndihmesën e tyre gjuhëtarëve të huaj në përcaktimin e gjuhës shqipe si pjesë e familjes indo-europianë. Pra «Shkolla Albanologjike» e arbëreshve, jo si një Institucion arsimor, por si një veprimtari e bashkuar e një elite autodidakte, kishte kohë që e kishte nisur rrugëtimin e saj. Në rradhët e kësaj shkolle rënditen shumë eruditë priftërinj arbëresh të shekullit 17-19, si Nilo Katalano (1637-1694), Josif Nikollë Brankati (1675 – 1741), Gjergj Guxeta (Giorgio Guzzetta 1682–1756), Pal M. Parrino (Paolo Maria Parrino 1710 – 1765), Jul Variboba (1727 – 1788), Nikolla Keta (1741 – 1803), Ëngjëll Mashi (1758 – 1821), Mikel Skutari (1762 – 1830), Zef Krispi (1781-1859), Vinçenco Dorsa (1823-1885), Zef Skiroi (1865 – 1927)etj.

Në këtë shkrim, do të trajtoj disa teza të rëndësishme, gjuhësore dhe historikë, të dy veprave të At Dhimitër Kamardës (1821-1882), «Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese», (Livorno 1864) ; «Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese»,(Livorno, 1866) duke ju bashkangjitur edhe mendimet e pararendësve, bashkohëse të tij dhe studiuesve të më vonshëm, të cilat (tezat) janë vënë në dyshim apo nuk janë shtruar fare nga Albanologjia e shk21. Gjuhëtarit gjerman Gustav Meyer (1850-1900) shkruante («Etymologische Wörterbuch der albanesischen Sprache» Strassburg, 1891) se, emri i Dh.Kamardës, meriton të kujtohet dhe të vlerohet në historinë e shkencës (gjuhësisë historike) sepse «për herë të parë» në veprën e tij (Saggio di Grammatologia ...) është bërë «një trajtim i plotë krahasues i gjuhës shqipe».

I shpreh mirnjohjen time Bibliotekës së ShBA, e cila e ruante librin e gjuhëtarit të famshëm arbëresh, «Saggio di Grammatologia comparata sulla lingua Albanese» (ribotim i vitit 1923) në koleksionin e veprave të rëndësishme të kulturës botërore dhe me ndërmjës të librarisë Amazon në Itali, u bë e mundur ta kisha në dorë. Vepra tjetër «Apendice...»(1866), që në fakt është një shtesë e së parës, është shfrytëzuar nga Interneti.

TEZA E PARË: SA ËSHTË MOSHA E GJUHËS SHQIPE?

Siç na dëshmon Herodoti, mbreti Psametiku (Egjipt) për të njohur se kush popull është më i vjetri, vendosi të mësojë se cilën fjalë të parë do ta shqiptonin dy fëmijët e ritur nga dy gra që ju ishte prerë gjuha. Cilët popull do t'i përkiste fjala, ay do të pranohej si më i lashti. Ky tregim duhet të ketë qënë një prove e vërtetë historike, sepse na ka ardhur deri në kohët tona fjala e parë që shqiptuan fëmijët «bek», që e kishin dëgjur nga udhëtarët e një karvani të ndalur pranë banesës së tyre. Nga kërkimet e njerzve të mbretit midis gjuhëve të asaj kohe, doli se në folurën e fiseve frigjiane kjo fjalë përcaktonte bukën. Pamvarsisht vendimit të shpallur nga mbreti, na intereson fakti se këtë fjalë e ruan edhe sot, vetëm gjuha shqipe: «buk». Pra shumë kohë para Herodotit, lashtësia e popujve shikohej në vartësi të lashtësisë së gjuhës që flisnin. Deri sa gjuha shqipe do të merrte denjësisht, në shekullin e 19, kurorën e GJUHËS SË PARË, «Shkollës albanologjike arbëreshë» ju desh një rrugë e gjatë kërkimesh, sa gjuhësore aq edhe historike, folklorike dhe fetare.

Pothuaj një shekull para se Kamarda t'i futej kësaj pune, ishin rrahur mendime të ndryshme për zbulimin e lashtësisë dhe origjinës së gjuhës shqipe. Nisur nga pohimi i autorit të parë të Historisë së Skënderbeut,



Marin Barletit (1450-1513) se gjuha shqipe rridhte nga latinishtja, Gjergj Guxeta mendonte se ajo duhet të ishte një përzierje e latinishtes dhe gjuhës së vjetër maqedonase. Ndërkohë bashkëpunatori i tij P. Parrino, mbronte idenë se gjuha shqipe, sidomos ajo e arbëreshve të Italisë, ishte e njëjtë me gjuhën maqedone (të lashtë-shën im). Por që të gjithë mohonin ndonjë afërsi apo lidhje me gjuhën greke.

Në vijim të bindjes së albanologëve nismëtarë G.Guxetës, P.M.Parrinos, edhe V.Dorsa pohon se Shqiptarët çfaqen qartësisht me një origjinë, përkatësi dhe lidhje shpirtërore të përbashkët duke formuar kështu një familje, ku gjuha e zakonet, i dallojnë qartësisht nga grekët. Pra rruga e vetme për të dëshmuar lashtësinë e gjuhës shqipe dhe rrjedhimisht e Kombit që e fliste atë, mbetej të vërtetohej lidhja apo trashëgimia e saj me gjuhën e maqedonëve të lashtë. Por siç dihet, nga kjo gjuhë nuk ka mbetur ndonjë dokument i shkruar me maqedonishten e Aleksandrit të Madh. Lindi kështu nevoja të krahasohej gjuha shqipe me një gjuhë tjetër të lashtë, nga e cila kishin mbritur vepra të shkruara. Me qënëse në rrethet filologjike europiane të shk 18-19, greqishtja mbajej më e lashtë se latinishtja, priftërinjtë eruditë arbëresh, si zotërues të saj dhe profesorë të kësaj gjuhe në shkollat fetare dhe Universitetet e kohës, ju futën punës për krahasimin leksikor dhe gramatikor të shqipes me të. Sipas Dh.Kamardës, gjatë krahasimit u vërejt se «shqipja përmban shumë elemente nga më të lashtat e të folurës greke, të cilave ne as nuk ua dimë shqiptimin e vërtetë (...) dhe kjo më shtyn të pranoj, lidhjen e shqipes me sanskritishten, te pothuar nga Franz Bopp».

Pothuaj 30 vjet para Kamardës, Z.Krispi i habitur, kish pohuar se «duke gjurmuar origjinën e gjuhës greke, është një gjë e bukur të shohësh se si ajo të kthen, në pjesën e saj më të madhe, tek gjuha shqipe» duke hedhur i pari idenë se ajo «mbase është më e lashtë se greqishtja dhe në thelb, gjuha me të cilën flitej në shekujt para Homerit» (Malte-Brun libr.199, f243) (12) Kjo teza do të trajtohet në fund të shk19 nga Sami Frashëri: «Ka shumë fjalë që vërtetojnë se format e tyre shqipe janë bazë, ndërsa format në gjuhët e vjetra greke e latine janë derivate të tyre. Kjo tregon se gjuha shqipe është më e vjetër se greqishtja ose latinishtja e moçme dhe se populli shqiptar është shumë i vjetër. (13) At Dh. Kamarda pohon se « shumë fjalë shqipe, përputhen me ato të gjuhës së lashtë të grekëve » duke shtuar se ato « janë unaza, (te ndërmjetme lidhëse-shën im)midis gjuhës së lashtë aziatike (sanskritishtes) me gjuhën e re hellene, asaj gjuhe të humbur, nga buroi gjuha e klasikëve grekë e mbritur tek ne, përmes librave të tyre të pavdekshëm».

Duket sikur këto përfundime hedhin poshtë studimet e gjuhëtarëve nismëtar, që u shprehën për dallimin rrënjësor midis këtyre dy popujve kufitarë ballkanikë të shekullit 19. Por duhet të kemi parasysh, se si lëndë studimi, nga gjuhëtarët u mor fjalori i greqishtes së lashtë i shkruarve të parë dhe, siç shprehej francezi Robert De Angely, «Po të mos kishin qënë shkronjat e njëjta (të greqishtes së lashtë) dhe asaj të shk19-shën. im), pashmangërisht do të ishte deklaruar se gjëndemi para dy gjuhëve të ndryshme» (15) Mjafton të shkruajmë një listë të vogël fjalësh shqipe, greke dhe hellene të lashta dhe nga krahasimi i tyre i drejtpërdrejt, vërtetohet se shqipja është krejtësisht e njëjtë me greqishten homerike, gjë që nuk ndodh me greqishten e re, do të shkruante më vonë studiuesi i miteve pellazge, arvanitasi Aristidh Kola.

Merita e Kamardës në studimin e gjuhës shqipe ishte edhe fakti se shfrytëzoi arrijtë e shkencës së porsa-lindur në Europë, Fonologjisë (Studimi i tingujve të gjuhës). Duke përdorur metodën krahasuese me gjuhët europiane, ai pohon se gjuha shqipe është shumë e pasur në tinguj dhe «përmban jo vetëm të gjithë tingujt e greqishtes dhe latinishtes, siç shqiptohen sot në Greqi dhe Itali, por do të

shtojmë edhe të frëngjishtes e gjermanishtes».

Në shekullin e 18 etërit arbëresh si P.Parrino e sidomos Nikoll Keta («Tesoro di notizie su de' Macedoni»1777), duke shfrytëzuar të dhënat historike mbi fiset e lashta shqiptare dhe maqedonase të shumë autorëve, të lashtë dhe modern, hebreg, egjiptian, grekë, latinë, italianë, francezë, metodë që Eqerem Çabej do ta quante «moderne dhe globale, e cila edhe sot është thellësisht e drejtë», aritën në përfundimin se gjuha maqedone e lashtë dhe ajo shqipe, i përkisnin trugut gjuhësor «feniko-pellazg». Duke ndjekur gjurmët e At V.Dorsës i cili pohonte se gjuha shqipe ishte «e thjeshtë, shprehëse, imituese dhe poetike, cilësi që nevoiten për të vërtetuar origjinën e saj të lashtë» dhe të At Z.Krispit: «Se tingujt, në gjuhën shqipe, duke qënë të shumtë dhe të papërcaktuar, na qartësojnë natyrën origjinale të saj, siç është pa dyshim, vetë gjuha që Zoti i dha njeriut të parë», Dh.Kamarda i kushtoi një rëndësi të veçantë vetë formimi të fjalëve të saj.

Gjuha shqipe, vëren autori, është e varfër me fjalë të përbëra (nga bashkimi i dy fjalë me kuptim të plotë si dhe më parashtesa e mbrapashtesa -shën im) me të cilat është e pasur greqishtja dhe gjermanishtja . Në gjuhën shqipe, si emrat edhe foljet ndodhen me shumicë në gjëndjen e rrënjëve të pastra. Këto fjalë/rrënja (të përbëra vetëm nga dy/tre gjërma si : ha, pi, ri, shi, re, vë, di, pa/me pa, mal, gur, lis, etj-shën im) janë trashëguar nga gjuha-mëmë. Kamarda e përcaktonte si një formë zanafilore e krijimit të fjalëve, si tek çdo gjuhë tjetër, por e mbetur deri më sot tek shqip-folësit nga «mungesa e kulturës», ku nenkuptonte mungesën e arsimimit dhe shkrimit të librave. Studiuesi arbëresh do të mbetej i habitur, sikur të shikonte se edhe pas tre shekujve, në kohën e internetit, ne fjalorin e shqiptareve fjalët/rrënja para-historike janë në përdorim të pandryshuara, dhe padyshim ky fakt ka shpjegimin e vet. Intuita prej shkencëtarit, e shtynte të parashikonte se në formën një rrokëshe të fjalëve «fshihet» kyçi i lashtësisë së gjuhës shqipe dhe «studimi i tyre kërkon një vëmendje të veçantë». Koha tregoi se kishte të drejtë.

Njohësi i veprës së Dh.Kamardës, francezi Eduard Shmaider (Pellazget dhe pasardhësit e tyre) mbasi bëri një përflorantje të fjalëve-rrënja, pohon se «gjuha shqipe ka 785 të tilla, që e tejkalon tepër shumë e fjalëve rrënja të të gjithë gjuhëve të tjera, të vdekura dhe të gjalla. Dhe ky numër nuk është përfundimtar (...) Me 75 tinguj zanore, dhe 31 bashtingllore të forta dhe 785 fjalë-rrënja, një gjuhë mund të arrijë në një shkallë përsosmërije të paparë». Përfaqësuesi i madh i «Shkollës Albanologjike arbëreshë» Jeronim De Rada (1814 – 1903), do të shprehej: «Gjuha Shqipe, në analizë të fundit është ajo Gjuhë e Parë (Lingua Primeva) ose Mëmë (Muttersprache) ose së paku e afërmya e saj e ngushtë e më përfaqësuese, nga copëzimi i së cilës, si Ai (Zoti-shën im) në Sakrificën e Madhe Kozmogonike të një Gjuhë Hyjnore, të gjitha gjuhët e tjera erdhën e u ndërtuan mënjanë».

Kamarda na sjell edhe mendimet e figuravë të shquara europiane, që janë shprehur mbi lashtësinë e gjuhës sonë si Theodor Stier i cili pohon se kohën e origjinës së gjuhës shqipe, duhet ta vendosim, në periudhën kur nuk flitej as greqishtja, qoftë moderne apo antike, as latinishtja, as ndonjë nga të folurat që njohim sot apo që janë zhdukur. Ndërsa figura më e rëndësishme e Rilindjes italiane Vincenzo Gioberti (1801 –1852) në librin e tij «Primato» (Bruselles1844, T.II p.133), këmbëngul se gjuha shqipe, përmban gjurmë të gjuhëve që kanë qarkulluar në Greqi para pushtimeve deukaliane dmth para se të formohej popullsia e emërtuar Ellenike.

Sot, studimet mbi origjinën dhe lashtësinë e gjuhës shqipe e kanë tejkaluar shumë nivelin e studimeve europiane. Studiuesi Petro Zhei, duke shfrytëzuar ligjet e fizikës moderne, shkrimet fetare, fondin dialektor e historik të fjalëve shqipe, duke i krahasuar ato me fjalorin e sanskritishtes, hebraishtes dhe të gjuhëve moderne, vërteton se fjalët shqipe kanë natyrë simbolike dhe mitike, tipare të gjuhës se krijuar nga njeriu i parë. Ai sjell shembuj të shumtë se si rrënjët e gjuhës shqipe zërthejnë kuptimin e rrënjëve të sanskritishtes, gjë që e ben dot ajo vetë për fjalët e saj dhe të gjuhës shqipe. Kjo dëshmon se shqipja e lashtë ka qënë gjuha MËMË e gjuhëve te «vdekura» dhe me kalimin e kohës, prej burimit të saj rrodhen gjuhët e tjera. Kjo, vëren P.Zhei, shpjegon edhe faktin se:«Në gjuhën shqipe ndeshen glosa të të gjitha gjuhëve të botës, gjë që, krahas cilësish të tjera të spikatura, e bën shqipen një gjuhë SIMBOLIKE».

Për sa më sipër, gjuha shqipe/arbërishte është i vetmi monument «i gjallë» para-historik evropian (i pa vlersuar akoma nga UNESCO për faj të institucioneve Albanologjike) që dëshmon se si njeriu i parë, duke ndjekur tingujt e botës që e rrethonte dhe duke besuar në forcat e mbinatyrshme, nisi të shprehej. Gjurmët e kësaj gjuhe të njeriut primitiv, që i ra kryq e tërthorë një hapëire jashtzakonisht të gjerë të Europës, Afrikës dhe Azisë, gjuha shqipe i ruan edhe sot, të shprehura në të gjithë treguesit e saj: në pasurinë e fondit themelor të fjalëve, strukturën e tyre dhe sistemin gramatikor.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Tipografia e Leshit (Lissos) dhe historia e tij

Nga DR. TAHSIN JONUSI


Leshi u themelua prej Dionisit I, tiranit te Siraguses me 365/4 para Krishtit per shkaqe strategjike. Ky i sherbente atij si nje pikmbeshtetje ne te kryemit e veprimeve te tija ne Shqipnien e veriut dhe n'Adriatik. Ai ndertoi aty nje skele lufte dhe rrethoi qytetin me nje mur te trashe.

Prej Leshit mund te ndifmojshin anijet sirakuzane ishujt e bregdetit te Dalmatise. Vendi i fortifikuar permbilidhte qytetin e sotshem dhe malin mbi te cilin qendron keshjtjella e ndertuar prej Sulltan Selimit (1512-1520). Kjo mbahet prej Hahn-it dhe Ippen-it per Akrolissin e vjeter. Germadhat e pame prej vizituesve ne kohet e shkuara gjenden brenda qytetit te sotshem dhe mbi malin e keshjtjelles. Keto jane pjese te mbetura te fortifikimeve, Ippen thot ne vepren e tij se indentiteti i Akrolissit me keshjtjellen e sotme eshte konstatuar me siguri prej Hahn-it. Ai e ve Leshin te vitit 213 para Krishtit ne pazarin e sotshem, por shton se duhet te jete shtrire edhe ne fusha, pse aty gjeti pjese te nje muri shume te trashe, i cili rrethonte qytetin dhe lagesh prej drinit. Hahn-i mendon edhe se Leshi duhet te kete qendruar mbi trullin e mbushur prej lumit dhe zhdukjen e mureve e shpjegon ai ne menyre qe derdhja e lumit ka naltesuar faqen e tokes, ky eshte i mendimit se dy muret qe dilnin prej Akrolissit (Keshjtjelles) zgjateshin deri ne Drin. Ippen, i cili gjeti pjese te mureve ne veri dhe veri-perendim, e refuzon mendimin e Hahn-it, porse pohon, sikurse u-tha me larte, se gjeti pjese te trasha te murit te qytetit, te cilat qendrojne ne buze te Drinit. Shkaku qe ky e hedh poshte mendimin e Hahn-it, eshte pse ky i fundit bie ne kundërshtim me Polibin.

Kuptohet edhe prej Strabon-it se Akrolissi dhe Leshi nuk jane te bashkuar prej ndonje muri.

Pse eshte distanca mjaft e madhe?

Kundershtimi ndermjet Hahn-it dhe Ippen-it qendron ne pikën qe Hahn-i e di se keto dy vende jane te ndara, porse mban per Akrolissos malin mbi te cilin qendron keshjtjella e sotsheme dhe per kete shkak i mendon muret te zgjaturra deri ne Drin. Ky pranim



e shtrengon ate me e kerkue Leshin mbi trullin e mbushur prej lumit. Ippen-i, perkundrazi, mbahet ne lajmet e Polybit dhe te Strabonit dhe le menjane keshtu mendimin e Hahn-it. Ippen eshte i mendimit se pjeset e mbetura te mureve qe ka pare i perkasin Leshit, porse mban, sikurse Hahn-i, keshjtjellen Turke per Akrolissin e vjeter. Ketu qendron gabimi se pari prej Hahn-it dhe se dyti prej Ippen-it. Prej pershkrimeve te reja, qe jane bere mbi Leshin eshte me i rendesishmi ai i Praschniker-Schober. Keta udhetuan me 1916 ne Shqiperi dhe bene studime Topografike dhe Arkeologjike ne Lesh dhe ne rrethin e tij, sikurse Hahn-i dhe Ippen-i, por me ndryshimin e madh se keta njerz te deges, Arkeologe, per kete shkak mundten te perfitojne me shume se çdo vzhgues tjetër.

Dhe me te vertete keta ia arriren qellimit te plote: gjeten Akrolissin. Ky pra nuk eshte keshjtjella e ndertuar prej turqeve, pra, nuk qendron mbi malin e keshjtjelles se larte-permendur, por mbi malin e Shelbuemit, i cili eshte shume me i larte se sa Keshjtjella. Mbi kete gjeten Praschniker-Schober pjese te mbetura te nje fortese, e menyra te njesojshme te ndertimit dhe njekohshmeria e te cilave me germadhat e Leshit eshte pa dyshim. Nuk eshte e mundur me e pranue mendimin e Hahn-it dhe te Ippen-it, qe keshjtjella e sotshme te kete qene Akrolissin i vjeter, pse vazhdimi i pa-prer i mureve fortifikues prej keshjtjelles deri ne Drin eshte nje fakt kunder ketij mendimi dhe dhe se do te binin ne kundërshtim me burimet historike, mbasi vendi i zbrazet ndermjet Akrolissit dhe Leshit nuk do te ishte. Per kete shkak u shtrengua Hahn-i me kerkue Leshin ne nje vend tjetër, pran buzes se detit. Ky mendim eshte i gabueshem pse kjo pjese toke eshte fituar detit prej Drinit, pra asht nje gje e re.

Me te gjeturit e Akrolissit mbi malin e Shelbuemit dhe barazimin e germadhave te Leshit me Lissos mund te kuptohet teksti i Polybit, i cili bene fjale mbi rrethimin e ketij qyteti prej Filipit te V-te te Maqedonise. Livi dhe Polybi nuk permenden ndonje lume prane Leshit, porse muri i ballit te veriut, i cili qendron ne buzen e Drinit ka per kusht, edhe ne kohet e vjeter, mbrojtjen prej nje uji; dhe, pse Drini ka pase ne kohet e vjeter nje drejtim tjetër marrin Praschniker-Schober dy mundesi para sysh:

- 1) Se deti ka pase formue nje gji ndermjet qytetit dhe kodres, e cila qendron perkundrejt ketij te fundit.
- 2) Se lumi, i cili permbilidhte ujrat e zadrimes se juges, ka pa formue nje skele perpara se te nderoje

Drini drejtimin e tij. Kete lume e quajn Praschniker-Schober, duke u mbeshtetur tek Diodori, Anaps. Prej ketyre te dy pikave mund te pranohet e para; e dyta duhet me u refuzuar. Ketu kane gabuar Praschniker-Schober, pse nje lum i quajtur Anapos nuk ka shkuar kure pran Leshit. Prej pranimit te nje fakti te tille rrjedh gabimi se gjoja Diodori ne pershkrimin e tij ka pase zbkuruar Leshin me Gjinnaze dhe Tempuj. Keta i perkasin me te vertete Sirakuzes. Me te drejte e kundërshton A. Wilhelm mendimin e Praschniker-Schober dhe thot se keta ia kane dhene gabimisht fundin e kapitullit te XIII-te Diodori XV, te gjithë Leshit, kurse kjo gje nuk eshte me vend.

A. Wilhelm e zgjidh kete çeshtje, duke vertetuar se pjese e fundit, te tekstit te Diodori, nuk i perket e gjithë Leshit, por edhe Sirakuzes. Ketu, pra, qendron gabimi dhe ky ishte shkaku, qe Leshi zbkurohesh me gjinnaze dhe tempuj. Lumi Anapos, te cilin Praschniker-Schober e vene prane Leshit, buron mbas Huelsen afer Akrai-t te vjeter(Palazolo) ne rreze te malit lauro ne jugelindje te Sicilise dhe derdhet mbas nje rrjedhjeje prej 15 kilometrash ne stele e Sirakuzes.

Me e mbrojte teorin e rrjedhjes se lumit Anapos prane Leshit, eshte sikur te pranosh mendimin se M. Antonius mundi te bjere ne vitin 48 para Krishtit anije te quajtura Pontones ne stele e Leshit, nuk eshte me vend, mbasi buza e detit te Shqiperise eshte e ceket dhe per kete shkak mund te pranohet se buze-deti i Leshit nuk ishte i volitshem per anije te tipi tjetër. Pra ky duhet te ket qene shkaku qe Antonius ka perdor anije te ketilla. Dhe prej kesaj rrjedh qe Polybi nuk bene fjale per ndonje lum pran Leshit. Heshjtjen e ketij kerkon Hahn-i, per me zgjidh teorin e Anopos-it, me e shpjeguar ne menyren se Filipit i V-te i Maqedonise e ka sulmue Leshin, tue marshuar prej juges, keshtu qe lumi, i cili shkonte ne veri te qytetit nuk ishte nevoja te permendesh, mbasi ushtria Maqedonase nuk duhesh te kalonte mbi te.

Burimet historike na rrefejne se Leshi eshte rindertuar dy here: nje rindertim eshte bere prej Jul Qesarit, kur ky qytet i perkiste ketij prej vitit 59 para Krishtit. Ky na refen se e kishte fortifikuar Leshin per konventin e qytetareve Romane, te cilet ja u kishe dhene ate. Per rindertimin e dyte marrim vesh prej Qiriakut t'Ankones, i cili ka vizituar Leshin me 1436. Ky pa aty mure te medhenj te ndrequr po me te tille gure dhe te zbkuruar me arqitekture te ndryshme. Ne pikpamjen ekonomike Leshi ka pase luajt nje rol te madh ne kohet e vjeter pse ka pase qene qendra e nje rruge tregetare me shume rendesi, e cila shkonte per mes Mirdites, Kosoves deri ne Rumani.

Leshi ka pase qene lidhe me Shkodren dhe me Duresin. Mbas Patsch-it Chaussee-ja romane eshte ndertuar ne nje trase te perparshme. Ippen-i barazon rruget e vjeter me ate qe kane ndreq turqit. Kete mendim nuk e pranojne Praschniker-Schober. Ata jane me te drejte te medndimit se rruga e vjeter duhet te kete shkuar prej Leshit gjat rezes se maleve per ne Pedhane mbasandej permbi lumin e Matit deri ne Laç. Shkaku i ketij mendimi eshte se çdo vije tjetër me te shumten e vjetit nuk eshte e mundur me u perdore, pse ajo duhet te shkoje neper moçale.

Fluss eshte i mendimit se te qenunit e Leshit si nje qytet grek nuk ka vazhdu per nje kohe te gjate, mund te pranohet se e ka lene vet Dionisi I. ma vone i perkiste Leshi mbreterise se Ardiervet dhe u mbajt prej tyre si qyteti me ne jug dhe ne vitin 228 para Krishtit, kur u-ba pagja ndermjet Romes dhe Ilirise, e cila i dha fund luftes ndermjet ketyre vendeve. Ne vitin 213 para Krishtit pushtohet Leshi prej Filipit V te Maqedonise per kete na refen Polybi. Mbas lajmeve qe na jep ky ia mbrriene Filipit ne krye te dy diteve nepermjet lumit te quajtur Ardaxanus Mati, ku ngre dhe çadrat.

Paraschniker-Schober jane me te drejte te mendimit, se Filipit vjen prej jug-lindjes, pse ai asht nisur prej Maqedonise. Ky duhet te marshoje neper mes te nahise se lumit Mat ne jugelindje te tij, dhe qafat per mes te cilave kalon ai nuk jane ato te Krujes, por ato, qe gjenden ndermjet Shena Prrendes dhe Skurajt. Tue dale prej pjeses malesore bie Mati afer Pedhanes ne fusha; prane ketij vendi duhet te kete qendruar Filipit, pse prej kendej mundesh me pa ai Leshin, pozicioni i te cilit i mbrujtur aq shume prej natyre se bashku me fortifikimet i lane atij nje vrage te madhe. Filipit u tremb kur pa se Akroliss-i kishte nje pozicion strategjik aq te forte; e humbi shpresen per ta pushtuar ate dhe i ve syrin Leshit.

Marre nga revista Kombi e vitit 1938 drejtor Ali Kuçi (vazhdon ne numrin e ardhshem)



Zbulimet tronditëse për qytetërimin Ilir

Kanë kaluar disa muaj nga lajmi i jashtëzakonshëm i arkeologëve kroat se historia Ilire do të rishkruhet dhe me këtë edhe historia e Ballkanit dhe Europës. Më së miri këtë zbulim për ilirët e ka vlerësuar Nju Jork Times, duke iu referuar zbulimit të arkeologëve kroat, shkruan: "Paraardhësit tanë i njohim për gjuajtjen e mamuthëve, por zbulimet e fundit në ishullin Korçul, na dëshmojnë se njerëzit kanë ditur ta përpunojnë qeramikën që nga koha e akullit". Dhe këta njerëz që kanë ditur të bëjnë shumë më shumë se sa gjuetinë kanë pasur kulturë, zhvillim teknike, dhe që kanë ditur shumë më shumë se sa ndoshta po hamendësojmë edhe tani ne, dhe arkeologe kroat e amerikan, dhe se librat që kemi mund të jenë të shkretët, për nga mësimet e gabuara, të historisë dhe arkeologjisë së deritanishme. Arkeologët kroatë kur e bën publik zbulimin e tyre, thane se keto gjetje e ndryshojne kuptimin e historisë së përgjithshme botërore.

Zbulimet në ishullin e Korçullçs, në lokalitetin Kopil kanë gjetur një nekropol ilir, në të cilën janë gjetur copëza qeramike, të cilat datojnë ndërmjet viteve 17.500 deri 15.000 para Krishtit, raportoni mediat kroate në vjeshtën e shkuar, duke prezantuar punën kulmore të hulumtimeve katër vjeçare. Paradoxikalisht me bindjet dhe librat historik dhe arkeologjik, ky zbulim e përfaqëson kohën dhe kulturën ilire dhe njerëzore, me moshën e piramidave të Bonjës, që arkeologu Samiragiç, pretendon se i ka zbuluar, dhe janë rreth 20 mijë vjet të vjetra, e më shumë. Pra, kufiri i kulturës ilire dhe asaj ballkanike dhe europiane, është zhvendosur për më shumë se 10 mijë vjet apo rreth 15 mijë vjet para shfaqjes së asaj të hershme, dhe me shume se 15 mijë vjet para asaj që njihet si qytetërimi helenik, dhe që Europa e quan, themel të qytetërimin të saj dhe atij botëror madje, duke e vlerësuar si më superiorin

në antikitet. Ajo që është habitëse në varreza u gjetën përveç qeramikës, edhe armë prej hekuri dhe stoli prej bronzi, argjendi, qelqi dhe qelibari, te gjitha keto që tregojne pavaresi dhe parazhvillim nga qytetërimi helenistik.

Varrezat e këtij lloji nuk kanë qenë të njohura, kurse sa i përket organizimit, dimensioneve dhe përmbajtjes paraqesin një gjetje të re në studimet historike të banorëve ilirë për kohën para Krishtit, thuhet ne deklarimet e arkeologëve kroat. Arkeologu, Dinko Radiç, kryesues i ekspeditës arkeologjike, kishte deklaruar se ndjehen të privilegjuar që në një vend të vetëm mund të shfaqet tërë historia e panjohur njerëzore. Në ishullin Korçula janë zbuluar dëshmi të jetës njerëzore, që nga epoka e gurit deri në epokën e bronzit. "Mendohet se zbulimet në Kopilç, do ta ndryshojnë mënyrën se si ne e shohim historinë në këto hapësira. Ilirët, shpesh i perceptojmë si marginalë, veçanërisht në raport me kolonët grekë. Megjithatë, kërkimet tona kanë treguar se roli i ilirëve në këto hapësira ka qenë më i madh sesa është menduar dhe paraqitur deri tani", thotë Radiç. Menjëherë pas këtyre rezultateve interesim për këto zbulime arkeologjike kanë treguar edhe arkeologët të njohur botërorë, prej të cilëve edhe profesori Preston Miracle nga Universiteti i Kembrixhit, i cili u është bashkangjitur arkeologëve kroatë në punën e tyre katërvjeçare, raportoni mediat.

Por, ajo që është tronditëse, dhe dëshpëruese për shqiptarët, ne që besojmë dhe tashmë po e argumenton veç arkeologjisë, historisë, antropologjisë edhe gjenetikës, se ne jemi pasardhës të ilirëve, historianët dhe arkeologët shqiptarë, vazhdojnë të heshtin, dhe të tregohen indiferent për zbulimet e bëra, që jo vetëm pra ndryshojnë pikëpamjet për zhvillimin dhe civilizimin ilir, por edhe atë europian dhe botëror.

La questione dei Coronei

(Continua a pagina 4)

Grecia, poiché è comprovato che immigrarono anche Gheghi in larga misura. E' vero, invece, che gli Arvanidhi venuti in Italia con la loro origine tosca e con le preziosità lessicali acquisite in Grecia, influenzarono tutte le comunità arberesh imponendo a queste il loro lessico. Solo da tanto può trarre fondamento l'affermazione di quanti sostengono che il lessico degli Arberesh è comune a tutte le comunità e che nella costruzione linguistica che si compie in Albania potrà innestarsi il lessico tutto Tosko degli Arberesh. Si è propensi ad affermare che, dopo l'arrivo degli Arvanidhi in Italia, anche l'esame glottologico più attento non potrebbe pervenire ad esiti certi circa l'originaria appartenenza ghega e tosca dei primi insediamenti della diaspora. Con gli Arvanidhi, infatti, si modificò la fonetica e parte rilevante della struttura morfologica delle originarie parlate e si arricchì soprattutto il lessico. La tematica attinente al ruolo assunto e svolto dai coronei e dall'altra tanta gente venuta successivamente dalla Grecia, nell'ambito delle comunità arberesh, non ebbe uniforme considerazione da parte anche di molta avveduta ed autorevole storiografia che si limitò a porre in risalto piuttosto la munificenza di Carlo V che conferì diploma attestante l'indiscussa fedeltà dimostrata alla Corte di Spagna dai profughi coronei. Tale attestazione formale, resa

universalmente visibile da un diploma, avrebbe assunto anche effetti sostanziali a seguito della contestuale assegnazione di un mantenimento dal Regio Erario napoletano di 5000 ducati annui, oltre all'esonero dal pagamento di tributi e tasse comunali agli altri sudditi. La ricerca delle testimonianze dei privilegi concessi ai profughi fece trascurare la ricerca attinente l'attuazione dei provvedimenti adottati. Se è vero che tali privilegi e benefici in favore dei profughi furono effettivamente concessi, è altrettanto vero che tali elargizioni rimasero prevalentemente senza attuazione, a cagione dell'estrema povertà ed ignoranza che contraddistingueva gli Albanesi in quel tempo. Dai bastimenti di Carlo V approdarono in terra italiana tanti Greci e molti Greco-Albanesi di Corone. Ma mentre i primi, abitualmente dediti ai traffici mercantili nella loro città, si fermarono a Napoli ed in altri vicini centri urbani, godendo anche di tutti i privilegi per loro statuiti, i secondi, invece, dediti abitualmente all'esercizio di attività agricole svolte nell'immediato entroterra di Corone, preferirono congiungersi con gli antichi consanguinei, raggiugnendoli nelle comunità arberesh disseminate nelle tante province napoletane ed in Sicilia. Costoro, nell'isolamento in cui vissero per secoli, forse ignorarono del tutto i provvedimenti adottati in loro favore, di cui certamente pochi ebbero a godere.

Jeta urbane dhe arsimimi në Shqipëri gjatë pushtimit italian

Nga **DORIAN KOÇI**
Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar

(Vijon nga faqja 1)

Markezi i San Xhulianos tha se përveç këtij janë formuar edhe disa komisione të tjera, ngaqë nevojitet shumë informacion lidhur me pasuritë natyrore, me gjendjen e bujqësisë dhe mjetet e zhvillimit të vendit, në tërësi. Me sa kuptova, komisioni i organizuar nga Banca Commerciale do të nisej dje nga Italia dhe besoj se do të nisej investigimin e vet në Shqipërinë e Jugut. (1-Valentina Duka, Dokumenta Britanike për Shqipërinë dhe shqiptarët, Toena, Tiranë, 2012, fq. 111). Dokumenti i mësipërm tregon se Italia po investonte në Shqipëri dhe së shpejti do të dominonte në ekonominë e brishtë dhe të prapambetur shqiptare. Italianët e shikonin në të njëjtën kohë, Shqipërinë, si një pikë nevralgjike e interesave politike dhe synimeve hegjemoniste të tyre në Adriatik e Ballkan. Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe qëndrimi i dyzuar i Italisë për t'u rreshtuar në njërin apo tjetrin krah, do t'i jepej fund me afrimin dhe plotësimin e interesave të saj strategjike. Periudha nga 1914-1915, karakterizohet nga tratativa të shumta të të dyja palëve, si të Bllokut Qëndror ashtu edhe të Antantës, ku secila dëshironte ta tërhiqte Italinë mbas vetes. Ndërkohë edhe pse Vjena kishte interesa gjeostragjike, kryesisht në Shqipërinë Veriore, ajo i njihte Italisë sovranitetin ndaj Vlorës dhe ishullit të Sazanit. Kjo njohje interesi strategjik ndaj Italisë, ndodhte për arsye se Austro-Hungaria, që kishte në zotërim ende popullsi italiane në perandorinë e vet dhe ndihej e kërcënuar nga jugu.

Vendosja e Italisë në një rol të privilegjuar bëri që ajo të luante dhe ta kishte si në patronazh Shqipërinë dhe çështjen shqiptare. Përfshirja e saj deri në vitin 1914, kishte qenë nëpërmjet diplomacisë tepër aktive dhe mbështetjes së grupimeve të patriotëve shqiptarë që përfaqësonin dhe interesat italiane. Mirëpo, pas ngjarjeve të vrullshme të rebelimit të Shqipërisë së Mesme, largimit të Princ Vidit nga Shqipëria më 1914, si dhe aktivizimit të ambicieve serbo-greke, Italia e pa të udhëqetë të ishte e pranishme edhe me trupat e saj në territoret shqiptare, që i konsideronte si vitale për interesat e saj strategjike në Ballkan. Për të dërguar forcat e saj në bregdetin shqiptar, ajo u kap pas rrezikut që Shqipërisë i kanosej nga forcat e ashtuquajtura "vorio-epirote", të formuara kryesisht prej ushtrisë së rregullt greke si dhe të burgosurve ordinerë grekë të amnistuar nga qeveria greke. Rreziku në fakt kishte qenë i madh pasi rebelimi jugor i kishte shërbyer si thikë në shpinë qeverisë së Princ Vidit, por në të njëjtën kohë, propaganda italiane e hiperbolizoi në momentin kur vendosi të ndërhynte në Shqipëri. Deklarata e thirrjes: "Kush prekte Vlorën, prekte Italinë!", në fakt e nxorri zbuluar ambicien e vërtetë italiane, sesa qëllimet humitare që shpalli në ndërhyrjen e vet në Shqipëri.

Në 25 dhjetor 1914, kur në Shqipëri vijonte konflikti i brendshëm i armatosur ndërmjet forcave esatiste dhe kryengritësve të Shqipërisë së Mesme, Italia pushtoi Vlorën, duke zbkruar në fillim me forcat e marinës luftarake dhe pas tri ditësh me forca tokësore. Për shkak të gjendjes së rëndë, që po kalonte vendi, forcat atdhetare shqiptare nuk bënë ndonjë qëndresë të armatosur. Në kushtet e vështira të brendshme të vendit, reagoi vetëm pushteti lokal në Vlorë dhe disa nga paria e atjeshme. Prefekti i Vlorës, Osman Haxhiu dhe zv/kryetari i bashkisë Ali Asllani i paraqiti konsullit italian në Vlorë një protestë me shkrim kundër pushtimit të Shqipërisë. Me hezitimin e Greqisë, për të marrë pjesë në një nga aleancat e Luftës së Parë Botërore, forcat italiane e zgjeruan rrezet e zbkurimit të tyre, duke përfshirë pothuajse gjithë Shqipërinë e Jugut.

Zona e pushtimit italian, gjatë Luftës së Parë Botërore përfshinte krahinat përreth Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës, Përmetit, Kolonjës e Tepelenës, të cilat përbënin një zonë me rëndësi strategjike për Italinë. Qytetet që bënin pjesë në zonën e pushtimit italian ishin kryesisht qytete të vogla, përveç Gjirokastrës e cila numëronte rreth 11.000 banorë, popullsia e qyteteve të tjera nuk ishte më shumë se 5 mijë secili. Administrimi i qyteteve dhe zonave rreth tyre ishte me dorë të hekur, përsa i përket marrjes së vendimeve administrative, por shumë më efektiv se ai i mëparshëm osman, përsa i përket krijimit të një kulture administrative, që do të vendosej në themelet e shtetit shqiptar pas viteve 20'.

Që në fillim të vendosjes të forcave italiane në Vlorë, komanda e tyre mori menjëherë masa me karakter administrativ. Në Vlorë, ata vendosën pranë Prefekturës dy këshilltarë, njërin për çështjen e përgjithshme politike, tjetrin për çështjet financiare. Kjo masë administrative e nxirte në plan të dytë Prefektin e Vlorës, Osman Haxhiu. Pushtuesit cënuan rëndë edhe kompetencat e organeve të zgjedhura, siç ishte bashkia. Tani këshilltari italian pranë kryetarit të bashkisë diktonte gjithçka dhe asnjë nëpunës shqiptar nuk kishte të drejtë të vepronte pa urdhërat e italianëve. Italianët vunë dorë edhe mbi gjyqet e doganën e qytetit. Administrata e doganës u mbush me nëpunës italianë, të cilët shtinë në dorë bashkë me të ardhurat e saj, edhe rreth 100 000 fr.ar, të depozitës doganore. (3-Valentina Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Toena, Tiranë, 1997, fq. 57)

Ata e shkëputën Vlorën nga pikpamja administrative prej pjesës tjetër të vendit. Administrata e re ushtarake, e cila u vendos në Shqipëri, e filloi jetën mbi një truall të zbrazët nga pikpamja financiare dhe e dokumentacionit, sepse funksionarët grekë kur u



larguan nga këto vise, morën me vete shumicën e regjistrave, shkresat dhe të hollat e arkës publike. Gjatë administrimit të tyre, italianët, bënë edhe një organizim të ri të bashkive. Ata i kushtuan vëmendje të veçantë shtimit të të ardhurave të tyre financiare, duke vendosur rregulla të forta në drejtimin e mbledhjes së taksave, si dhe duke kontrolluar rigorozisht hyrjet dhe daljet në arkën bashkiake. Në këto kushte bilanci buxhetor i bashkive u rrit mjaft.

Kështu p.sh. buxheti i bashkisë së Gjirokastrës nga 40 000 lireta që ishte në vitin 1917, u rrit në 402 000 lireta në vitin 1918; i Sarandës nga 74 000 lireta në 85 000 lireta; i Përmetit nga 24 376 lireta në 46 000 lireta. Një pjesë e mirë e këtyre të ardhurave, u përdorën për punëra të ndryshme publike, një pjesë e të cilave janë në funksion edhe sot si godina administrative. Lehtësimi nga pushtimi i ashpër grek i Shqipërisë së Jugut si dhe investimet publike që filluan, e rritën ndjeshëm imazhin e Italisë në sytë e popullsisë shqiptare, por ky imazh do të dëmtohej rëndë dhe gati në mënyrë të pariparueshme pas denoncimit dhe marrjes vesh nga opinioni publik në nëntor 1917, i Traktatit të Fshehtë të Londrës. Traktati i Londrës u nënshkrua më 26 prill 1915, nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, të Francës dhe të Rusisë në njëjërën anë dhe të Italisë në anën tjetër. Përfundimi i kësaj marrëveshjeje ishte të kënaqte lakmitë italiane dhe ta rreshtonte atë përkrah Antantës. Shqipërisë, ashtu si dhe më parë në Konferencën e Ambasadorëve, sërisht i cënoheshin territoret dhe shteti i gjymtuar shqiptar vendosje nën tutelën italiane për t'u përfaqësuar në komunitetin ndërkombëtar. Traktati i Londrës i vitit 1915 ka hyrë në histori si një ndër aktet kryesore të diplomacisë së fshehtë. Ai është në të njëjtën kohë një ndër aktet ndërkombëtare më tipike të periudhës së imperializmit në përgjithësi. Nga arsenalit i diplomacisë zor se ka dalë një akt tjetër si ky, që ta karakterizojë më mirë thelbin e politikës së Fuqive të Mëdha ashtu dhe metodat e saj. Duket theksuar se në gjithë këtë traktat asgjë tjetër nuk e nxjerr aq qartë natyrën e vërtetë të imperializmit, të politikës së tij sidomos ndaj vendeve të vogla, sesa ajo pjesë, që bën fjalë për Shqipërinë e fatin e saj. (4-Arben Puto, Çështja Shqiptare në aktet Ndërkombëtare të periudhës së Imperializmit, vëll.II, 8 Nëntori, fq.151).

Nenet që i referohen direkt Shqipërisë ishin nenet 6 dhe 7. Neni 6 i kushtohej kërkesës kryesore të Italisë, së cilës i përgjigjet duke parashikuar "sovranitetin e plotë italian mbi Vlorën, mbi ishullin e Sazanit dhe mbi një territor të gjerë sa të siguronte mbrojtjen e atyre pikave". Zotërimi i këtij hiterlandi të gjerë ishte kryeura, që diplomacia italiane kish synuar prej kohësh në Shqipëri. Në nenin 7 bëhej një ndarje e "plaçkës", ku përfshihej edhe coptimi i ri i Shqipërisë. Tani Italisë me këtë formulim i jepej për të përfaqësuar një shtet shqiptar në marrëdhëniet me jashtë. Mirëpo ngjarjet e evluan në terren më shumë sesa mund të mendohej. Administrimi i territoreve të Shqipërisë së Jugut, që kishte qenë dhe truallit ku nacionalizmi shqiptar kishte operuar më tepër dhe pjesa më e urbanizuar e Shqipërisë, me qytete të spikatura si Korça, Beratit dhe Gjirokastra, rezultoi të ishte jo i lehtë për autoritetet italiane dhe për më tepër pavarësia e Shqipërisë e panegociushme nga qarqet patriotike nacionaliste. Ky presion për të ardhmen e Shqipërisë ishte arsyeja, që i detyroi italianët që gradualisht, të ndryshonin mendim dhe metodë për përqasjen e tyre ndaj çështjes shqiptare edhe pa u publikuar teksti i plotë i traktatit në gazetën ruse "Izvetia" në nëntor 1917.

Në 3 qershor 1917, italianët shpallën proklamaten e tyre në Gjirokastrë ku shqiptarëve u jepeshin disa të drejta.

Gjithë popullit shqiptar! Sot më 3 qershor 1917, në ditën e përvjetorit të lirisë kushtetuese italiane, ne, gjeneral kolonel Xhiacinto Ferrero, komandati i korparmatës XV, me urdhër të qeverisë së mbretit Viktor Emanuelit III, shpallim solemnisht unitetin dhe pavarësinë e gjithë shqipërisë nën egjiden dhe mbrojtjen e Mbretërisë së Italisë. Shqipëtarë! Me këtë akt ju, shqiptarë do të keni institucione të lira, milici gjyq, shkolla të drejtuara nga qytetarë shqiptar; do të mund t'i administroni vetë pasuritë tuaja, në të mirën tuaj profesionale dhe për

mirqënien gjithnjë më të madhe të vendit tuaj. (5-Eqerem bej Vloza, Kujtime 1885-1925, IDK, fq. 432). Ai ju bënte thirrje shqiptarëve të merrnin armët dhe të kujtonin traditat e lidhjeve të dy brigjeve të Adriatikut gjatë Perandorisë Romake, ku dhe u kujtonte shqiptarëve se veç një deti i ndante me Italinë. Në proklamaten rithexsohej sërisht miqësia me Italinë dhe se Shqipëria do të kishte mbrojtjen e Italisë për t'i garantuar pavarësinë. Mirëpo gjatë kësaj kohe kemi edhe një notë kundër proklamates për protektoratin italian në Shqipëri. Establishmenti ushtarako-politik i Italisë nuk mund të binte dakord me lëshimin e Vlorës dhe kujdestarinë ndaj shtetit të cinguar shqiptar.

Gjithësesi, pavarësisht kundërshtimeve në aspektin politik të pavarësisë së Shqipërisë, autoritet italiane për të fituar prestigj dhe influencë në sytë e popullsisë vendase, i kushtuan kujdes të madh, si sistemit urbanistik, ashtu edhe riparimit të infrastrukturës. Në fushën e arsimit, ata mbyllën shkollat fillore greke dhe në vend të tyre hapën shkolla fillore në gjuhën shqipe dhe italiane. U hapën kurse për arsimtarë shqiptarë si në Gjirokastrë edhe në Vlorë, si dhe u sollën nga Italia mjete mësimore dhe një sërë librash shkollorë. Gjatë kësaj periudhe u hapën spitale, u ngritën ferma, iu kushtua vëmendje punëve publike dhe u inkurajua prodhimi bujqësor. Të gjitha investimet italiane ishin të rëndësishme, por ato në fushën e arsimit fituan një rëndësi më të madhe kulturore duke pasur parasysh gjendjen e shtetit të ri kombëtar, shqiptar.

Lufta e parë botërore e gjeti të brishtë edhe arsimin shqiptar. Trevat shqiptare u ndanë në katër zona pushtimi ku secili nga këto shtete pushtuese imponuan mënyrën e tyre për përhapjen e arsimit. Shumë intelektualë shqiptarë u ngritën me kërkesat e tyre për të pasur një arsim të unifikuar kombëtar. Ndër të tjera ata këmbëngulën që gjuha shqipe të bëhej gjuhë zyrtare dhe të përdorej edhe në shkolla si dhe të organizohej rrjeti i shkollave shqipe. Në të njëjtën kohë kërkoheshin hapja e kurseve të shpejta për përgatitjen e mësuesve, ngritjen e shkollave profesionale me synim që të kalohet nga puna e thjeshtë e dorës në artizanat, të hapeshin konvikte ku të strehohen sidomos nxënësit e aftë që vinin nga zonat e largëta. Gjithashtu, të dërgoheshin nxënës për studime të mesme dhe të larta në shkolla të ndryshme në Evropë.

Në zonën e pushtimit Italian u mbyllën shkollat në gjuhën Greke dhe u hapën shkolla fillore në gjuhën shqipe, në të cilat dominonin mësues Italianë dhe mësimi i italishtes filloi të zinte vendin e parë. U hapën kurse të shkurtra për arsimtar shqiptar si në: Gjirokastrë dhe Vlorë, ku morën pjesë 135 veta dhe u sollën nga Italia mjete mësimore dhe libra shkollorë. (6-Valentina Duka, Historia e Shqipërisë 1912-2000, kristalina-KH, Tiranë, 2007, Fq. 96). Ndërkaq, qeveria italiane në qarkun e Vlorës dhe të Gjirokastrës krijoi një administratë ushtarake, që drejtohej nga specialistë italianë. Në këtë zonë shkoi duke u rritur numri i shkollave. Çdo shkollë kishte mësues shqiptar dhe mësues-ushtarë italianë. Mësimi i gjuhës italiane ishte i detyrueshëm. Për aftësimin e mësuesve shqiptarë në Vlorë u organizuan kurse të shkurtra, ndërsa në vitin 1917 u dërguan edhe 25 vetë, ku ndoqën një kurs 3 mujor pedagogjik. Shkollat punonin sipas programit të shkollave italiane. (7-Historia e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar, fq. 330).

Në vitin shkollor 1917-1918, në Gjirokastrë u hap edhe një shkollë qytetëse me profil tregëtar, në të cilën të gjitha mësimet të bëheshin në italisht. U bënë përpjekje për të çelur edhe shkolla me profil artizanal e bujqësor, por këto ngelën të porealizuara. Të udhëhequr nga interesat e veta ushtarake, politike dhe ekonomike italianët u kushtuan rëndësi të madhe qytetit të Vlorës dhe zonës përreth tij. Në këtë qytet ata ndërtuan çdo gjë që duhej nevojave të frontit. Në radhë të parë ata bënë një sërë punimesh drenazhimi në periferi të qytetit dhe ngritën institucionin italian të post-telegrafës. Gjithashtu me shpenzimet e prefekturës së Vlorës ngritën spitalin civil të qytetit me kapacitet 50-60 shtretër. Komanda për nevojat e ushtrisë bllokoi gjithë lokalet me pronësi shtetërore. Italia ndërtoi edhe disa pallate e barka për të sistemuar ushtarët. Në të njëjtën kohë italianët montuan edhe një central elektrik për ndriçimin e limanit dhe të

rrugëve kryesore të qytetit. U montuan tubacione të ujit të pijshëm, si dhe urrave të zeza.

Mullinjët e blojës me motor edhe preset hidraulike të vajit, të vetmet njësi industriale të trashëguar në vitet e mëparshme, u vunë në shërbim të luftës. Në shpinë të godinës së bashkisë u ndërtuan edhe një sërë magazinash dhe furrash. Për qëllimet e saj komanda italiane ndërtoi edhe një oficinë mekanike. Ata ndërtuan edhe një fabrikë tullash dhe një punishte lëkurësh. Shoqëria italiane "SIMSA", me qendër në Romë, bleu minierën e Selenicës së Vlorës kundrejt një shpërblimi prej 1 700 000 liretash. (8-Valentina Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Toena, Tiranë, 1997, fq. 159). Gjithashtu u ndërtua edhe një fermë bujqësore.

Autoritetet italiane i kushtuan shumë rëndësi edhe sistemit urbanistik të qyteteve të tjera në Shqipërinë e Jugut. Në qytetin e Gjirokastrës u restaurua godina e prefekturës. Restaurime u bënë edhe në ndërtesat ku u vendosën ambulanca, jetimorja, bashkia dhe policia e qytetit. U ndërtua një shesh i madh në qendër të qytetit, u ndërtuan banesa për akomodimin e oficerëve italianë, si dhe magazina për sistemimin e mallrave të ndryshëm. Ata kryen edhe një sërë punimesh për të ndërtuar ujësjellsin e Sopotit, i cili do t'i siguronte Gjirokastrës ujë të pijshëm. Në Sarandë u ndërtua një magazinë ushqimore, e cila lidhej me portin me anë e një dekovili, që shpejtonte ngarkim-shkarkimin në të. Gjithashtu u ndërtuan edhe godinat e nënprefekturës dhe bashkisë së qytetit të Leskovikut, si dhe u sistemuan një sërë rrugësh në qytetin e Delvinës dhe Tepelenës. (9-Valentina Duka, Qytetet e Shqipërisë në vitet 1912-1924, Toena, Tiranë, 1997, fq. 60). Pjesa më e madhe e këtyre ndërtimeve u bë duke shfrytëzuar fondet e prefekturave dhe të bashkive. Edhe ekonomia e qyteteve u vu në shërbim të luftës. U bë edhe projektimi i një tipografie, e cila do të lidhej me një shkollë artizanale, çka nuk u arrit të realizohej. Komanda italiane rëndësi i kushtoi edhe edhe marrëdhëniet tregëtare, brenda zonës së pushtimit. Kjo për arsyen edhe sepse Italia i shikonte këto marrëdhënie edhe si mjet të rëndësishëm për të forcuar pushtetin e vet politik dhe ekonomik. Skela kryesore ku realizoheshin këto, ishte Vloza. Gjatë vitit 1917 kemi një rritje të madhe të importit, sidomos miellit dhe misrit, për shkak të nevojave të mëdha që kishte në to ushtria pushtuese dhe tregu vendas. Në vitet 1917-1918 kemi edhe rritjen e eksportit. Rritja e vlerave gjatë këtyre viteve shpjegohet me blerjen prej palës italiane të sasive të mëdha të leshtit të përpunuar e të vajit të ullirit. Për hir të interesave të tyre ekonomike dhe strategjike, pushtuesit italianë, ashtu si ata francezë dhe Austro-hungarezë, bënë eksplorime për naftën dhe qymyrgurin në zonën e tyre të pushtimit. Për këtë qëllim italianët kryen edhe një sërë punimesh për hapjen e rrugëve të ndryshme.

Hapat e para për ndërtimin e një rrjeti rrugor u hodhën që në fillim të pushtimit. Për nevojat e tyre ushtarake ushtritë pushtuese austriake, italiane e frënge ndërtuan me shpejtësi rreth 1 000 km rrugë të improvizuara. Pjesa më e madhe e tyre (rreth 650 km) u ndërtuan nga ushtria austriake, ndërsa rreth 200 milje u ndërtuan nga ushtria italiane. Me rrugët që u ndërtuan nga ushtria italiane u lidh Vloza me Gjirokastrën, me Përmetin, me Delvinën dhe me Sarandën. Ushtritë franceze që kishin pushtuar qarkun e Korçës, ndërtuan vetëm rrugë me karakter vendor. (10-Akademia e Shkencave, Histori e Popullit Shqiptar Vëllimi II, Toena, Tiranë, 2002, fq. 106). Përveç këtyre, ushtritë austriake e italiane, gjithmonë për interesat e tyre ushtarake, ndërtuan gjatë Luftës së Parë Botërore një rrjet dekovili, me një gjatësi prej 350 km.

Dekovili i ndërtuar nga ushtria italiane pati karakter vendor dhe ndryshonte nga ai ndërtuar nga Austro-Hungaria, i cili lidhte qytetet më të rëndësishme. Ky sistem rrugor ishte shumë i dobët dhe nuk i lidhte të gjitha krahinat e Shqipërisë. Qytetet e Shqipërisë Veriore nuk lidheshin me ato të Shqipërisë Jugore dhe të dyja këto pjesë ishin të shkëputura nga viset e Shqipërisë Juglindore. Qeveria italiane projektoi edhe ndërtimin e një hekurudhe transballkanike, e cila do të fillonte në Bari e do të përfundonte në Stamboll. Puna për ndërtimin e kësaj hekurudhe njohu vetëm fillimet e saj, sepse rrjedha e ngjarjeve të mëvonshme e detyroi Italinë t'i pezullonte punimet.

Edhe pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore Italia vazhdoi të ishte prezente në Shqipëri, sidomos në zonën e Vlorës, të cilën vazhdoi ta kishte nën administrim. Gjatë fundit të vitit 1919 dhe fillimit të vitit 1920 patriotët shqiptarë menduan të mbanin një kongres të madh dhe në këto momente të vështira Lushnja ishte qyteti më strategjik dhe që i plotësonte kushtet, pasi ai ishte një qytet në qendër të vendit, ku delegatët do ta kishin shumë më të lehtë për të ardhur e për të marrë pjesë në Kongres. Mbajtja e Kongresit të Lushnjës ndeshi në kundërshtimin e qeveritarëve të Durrësit të pushtuesve Italianë, por më në fund ai arriti të mbahej duke marrë vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë. Vendimet e tij ngjallën jehonë të madhe në qarqet patriotike shqiptare dhe u përdorën ngado. Aty u arrit një bashkim politik i një aleance të të gjitha shtresave e grupeve politike, e cila i dha shpejt frytet e saj. Rezultati i parë i Kongresit të Lushnjës ishte organizimi dhe mbështetja e Luftës së Vlorës që garanto tërësinë territoriale të Shqipërisë të njohur ndërkombëtarisht në 1913. Lufta e Vlorës i dha fund pushtimit italian në Shqipëri dhe kohezionin e duhur të brendshëm shqiptarëve për të marrë fatet eventidit në duart e veta. Kjo tendencë në mendimin patriotik shqiptar do të mbizotëronte si ide gjatë gjithë rrugëtimit të mëvonshëm shtetformues shqiptar.

Në vend të një falenderimi për Pultin dhe pultjanët

Rreth librit të Dr. Mark Palnikaj: "Një vështrim historik rreth dioqezës së Pultit"

Nga Nikollë LOKA

Ka shumë mënyra për ta dashur vendlindjen dhe të gjithë njerëzit në përditshmërinë e jetës apo në momente të caktuara reflektimi ata i rikthehen asaj për mbështetja. Vendlindja jeton brenda njeriut. Disa e duan pa mundur t'ia shprehin dashurinë me ndihmë konkrete, ndërsa të tjerët lënë gjurmë ndër breza. Sidoqoftë, vendlindja ka nevojë për të gjitha llojet e dashurive, që nga lidhja emocionale me të e deri te përkushtimi me devocion ndaj saj. Studiuesi i njohur Dr. Mark Palnikaj ka zgjedhur një mënyrë origjinale për ta dashur vendin e lindjes, duke ia zbuluar disa pjesë të së kaluarës që të tjerët nuk i kanë parë, për shkak dhe rrethana nga më të ndryshmet.

Prej disa vitesh Mark Palnikaj është angazhuar në fushën e studimeve për vendlindjen. Palnikaj u është kushtuar studimeve shumëvjeçare në fushën e historisë, etnologjisë, folklorit, mesa duket një pasion i hershëm i tij. Ai ka krijuar vit pas viti një bibliotekë të pasur me botime në shqip dhe në gjuhë të huaja, me studime themelore akademike për t'u patur zili nga autoritete të larta shkencore. Duke u marrë për një kohë të gjatë me lexime dhe hulumtime të karakterit historik etnologjik e folklorik, ai ka formuar kulturën e nevojshme për të ndërmarrë studime në fushën e historisë dhe etnologjisë, ku është paraqitur me dinjitet me botime librash, artikujsh shkencorë, kumtesa, shkrime të karakterit publicistik-shkencorë, etj.

Në monografinë për Beqir Ndoun, njërin ndër drejtuesit e rëndësishëm të Luftës Nacionalçlirimtare në Malsinë e Gjakovës, ai ia ka dalë me sukses të pasqyrojë sipas kritereve shkencore perëndimore Luftën Nacionalçlirimtare, të shpërfytyruar nga trajtime diletante nën ndikimin e interesave politike apo klanore.

Në librin për bajraktarin e Mërturit, Tunxh Miftarin, Palnikaj sjell përmes dokumenteve, të vërtetat tronditëse që kanë shoqëruar jetën në ato male deri në shekull më parë. Ndërsa në një botim me titullin domethënës "A mund t'i përmirësojmë traditat", Marku i sheh normat e vjetra zakonore të Nikajve në një këndvështrim të ri, si vlerë që mund të mbijetojnë dhe të përdoren vetëm po të çlirohen nga ato teprime që nuk u qëndrojnë kushteve të reja ekonomike dhe realiteteve të reja shoqërore.

Autori Palnikaj është studiues me prodhimtari të gjërë, referues në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në Tiranë, Prishtinë, Shkup; lektor në shumicë të universiteteve shqiptare, si dhe autor i shkrimeve shkencore në periodikë apo në gazeta të përditshme.

Duke parë se dokumentacioni për Pultin në arkivat tona nuk ishte shfrytëzuar plotësisht, ndërsa arkivat kishtarë në Romë, Grottoferata

dhe Napoli nuk ishin hapur për trevën e Pultit nga asnjë studiues, ai me shpenzimet e veta, që prej tre vitesh është angazhuar në grumbullimin e një dokumentacioni të pasur. Marku ka punuar me javë në arkivat e lartpërmendura dhe tani zotëron në arkivin e tij, që e ka vënë dhe në shërbim të studiuesve të tjerë të njohur, një pasuri të madhe arkivore. Krahas kësaj, Palnikaj, nga pozitat e studiuesit që zotëron dokumentacion me vlerë të veçantë historike, ka nisur bashkëpunimin shkencor me disa personalitete të shquara të botës akademike si Noel Malkolm, Aleksandër Meksi, Robert Elisie, Odette Marquet, Zymer Neziri, Mark Tirta, Lush Gjergji, Ndoc Papeleka, Ardian Marashi, Nezir Bata, etj. Falë punës së tij, të paraqitur në këtë libër, Pulti del vend me histori, traditë, jetë, kulturë dhe qytetërim.

Marku vendos në bazë të studimeve të tij dokumentacionin kishtar dhe merret me atë pjesë të Pultit që përbënte Ipeshkëvinë e tij. Vetë kisha katolike ka shërbyer si institucion me funksione të shumëfishta për banorët. Relacionet kishtarë kanë dhënë një pasqyrë të hollësishme të jetës në male dhe janë pasuri e madhe historike për shumë fusha të dijës.

Palnikaj ka evidentuar me dokumente masakrat e kryera nga turqit ndaj popullsisë dhe klerikëve katolikë, duke dhënë prova se edhe në vitet e fundit të sundimit të tyre, turqit janë sjellë ndaj shqiptarëve si pushtues. Popullsia e Pultit është vrarë, pjekur e djegur, por nuk e ka pushuar luftën kundër të gjithë llojeve të pushtuesve.

Autori paraqet dokumente për genocidin serb dhe malazet ndaj shqiptarëve, duke na kujtuar se as katolikët shqiptarë nuk u kursyen në aktet e tyre kriminale. Për serbët dhe malazetët, myslimanët dhe katolikët shqiptarë ishin njësoj armiq. Malësitë katolike kanë bërë të njëjtën rezistencë ndaj tyre si dhe popullsia myslimane.


Ka të dhëna të rëndësishme për vendbanimet e dioqezës së Pultit. Të 36 vendbanimet e evidentuara prej autorit jepen në ndryshimin e tyre në kohë, përmes shumë relacioneve kishtarë, që sjellin shumë të dhëna me kërkesa që përsëriten nga njëri relacion te tjetri për numrin e banorëve dhe shtëpive, si dhe të dhëna të tjera.

Për herë të parë në këtë libër bëhet evidentimi i të gjitha kishave të dioqezës së Pultit. Janë 93 kisha, që kanë shërbyer në një periudhë të caktuar kohë, ku vetëm dy prej tyre, kisha e Shën Gjonit afër Gegëhysenit dhe kisha e Shën Mëhillit të Salcës kanë ardhur deri në ditët e sotme. Mbijetesë në fije të perit. Përmenden dhe 23 famulli, ku në disa prej tyre kishte shumë kisha, si në Gegëhysen 5, nga të cilat katër ishin funksionale, në Rajë 9 kisha, etj. Numri i madh i famullive dhe kishave në të gjithë dioqezën e Pultit tregon për praninë e një popullsie

të konsiderueshme, jetë fetare dhe ekonomike të zhvilluar, që pësoi regres nën pushtimin osman, sa për një periudhë kohe, në të gjithë Pultin kishin mbetur vetëm dy priftërinj. Ndoshta kjo gjendje me dy priftërinj, pa Ipeshkëv dhe me jetë fetare të paralizuar ka vazhduar për shumë kohë, deri sa fuqitë europiane filluan t'i diktonin Perandorisë Osmane respektimin e të drejtave të popullsisë së krishterë.

Palnikaj sjell për herë të parë në historinë kishtarë një listë të klerikëve që kanë shërbyer në dioqezë për një periudhë të gjatë kohe. Ai shfrytëzoi dhjetra relacione për periudhën nga viti 1628 dhe deri në vitin 2005. Aty ku ka qenë e mundur, ai sjell të dhëna për klerikët e përmendur si kombësia, vendi i lindjes, viti i shugurimit, funksionet në hierarkinë kishtarë, viti i vdekjes dhe për ata që ishin martirizuar edhe të dhëna rreth mënyrës së vrasjes së tyre. Në atë listë mund të gjendet se cilët nga këta klerikë ka qenë me kombësi shqiptare dhe për një pjesë prej tyre, nisur nga mbiemrat, dhe trevën nga vinin. Për dyzet vitet e para, nga viti 1628 dhe deri në vitin 1668 kemi klerikë të huaj, shumica dërmuese e të cilëve qenë misionarë. Nga viti 1668 dhe deri rreth viteve 1900, kemi françeskanë të huaj dhe vendës pothuajse në numër të barabartë dhe pas vitit 1900 me shumicë dërmuese shqiptarë deri në vitin 1967. Me ringjalljen e veprimtarisë së kishave pas vitit 1990 edhe në dioqezën e Pultit erdhën misionarë të huaj.

Libri sjell kontribute të rëndësishme dhe në studimin e jetës materiale dhe shpirtërore, duke përshkruar kushtet e banimit dhe të jetesës, marrëdhëniet brenda familjes, në vëllazëri, fis, fshat apo më gjërë. Në gjendjen në të cilën ndodheshin, pultjanët u ishin ekspozuar plotësisht kapriçioze të natyrës. Banorët e fshatrave kishin problem em rugët, se një shkëmb i pakalueshëm, një mal i lartë dhe i pakapërcyeshëm, reshjet e zgjatura, etj. bllokoni vendkalimet e shkurtëra dhe zgjasnin rrugët. Në verë kur shterronin përrënjtë, banorët ndërtonin ura të përkohshme, që i përllante ujë në vjeshtë. Përpjekjet për ta disiplinuar natyrën që mos t'u shkaktonte dëme kanë vazhduar deri në mes të shekullit të kaluar, madje dhe më vonë. Dr. Palnikaj sjell në këtë libër dokumente që përdoren për herë të parë nga historiografia shqiptare, që falë punës së tij mund të citohen në studime të tjera. Kërkimet e tij në Vatikan, Grottoferata, Napoli, Arkivin e Shtetit dhe Bibliotekën e Etërve Françeskanë në Shkodër kanë plotësuar një nevojë që ka patur historiografia jonë e studimeve kishtarë për dokumente të reja. Ndërsa nga librat e përdorur prej tij janë Iliricum Sacrum, Annuario Pontificio 2015; Conradus Eubel, Hierarkia Catholica, volumi I - IV; Ludovico Thomasino, Ecclesiae Disciplina, Lib. 1-De Primo Cleri Ordine, Lib. 2-De Secundo



Cleri Ordine, Lib. III, De Clericorum & Monacorum Congregationibus, Venetiis MDC CXXX; Loernzo Tachella, Le antiche sede episcopali latine, greche e bulgare dell Albania antica e della Macedonia; Enciklopedia Cattolica, Robracher, Historia e kishës; Francesco Carrara, Diocese di Spalato un tempo Salonitana di Spalato MDCCCXLIV; Ivan Kukuljaevic, Sackinski Codex Diplomaticus Regni Croatiae, Slavoniae et Dalmatiae, që janë burimet themelore të referencës për studimet e historisë së dioqezave.

Libri i studiuesit, Dr. Mark Palnikaj vjen në radhën e botimeve që studiues të ndryshëm po bëjnë për historinë e dioqezave katolike në vend. Me prurjet e reja dokumentare, Marku bën një përshkrim të thellë dhe të saktë të realiteteve historike në vend. Koncepte të tilla si: "Mbijetesë nën pushtim", "veprimtaria misionare", "konvertimi", "vëllazërimi ndërjetar", "lufta kundër pushtuesit" fitojnë referenca të reja. Falë dokumenteve të paraqitura në këtë libër, me fakte të reja që u shtohen dokumenteve të mëparshëm, Pulti paraqitet si trevë qëndrore dhe vatër atdhetarizmi. Treva që dikur quhej Pult është e vendosur gjeografikisht midis dy ultësirave: Nënshkodrës dhe Kosovës dhe sipas rasteve ka dhënë e marrë herë me njërin e herë me tjetrën, në simbiozën e përjetshme të fushës me malin. Gjeografia i ka përcaktuar kësaj treve një mision, historia i ka caktuar një detyrë, që Pulti të mbetet përjetësisht një kala natyrore e shqiptarizmit që rrezaton qëndrësë, frymon shqip me njerëzit fisnikë që mbajnë mbiemrat identitarë: Krasniqi, Gashi, Berisha, Bytyqi, Nika, Curri, Shala, etj. Vepra është shërbim i mirë ndaj të vërtetës historike dhe një homazh ndaj përpjekjeve mbijnjerëzore të kësaj treve për mbijetesë dhe ruajtje të identitetit të vet.

Një e njohur e rastit - Miq që i takojmë dhe i humbasim udhëtimeve

Nga ALBANA M. LIFSCHIN

Zakonisht nuk i mbajmë mend bashkudhëtarët e rastit në avione. Megjithatë, në 35 udhëtime gjatë dy dekadave në Evropë e në atdhe, në kujtesën time më ka mbetur një grua nga India. Avioni ynë ndodhej ende në runway në aeroportin e Munichut. Ajo lëshoi çantën e saj në karrigen pranë meje, por nuk u ul. Lëvizte nëpërmes radhëve me një sy hulumtus. Me të parë stjuardesën filloi bisedën me të. Qe nje e folur e shpejtë e me një ton të pakënaqur. Insistonte të ndërronte vend sepse kishte nevojë për dy karrige bashkë.

- Kam bërë udhëtim të gjatë që nga India, zonjushë, dhe kam edhe 10 orë udhëtim deri në NYC. Për kë i keni rezervuar ato dy vendet në fund? Pse të mos shkoj unë aty? Apo keni preferenca për njerëzit? Këtu jemi të gjithë të barabartë. U ul në vend e indinjuar. Me insistimin e saj në fillim m'u duk si grindavece, por pastaj e guximshme. Më tregoi se ishte gazetare nga India. Po shkante në NYC për një konferencë kolegësh.

-Unë kam udhëtuar shumë, në shumë vende, në të gjitha kontinentet, spjegoi. Pastaj më pyeti se nga c'vënd isha.

-Nuk besoj që të keni ardhur në vendin tim. Më duket se në fillim të viteve '90, të gjithë përgjigjeshim njëllor, me një farë ngurimi. Nuk na besohej se të huajt e njihnin atdheun tonë. Kaq dekada të mbyllur ndaj botës. Ajo u kthye e tëra nga unë dhe pritja.

-Unë jam nga Albania. Tani vonë kemi filluar të udhëtojmë nëpër botë. Dhe... jemi larg me Indinë.

-Edhe afër, - tha ajo, dhe në një moment më hutoi.

-Sepse ne kemi një grua të madhe të përbashkët që ka kombësinë tuaj, por shtetësinë tonë, Mother Tereza, - tha ajo. U hap një temë interesante për të dyja. I thashë se gjithnjë më kishte habitur fakti që NENE Tereza, kujdesej për leprozët dhe sëmundja nuk e kishte afektuar atë.

-E liga ka frikë nga shëtorët, -tha ajo me një ton afirmues. Atë kohë Nënë Tereza nuk ishte bërë ende shejt, madje as nuk ishte folur për shenjtorinë e saj, por mënyra se si e tha Mohini, mua mu duk se ajo ishte pikërisht ashtu. Një shejt. Udhëtimi i gjatë na miqësoi. Kur zbritëm në aeroportin Kenedi shkëmbyem adresat dhe kur po ndaheshim tek më zgjati dorën, u kujtua për diçka. Hoqi unazën e saj nga gisht i dhe ma zgjati mua. Ishte një unazë me gurë të gjelbër rubini. Kjo qe fare e papritur. Ajo u përpoq të ma vendoste unazën në gishtin përkatës, por gishtërinjtë e Mohinit ishin më të hollë se të mitë dhe rrethi i unazës përfundoi në gishtin e vogël.

Ishte fillimi i viteve '90. Muaj e vite kaluan dhe unë isha zhytur në rutinën e punës së përditshme për mbijetesë në Nju Jorkun e madh, ku ishte e vështirë të gjeje kohë edhe për një kafe me miqtë për shkak të distancave të mëdha dhe mungesës së kohës. Për Krishtlindje hodha një kartolinë urimi në kutinë e postës që kishim bujë rrugës. Mohini më ktheu përgjigje menjëherë. Më shkruante për udhëtimet që kishte bërë, për takimet me miq e kolegë në Evropë, për planet e ardhshme të udhëtimeve ku përfshihje edhe NYC, ku banonte një mikeshë e saj. Letrën e mbyllte me ftesën :

"Albana, come to Delhi, and stay with me. I will look after you". Madje më thosh se mund të vija bashkë me tim bir, vetëm duhet të evitoja dy muajt e verës kur ajo priste miq nga Evropa. Shkonte edhe më tej, duke më dhënë adresën e Indramit, në Mahhattan, në 4-th avenue. Ajo do të më informonte për vendet e bukura që ka India. Për një moment Mohini m'u duk sikur qe shqiptare. Në ishim kaq mikpritës dhe entuziastë për miqtë. E ruajtja atë kartolinë dhe adresën e saj. E vendosa brenda folderit tim tek xhepi me germën M". Sot, pas dy dekadash e sjell puna që unë e lexoj sërish. Kur mbarova, provova një ndjenjë boshllëku. Si e kisha harruar kaq vite?

-Pol, i thashë tim shoqi, -duke mbajtur në dorë kartolinën-letër të Mohinit, po sikur të bëjmë një udhëtim në Indi? I tregova si isha njohur me të dhe i zgjata letrën.

-Nuk jam e sigurtë nëse do ta njoh pas kaq kohësh, fola si me vete duke u ndjerë fajtores për këtë heshtje të gjatë. A nuk humbasim kur heshtim? E kërkova në internet gazetën e saj "Delhi Diary" për të marrë informacion për të dhe mësova se bashkëudhëtarja ime Mohini Bazaz paska qenë kryeredaktore e gazetës që nga viti 1948. Gërmova edhe më, dhe mësova që emri i gazetares Mohini Bazaz është sinonim për revistën "Delhi Diary". Kur thua "Mohini Bazaz" nënkupton "Delhi Diary" dhe e kundërta. Revista është krijesa e saj. Fillimisht si kryeredaktore (1948)dhe më pas si pronare e saj, (1969) ajo i dha revistës një portret të ri, të larmishëm, shumëgjyresh duke e shëndruar në enciklopedi për vendasit dhe sidomos për të huajt të cilët vizitonin Indinë duke u frymëzuar nga Ditari i

Delhit. Kolegët e respektojnë Mohinin si një botuese energjike e pasionante e mrekullisë së përjavshme të Delhit,(revista dilte çdo të premte) si një personalitet i fuqishëm në fushën e saj, e njohur brenda dhe jashtë Indisë. Për 40 vjet rrjesht pasuria e larmia e temave,ideve, ishte reflektim i udhëtimeve të saj brenda e jashtë Indisë duke njohur botën me atdheun e saj. Ajo vizitoi Britaninë e Madhe, Francën, Italinë, Egjiptin, Meksikën, Japoninë, Indonezinë, Singaporin, Australinë, Zelandën e Re, Rusinë, Kinën, Taivanin, Vietnamin, Israelin, Turqinë, etj. Pena dhe vepra saj u bë e njohur në shumë e shumë vende. Për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në fushën e gazetarisë turistike,në 2011 Mohini Bazaz u nderua me "Lifetime Achievement Award" për revistën e saj, më popullorja, për qytetarët e Delhit, që nga viti 1969". Duke llogaritur vitet mendova që Mohini tani duhet të ishte në pension. Kishte moshën e nënës sime. U gëzova kur gjeta një adresë të gazetës së saj në fb dhe dërgova një mesazh. Ditët kalonin dhe kur po më mbushje mendja se duhej të qe ndonjë adresë që nuk përdorej, më erdhi një përgjigje e shkurtër." Hi Albana, Regret to tell you that Mohini has left the earth for a heavenly abode and we don't have her with us any more". Mohini s'ishite më. Kolegët, lexuesit që e admironin dhe revista që ajo krijoi, e humbën zonjen e madhe Mohini Bazaz, në 28 korrik 2016. Isha 6 muaj e vonuar. Udhëtimet e rastit mund të na njohin me njerëz të jashtëzakonshëm. Janë mundësira të papritura për të hapur horizonte të reja në jetë. Është rutina e përditshme që i le ato përtej kujtesës dhe kur kujtohem ne, është tepër vonë.

'Fitorja si e Pirros' dhe qyteti i ndërtuar me urdhër të Pirros

Nga GEZIM LLOJDIA

Qyteti që ndërtoi Pirro gjendet disa km më sipër ndoshta 7 km nga fshati Saraqinisht. Antigoneja është një ballkon ku në prerin tënd qëndron lugina e Drinos përballë qytetit të Gjirokastrës. Fokusi përfshinë një pamje magjepsë. Rrënojat këtu qëndrojnë kohës prej fund të shekullit të 3-të dhe në fillim të shekullit të 2-të, kur mori formën e një qyteti shteti dhe u kthye në një nga vendbanimet më të rëndësishme të antikitetit. Qyteti shtrihet në një kurriz të gjatë e të sheshtë të kodrës së Jermës rreth 600- 700 metra mbi nivelin e detit, në afërsi të fshatit Saraqinishtë, përballë pamjeve të bukura të Gjirokastrës. Sipërfaqja e përgjithshme e qytetit brenda dhe jashtë mureve është rreth 90 hektarë.

Shëtite në hapësirat e pamata të qytetit me emrin e Mbretëreshës Antigona. Lojra sportive në lëndinat plot lule. Ushqim i shijshëm nën hijet e lisave shekullore. Ujë i pastër dhe i freskët nga burimet me ujë kristal të Antigonesë. Shëtite me kuaj dhe biçikleta. Futboll dhe volejbol. Birra dhe pije freskuese, qofte dhe shishqebap zgate, djathë dhe veze fshati. Kjo është një ditë pikniku në qytetin e Pirros. Antigoneja në pranverë shtrihet në një qilim masiv të gjelbër. Autobusët, automobilat e tjerë qëndrojnë më sipër ngase ledhet janë të mbushura me rrënoja. Pllajat mërzejnë në diell i bëjnë, hije trupit të vet. Përpara se të lini pas korijet e gjelbëruara, vështrimin e fundit e hedhe nga qyteti i Pirros. Kështu më ka ndodhur kur isha në Antigone. Më ftoi Engjell Serjani se „Lushi, unë, Bashkimi,Marini e ndonjë tjetër për herë të parë në Shqipëri bëmë të vizitueshme parqet arkeologjike, një traditë që vijon edhe sot, me pak njerëz dhe vullnet kthym këto qendra arkeologjike nga qendra të harruara nga kohët dhe njerëzia e këtij vendi në destinacione turistike të preferuara. Nëse sot flasim për arkeologji shqiptarët kuptojnë parqet e Butrintit, Apolonisë, Bylësis, Amanti, Oriku, Finiq. Kjo përvojë që lindi për herë në parë në SHBA, u muar si një mësim ku sot turizmi arkeologjik kulturor është i preferuari turistëve të huaj. Duke folur për Lushin dua të them se Lushi gjatë kohës që qëndroi drejtorë ka ndërmarr ekspedita dhe e ka zbuluar qytetin e Pirros me një sërë projektesh. Ndiqni ritmin e kësaj dite. Në përmbajtje shfaqet e qetësuar, e zakonshme, gati e rëndomtë, mirëqotë brendia e saj është plot thesare. Thesaret e kësaj bote, nuk fshihen në brendi të tokës, por rrojnë në thellësitë e shpirtit. Kapjen e fillit,që bëri Lushi, bënë për ti paraprirë poezisë, delli i pashaqur ende, nuk dihet rruga, që do të ecte, traga dhe fush - pamja që do të përshkonte, gjurmët nuk shiheshin qartazi,por brendia e shpirtit pluskonte lëvizje sizmike. Lushi dhe 5 shtetarë të tjerë e kthyen Antigonen në një qendër arkeologjike të vizitueshme. Duhet vlerësuar edhe kontributi i tyre, leximi i të cilës është paraprirë nga puna dhe idetë për të ndriçuar një qytetërim të humbur. Pikërisht fryma e këtij njeriu plot ide. Era nuk e rrëzoi në përnuan e thellë. E zgjoi atë ëndërr të fshehur, shpirti i lartësuar për të bërë punesa të mbara. Prandaj ndikimi i Lushit nuk shfaqet rastësor, i befte, por është përcaktues është një lloj skalitje siç bënë me gurin skulptori, pikërisht në saj të forcës,që i dha fryma e tyre, Antigoneja sot është qendër e vizitueshme. Ata që kthehen prej andej, qoftë nga Antigoneja, Amantia, Oriku, Bylisi sepse Apolonia apo Butrinti kishin qenë destinacione turistike jo shumë të njohura,por sigurisht kishin qenë janë koshientë të tregojnë se kanë parë një qytet magj. i kur mjegulla e bardhë si një napë e ka përpirë të gjithën dhe mbretesha Antigona ende fle në kujtesën e qytetit. Po Pirro ku është?

PIRRO, MBRETI I EPIRIT.

Gjithkush e di emrin e Pirros, proverbial për vlerën e fitoreve të kryera, por edhe për finalitetin e fitoreve të shumta në fushë, shkruan autori italian Sandro Caranzano. Pirro i përkiste fisit të Molosëve, (ndarjet rreth shekullit të katërt para Krishtit në Epir, thotë autoritalian). Molossi i njohur në origjinën Trojës prejardhja un'ori, duke sjellë lindjen e postipite të tyre AK. Molossus, bashkimi i Neoptolemus (birrit të Akilit) dhe Andromaka (e veja e Hektorit). Sipas traditës, pas një seri aventurave, të dy kishin vendosur rezidencën në qytetin e Butrintit (në jug të Shqipërisë). Ky version i mitit, nuk është vulosur tjetërkund, u zhvillua ndoshta në një tavolinë në epokën klasike si shtysë nga sundimtarët, të cilët tregonin istoria është marrë nga Euripidi nëll'Andromaca dhe kështu, dramaturgu i njohur ishte i ftuar në qytetin Mollosisë e Passaron për



të mbikëqyrur skenën e tragjedisë.Plutarku në jetë paralele tregon për shumë zyrtare të Pirros, një gjeneral i cili udhëhoqi ushtarët i veshur me përkrenare të veçantë, të stolitur nga dy brirë dhish. Në rininë e tij, e dëbuan nga shtëpia, Pirro kishte shkuar për të kërkuar pasurinë e tij në ushtrinë helene Pas disa teste ndalet, Dhimitër I i Maqedonisë (një nga pasardhësit e Aleksandrit) e kishte dërguar në Egjipt në gjykatën e Ptolemies si një peng, një pozicion që i dha atij mundësi interesante. Hyri në zemërgjerësi të mirë të sundimtarit të Egjiptit, Ptolemeu I, Pirro ka pasur privilegjin të marrohet me Antigonen, vajzën e shtratit të parë të mbretëreshës së Egjiptit. Në vitin 297 p.e.s komandanti u kthye në Epir me nusen e tij të re dhe me kurorë pas vdekjes së saj Cubase Gino Neoptolemus, ka është përfolur se ai ishte helmuar. Për të cilën një brez tragjike që shoqëroi Pirron gjatë gjithë ekzistencës së saj të trazuar, princesha egjiptiane vdiq vetëm dy vjet më vonë. Pirro ka kërkuar për të përjetësuar emrin saj e cila është drejtuar nga qyteti që ishte duke u përgatitur për ta gjetur: Antigonenë. Ajo ishte planifikuar të ndërtohej shtatëqind metra lartësi, në zemër të luginës së lumit Drino (rrugë strategjike në mes të Epirit dhe Ilirisë), ulur në një vend të bukur panoramik mbi kodrat që tani dominojnë qytetin e hipnotizuar Gjirokastrën, thotë autori italian.

Antigoneja është simbol i pranisë së udhëheqësit më të famshme në Shqipëri,dhe është gjithashtu vendi më i rëndësishëm arkeologjik sot. Plani urban respekton traditën e qyteteve fqinje me blloqe drejtkëndëshe me përmasa 51 x 102 m përshkuar,nga lindja në perëndim nga një rrugë e madhe, që shtrihet për 900 metra. Planifikimi urban është studiuar teorikisht, duke krijuar tre rrethe: Akropoli i cili gjithashtu ka vendosur shtabin ushtarak, një hapësirë e gjallë e përbërë nga agora dhe një shtesë .Fillimisht i lirë në pritje të ardhjes së qytetarëve të rinj nga vendi. Qendra u bë një nga më të populluar të rajonit, si një pikë referimi për biznesin dhe zejtari të cilësisë.

-Antigoneja, shkruan Sandro Caranzano, nuk ishte padyshim i vetmi qytet i madh. Si dhe ka ndërtuar në mendjet e tij, Butrintin dhe Finiqin, mbretëria zgjatet më në jug, në, ku kishte Ambracia dhe Passaron (qyteti ku mbretërit u betuan për besnikëri ndaj ligjeve dhe ishin të vendosur) Molossi gjithashtu ka dominuar me orakullin e famshme Sanctum e Dodonës, ku priftërinjtë, sipas një tradite të lashtë, kanë emtuar përgjigjet me interpretimin e fëshfërimën e gjetheve në erë të një lisi të shenjtë të Zeusit. Aleatët italian të Pirros dhe romakët vetë mbetën jo shumë të habitur nga ushtria imponuese me udhëheqës epirotë,madje nga rrufet e fitoreve të tij, por edhe imponimi tërheqës, e cila frymëzoi të famshme shprehje duke thënë "fitore e Pirros".

Prej vitit 2011 gërmimet në Antigone i kryen një ekspeditë e Institutit Arkeologjik me udhëheqës prof. Dr Dhimitër Condi. Historia e qytetit. Gërmimet e para janë bërë nga arkeologu grek Evangeliades Demitrios në vitin 1913, por ishte arkeologu i njohur shqiptar Dhimosten Budina i cili, në vitet 1970 dhe 1980, zbuloi planin e qytetit dhe gjithashtu emrin e tij. Një seri prej monedhash bronzi të gjetura gjatë këtyre gërmimeve ishin përdorur ndoshta për të votuar në asambleen e qytetit. Ato ishin stampuar me mbishkrimin

ZBULIMI I NJË MBISHKRIMI MBI NJË PLLAKË SHTUFI NË GNATHIA

nga ETNOR CANAJ

Një tjetër fakt i rëndësishëm është zbulimi i një mbishkrimi mbi një pllakë shtufi, gjendur në një varr mesap (datuar si i shek. IV-III. p.Kr.) në Gnathia (Egnazia, Puglia), me emrin e një Βυλλίωνος, «ΔΑΙΗΘΝΣ ΠΛΑΤΟΡΡΙΗΙ ΒΟΛΛΙΗΙ». Antroponimi Πλάτωρ është tipik i popullatave ilire dhe pjesa e tretë e emrit, pikërisht ΒΟΛΛΙΗΙ, mund të sugjerojë faktin se familje të popullsisë së Bylineve mund të kenë emigruar nga atdheu i tyre dhe të jenë vendosur në Gnathia.

Në lidhje me identifikimin e sitit arkeologjik, emrin e tij, kronologjinë dhe problematikën që paraqitet në lidhje si me të dhënat arkeologjike dhe ato historike, këtu do marrë si referencë mbishkrimin e Bylësis, përkatësisht atë të Marcus Valerius Lollianus, sikurse bënë edhe disa udhëtarë dhe studiues në të kaluarën të cilët kërkuar të zgjidhnin enigmën e Astacias së lashtë. Siç është sjell në këtë punim, studjuesi i parë që identifikoi Klosin me Nikaian e lashtë ishte epigrafisti francez Louis Robert, që duke u mbështetur në tekstin e Oroposit (Σώστρατος ... Βυλλίων άπο Νυκαίας) mbështeti tezën se qyteti i origjinës (Nikaia) i djaloshit fitues së garës ishte i njëjti qytet sjell në veprën e S. Bizantin.

Por çfarë lidhje ekziston midis emrave të Astacia dhe Nikaia?

Në veprën «Dionisiaka» Nonno i Panopolit flet për një nimfë, me emrin Nikaia. Ajo është njëra prej një grupi nimfash të cilat quheshin Αστακίδες dhe që jetonin në liqenin Astacide në Bitini:

«Ενθα τις άγκυλοτόχος, έρημάδι σύννομος ύλη, παρθένος Αστακίδεσσιν όμότροφος ήνθεε Νύμφαις καλλιφής Νίκαια, λαγοβόλος Άρτεμις άλλη, ... «D. 15, 169-17465

Sipas mitologjisë kjo nimfë e ujit, e cili jetonte në liqenin Astacide, i dha emrin qytetit të Nikaia në Bitini, sikurse sillet në një pasazh të Memnonit:

«Αύτη δέ ή πόλις ή Νίκαια τήν μεν κλήσιν άγει άπό ναίδος νύμφης, όνομα λαχούσης τήν Νίκαϊαν, έργον δέ γέγονε Νυκαέον τών μετά Άλξανδρου μέν συστρατευσάντων, μετά δέ τών έχέινου θάνατον κατά ζήτησιν πατριδος ταύτην τε κτιζάντων και συνοικισαμένων.»

Pra, në rastin tonë, nuk është për tu përjashtuar teza sipas së cilës qyteti kishte dy emra, atë të Nikaia dhe Atacia. Raste të ngjashme mund të përmendim atë të qytetit fqinj të Apollonisë, i quajtur edhe Gylaktion prej kolonëve korinthis, sikurse edhe rasti i Δυρράχιον, quajtur edhe Επιδάμωνος. Përveç kësaj duhet shtuar që emri Nikaia/Astacia mund të ishte i justifikuar, pasi Klosi është i rrethuar nga uji. Përveç lumit Aaos (Vjosa) në perëndim, në fakt në jug gjendet lumi Povla, dhe në lindje përroi i Marushës. Banorët e lashtë, ka mundësi që ti kenë dhënë këtë emër qytetit të tyre, në nder të kësaj nimfe të ujrave. Nuk është për tu përjashtuar, në këtë pikë, që rruga e ndërtuar nga Marcus Valerius Lollianus të çonte në Klos dhe se Astacia e lashtë të ishte pikërisht qyteti i Nikaias. Këto të dhëna mund të forcojnë më tej tezën e Robert në identifikimin e Nikaias, por, në të njëjtën kohë, ato na vendosin përballë disa pyetjesh dhe problemesh të tjera. Sipas studieve dhe arkeologëve shqiptarë dhe të huaj, qyteti i Nikaia-s u shkatërrua në vitin 167 p. Kr, nga Lucio Emilio Paolo Macedonicus, pasi qyteti zgjodhi për të marrë anën e mbretit Perse të Maqedonisë. Në mbështetje të kësaj teze, ata sjellin faktin se të vetmet monedha të kësaj periudhe, të zbuluara gjatë gërmimeve, janë ato republikane epirote si dhe ato të mbretit Perse të Maqedonisë.

Megjithatë Papajani, gjatë gërmimeve në Klos, gjeti reperte të periudhës romake, si për sa i përket monedhave (57 copë) ashtu edhe fragmente qeramike edhe pse në sasi më të vogël në krahasim me ato të periudhave të tjera. Sipas mendimit tim, teza mbi bazën që qyteti u braktis pas vitit 167 p. Kr., në një farë kuptimi, mund të jetë kontraktore me pretendimin e Robert. Teksti i Oropos në fakt është datuar si i shek.I p. Kr., kështu që ne duhet të supozojmë se në periudhën e cila shkon prej vitit 100 p. Kr., e deri në vitin 1 p. Kr., qyteti vazhdoi të banohej dhe kishte një jetë publike si dhe private që zhvillohej normalisht. Dëshmi e kësaj është fakti që qyteti dërgoi një atlet të ri të vetin për të marrë pjesë në lojërat Olimpikë në Oropos të Atikës.»



(Vijon në faqen 18)

Sulle Alpi Albanesi con Ugo Ojetti¹

Il 1° luglio 1901 lo scrittore e giornalista Ugo Ojetti (Roma, 1871 - Firenze 1946) partì da Brindisi diretto a Prevesa, prima tappa del suo reportage albanese come inviato del Corriere della Sera. Da quel viaggio nacque uno dei più bei libri italiani sull'Albania. Il volume esce ora in una nuova edizione annotata e commentata (Ugo Ojetti, L'Albania, a cura di Olimpia Gargano, Ledizioni, Milano, 2017), completo della cartina originale "La grande Albania". Per l'occasione, riportiamo qui di seguito un estratto del reportage che diede origine al libro: pubblicato su La Lettura, rivista mensile del Corriere della Sera, era accompagnato da bellissime illustrazioni di costumi albanesi di cui offriamo per la prima volta una selezione ai nostri lettori.

(Continua da pagina 1)

La narrazione si fa sempre più appassionata man mano che si sale verso il nord: per Ugo Ojetti, come del resto per molti scrittori europei prima di lui, il cuore della tradizione albanese si trovava su per le montagne, da Scutari in poi. Ojetti rimase affascinato dagli antichi costumi albanesi, che fino a quel momento conosceva soltanto attraverso i libri, in primo luogo dai versi di Byron, che se n'era innamorato al punto da farsene confezionare un paio da esibire nelle occasioni più importanti. Ecco come descrive l'aspetto e la giornata tipica di uno dei montanari incontrati lungo il suo percorso.

"Magro, alto, nervoso, taciturno, coi baffi lunghi biondicci, senza barba, coi capelli rasi fin dietro le orecchie sotto la calotta bianca o rossa, con le brache di cotone o i pantaloni di panno bianco larghi fino al ginocchio, attillati sul polpaccio e aperti alla messicana sulla cavaglia, col giustacuore nero o rosso, col farsetto largo a scapolare fatto ora di panno nero o rosso, ora di pelle di pecora o di capra nera col vello in fuori, con la cartucciera alla cintola dai bossoli d'ottone lucenti e sopra la cartucciera lo « scigliachi » per il revolver e per il coltello, egli non fa un passo senza il suo fucile; e, se ara, se lo appende sulle spalle a bandoliera, e se bada alle pecore o alle vacche che pascolano, si siede tenendoselo sulle ginocchia o si sdraia per terra ponendoselo sotto la testa come un sicuro guancialetto.

Non lo lascia che alle porte di Scutari, per un recente regolamento di polizia che è stato accettato solo dopo il parere favorevole e unanime dei vecchiardi di tutte le Bandiere della Montagna, — e anche perché gli stessi montanari hanno capito che con tutti quei fucili in spalla e con tutte le vendette da compiere il bazar del mercoledì a Scutari, dove essi raccolgono tutto il loro commercio, diventava più spesso un convegno per massacrarsi con lealtà che un mercato per vender grano, pelli, tabacco o cavalli."

Tra le fonti su cui Ojetti si era documentato c'era sicuramente la preziosa monografia di Arturo Galanti², un libro che per ricchezza d'informazioni oltre che per la sua ampia bibliografia è un punto di riferimento nell'albanistica di lingua italiana. Così, munito delle conoscenze necessarie per districarsi nella complessa topografia amministrativa dell'Alta Albania, Ugo Ojetti disegnava sotto gli occhi dei lettori italiani di oltre cento anni fa quello straordinario sistema di governo con cui si reggevano intere popolazioni di antica discendenza. Ad accompagnare le immagini c'era l'elenco dei relativi *bajrak*, le collettività locali riunite sotto la stessa bandiera.

"I malliesi o montanari si dividono in tribù e in



Fig. 3. Montanaro di Schlachi



Montanara di Busciati



Contadina ortodossa di Vroca



Contadini della pianura del Drino



Mirdita



Donna Mirdita

bandiere o *bairacht*. Dalla bandiera dei Clementi più vicini al confine montenegrino, scendendo giù per la riva orientale del lago di Scutari verso sud, si incontrano di montagna in montagna gli Hotti, gli Scerli, i Castrati, i Rioli, i Busciati i Pulati, i Posripa, gli Slachi e, ritornando verso l'interno lungo il Drino, nel versante nord i Dusmani, i Nicài, i Marturi, i Grasnici, gli Hasi, nel versante sud i Mirditi, i Ducadgini, i Taci, — per dir solo di quelli compresi nel vilajët scutarino. Le tribù più numerose, ad esempio quella dei Mirditi che comprende venti o trentamila persone, si dividono in più bandiere che spesso prendono nome dal

paese o dal villaggio più numeroso. Ogni *bairacht* è comandata da un *bairachtar* che assistito dal consiglio dei *vecchiardi* o anziani delle famiglie maggioranti tutela gl'interessi della tribù, nomina in caso di guerra un capo militare per un tempo e uno scopo determinato, amministra la giustizia secondo la legge della Montagna o Lek Ducadgin e sorveglia l'esecuzione delle sentenze".

Ugo Ojetti era arrivato in Albania nello stesso anno in cui vi mise piede per la prima volta la pittrice, etnologa e scrittrice Mary Edith Durham, che con i suoi libri segnò una svolta nella conoscenza della cultura dell'Alta Albania.

Non sappiamo se i loro cammini s'incrociarono; quel che è certo è che ognuno dei due contribuì a fare luce su un tesoro di antiche tradizioni nel cuore dell'Europa, un piccolo universo fuori dal Tempo e dalla Storia, rimasto intatto per secoli a due passi dalle rive del mare Adriatico.

¹ Le citazioni e le immagini riportate in questo articolo sono estratte dal reportage di Ugo Ojetti *Sulle Alpi Albanesi*, in *La Lettura. Rivista mensile del Corriere della Sera*, Anno I, n. 11, Novembre 1901.

² Arturo Galanti, *L'Albania. Notizie geografiche, etnografiche e storiche*, Roma, Società Editrice Dante Alighieri, 1901

Un capo dei ribelli Albanesi a Nuova York

(Vijon nga faqja 3)

per il mondo che noi aspettiamo i più forti aiuti. Noi siamo in pochi all'estero, poiché il crudele destino esige che la moltitudine resti a soffrire nelle proprie montagne, pronta ognora a difendere l'integrità del suo territorio. Aiutando la causa albanese, l' "idea nazionale" gli italiani non soltanto faranno una bene alla terra dei loro avi, ma eviteranno che sull'altro lato dell'Adriatico, rimpetto a Brindisi, possa sventolare un giorno la bandiera austriaca. Non basta la oppressione della propria patria; si deve anche far correre rischio, lasciando libero passo al nemico secolare, a quella che si largamente concesse e concede ospitalità all'Albanese?

Che cosa dovrebbero fare gli Albanesi in America?

- Essi dovrebbero organizzarsi in fascio e intendersi per intensificare la propaganda nazionale, raccogliere armi e quattrini per soccorrere i moti insurrezionali; tener viva in questa libera terra l'agitazione per la santa causa della indipendenza patria; in modo che l'America e l'Europa si commuovano al grido di dolore che viene dall'Albania. Bisogna far sapere al mondo che il popolo Albanese non è morto: come visse libero e glorioso, tale "deve" vivere e "saprà" vivere.

A questo punto finì la parte essenziale della intervista, a cui assistette un altro milite della sacra causa albanese: Pietro Scaglione da Piana dei Greci, che in Italia è stato tra i più attivi propagandisti e che in America continuerà l'opera sua difficile quanto nobilissima.

Shaban Bey Gotsha ha lasciato in noi profonda impressione. E tale l'accento con cui questo apostolo perora la causa del suo popolo, è tale l'indomita energia che pervade il di lui spirito, è tale la fiducia che egli ripone nell'avvenire della sua Albania, che noi non possiamo davvero — confermando voti nostri antichi — non augurare la liberazione e i sorrisi della civiltà ad una terra che produce figli siffatti. Shaban Bey Gotsha sembra un eroe di altri tempi. Innanzi a lui si pensa a tutta la falange di agitatori che trassero dal servaggio la nostra Italia; si immaginano gli sforzi ch'essi facevano ramingando in esilio e invocando la libertà nazionale. Innanzi a Shaban Bey Gotsha si sente il malessere di appartenere ad una epoca priva d'ogni fede e d'ogni ideale. Quanti bagliori nello sguardo del giovane Albanese che sogna per la patria sua un'aurora di liberazione! La vittoria, la vittoria soltanto, coroni questo gran sogno!

(Da "Il progresso" italo americano) New York, 11 maggio 1907.

Një udhëheqes i rebelëve Shqiptarë në New York

(Vijon nga faqja 3)

- Në menyrë të veçantë nga Shqipëtarët e Italisë të shperndarë nëpër botë, që ne presim më shumë ndihmë. Ne jemi pak jashtë vëndit, sepse edhe fati krudel, bën që të preferojnë të fshihen nëpër male, gati për të mbrojtur integritetin e teritorit të tyre duke ndihmuar çështjen Shqipëtare në "Idenë nacionale". Italia jo vetëm bën një të mirë në tokën e të parëve, por eviton që nga ana tjetër e Adriatikut, p.sh. në Brindizi të valëvitet një ditë flamurin Austriak. Nuk mjafton vetëm vëndi i sunduar, por duhet të rezikojmë dhe ti lëmë kalim të lirë armikut shekullor, që as për së largu njihet dhe lejon hyrje të shqipëtarëve?

Cfarë duhet të bëjnë Shqiptarët në Amerikë?

- Ata duhet të organizohen, dhe të intensifikojnë propagandën kombëtare, të mbledhin të holla dhe armë për të ndihmuar rilindjen e përgjithshme. Duhet mbajtur gjallë në këtë tokë të lirë shpirtin për kauzën e shenjtë të lirisë së mëmëdheut, në mënyrë që Amerika dhe Evropa të mallëngjehen nga thirrja e dhimbshme që vjen nga Shqipëria. Duhet ti bëjmë të ditur botës që populli Shqiptar nuk ka vdekur: siç

ka lindur i lirë dhe krenar, kështu duhet të jetojë, dhe ai di të jetojë.

Në këtë pikë mbaron pjesa më e rëndësishme e intervistës në të cilën merte pjesë edhe një tjetër militant i çështjes Shqiptare: Pietro Skalione nga "Piana Dei Greci" që në Itali ka qënë nga propagandistët më aktivë dhe që në Amerikë do vazhdojë veprën e tij të shquar.

Shaban Bey Gotsha ka lënë mes nesh një mbresë shumë të thellë. Ehtë aq i fortë theksi që ky apostoll përshkruan çështjen e popullit të tij, është i tillë besimi që ai vë në të ardhmen e Shqipërisë, që ne me të vërtetë nuk mund të mos konfermojmë votën tonë, dhe të mos urojmë liri dhe gëzim në një tokë që nxier bij të tillë. Shaban Bey Gotsha duket si një hero i kohëve të shkuara. Kur flitet për të, mendojmë për të gjithë ata patriotë që nxorën nga ërrësira Italinë tonë: Imagjinojmë sakrificat që ata kanë bërë duke rrahur tej e mbanë nëpër emigracion në emër të lirisë kombetare. Përpara Shaban Bey Gotsha ndihet me keqardhje fatkeqesia që ai i përket një epoke e cila privohet nga çdo lloj besimi dhe ideali. Sa dritë në vështrimin e të riut Shqiptar që ëndëron për mëmëdheun e tij lindje e një aurore në liri! Fitorja dhe vetëm fitorja mund të kurorëzojë këtë ëndër të madhe!

(Nga "Il Progresso Italo - Amerikan". New York, 11 Maj 1907. (Perktheu: Ana Bisholla)

Gjuha e shkrimit Linear B është Gjuha Pellazge-Shqipe


(Vijon nga faqja 1)

Që shkrimi i përdorur në rrasat e Linearit B janë në gjuhën pellazgo-shqipe vërtetohet nga analiza e mëposhtme.

Shkrimi i quajtur Linear B ruhet në mbishkrimet me të njëjtin emër, shkrim i përdorur në Kretë para shekullit të 14 p.e.r. Shkrimi është i vizatuar në disa rrasa argjilore të pjekura, i gjetur në pallatet e Knosit në Kretës dhe në Pylli, pranë Mikenës, sepse në vendqetjen Pylli pranë Mikenës janë gjetur për herë të parë këto rrasa me mbishkrime të çuditshme, por që në vetvete përbëjnë thesar të madh gjuhësor për kulturën europiane.

Në rrasën nr. 7671 e paraqitur në fig. 23, kemi shenja mjaft të vjetra dhe të pa kuptueshme, por disa prej këtyre shenjave, duken mjaft qartë se ngjajnë me germat e përdorura në abecen pellazge dhe latine, që rrjedh prej saj.

Të tilla janë germat:



Germa të abecedarit pellazg janë të përmendura edhe nga N. Vlora si dhe nga J. G. Han.



Fig. 23 - Rrasa e shkrimit Linear B nga Mikenae
Fig. 23 - The tablet with linear B script from Mikenae

Le të analizojmë me kujdes tani njërin nga rrasat prej balte të pjekur dhe kopjen e saj të transkriptuar poshtë, të cilat ndodhen në Muzeun Arkeologjik të Athinës me nr. 7671. Që në vështrimin e parë, vëmë re se germat e përdorura janë mjaft të vjetra dhe jo të sakta si germat e sotme. Por këto germa i përkasin abeces pellazge. Kjo abece, sipas disa studiuesve N. Vlora (2004), Katapano (1984), Peza & Peza (2011, 2012), S. Hushi (2010) etj. është më e vjetra e njohur dhe e përdorur në Europë. Është po ai stil i germave, që kemi ndeshur edhe në shkrimin e kulturës pellazge Vinçë-Turdas, të përmendur më parë.

Një pjesë e germave të përdorura në këtë rrasë të Linearit B, për ne janë të pakuptueshme dhe kanë më shumë pamjen e germave vizatimore, ku një shenjë shpreh një fjalë ose rrokje. Por disa janë po ato germa dhe po ajo shprehje, që janë përdorur edhe në një shkrim tjetër, mjaft të qartë në gjuhën pellazge, por mjaft të më vonshëm se ai i Linearit B të Mikenës. Në anën tjetër të rrasës së dheut është paraqitur një luftëtar pellazg i veshur me fustanellën karakteristike pellazgo-ilire-shqiptare.

Në fragmentin e marrë nga rrasa e mësipërme e shkrimit të Linearit B lexojmë:

Lineari B, PELLAGJISHT
Drejtimi i leximit ←
TRANSKRIPTIMI I Z A I Z ←
SHQIP Zi asht Zi →

Sidoqoftë nga e gjithë kjo rrasë mjaft interesante dhe e kuptueshme kemi zgjedhur shprehjen, e përbërë nga germat I Z A I Z ← (lexoje mbrapsht), në transkriptimin e sotëm → Z I A Z I, e cila ndodhet në pjesën e sipërme të rrasës, në të majtë të lexuesit. I gjithë shkrimi është shkruar me mënyrën bustrofedike sa djathta ashtu edhe

	a	e	i	o	u
d	⊥	⊗	⊖	⊙	⊕
j	⊠	⊗	⊖	⊙	⊕
k	⊕	⊗	⊖	⊙	⊕
m	⊗	⊖	⊙	⊕	⊕
n	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
p	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
q	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
r	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
s	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
t	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
w	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕
z	⊖	⊙	⊕	⊕	⊕

Fig. 22 - Tingujt në shkrimin linear B, sipas Ventris dhe Caduik
Fig. 22 - Sounds of the linear B script, after Ventris and Caduik

majtas, por në këtë rast shprehja e përmendur është shkruar nga e djathta në të majtë. Të transkriptuar në gjuhën e sotme shqipe kjo shprehja e vjetër do të lexohej:

I Z A I Z (←) = (→) Z I A Z I = ZI asht ZI. Kjo shprehje kuptohet shumë qartë nga gjuha shqipe, përbën një pjesë të vajeve për një të vdekur në familje dhe sot do të thuhet: ZI ASHT ZI ose ZI dhe ZI.

Për ta bërë më të qartë leximin e kësaj pjesë të rrasës së më sipërme dhe më të besueshëm interpretimin e saj, që japin në këtë shkrim dhe që është shkruar në gjuhën pellazge (Peza & Peza 2009, le të bëjmë krahasimin e saj me një rrasë tjetër me mbishkrime tashmë të njohura në gjuhën pellazge, por me moshë më të re, të shekujve 9-8 dhe për rrjedhojë mjaft më e qartë (fig. 23).

Rrasa e gurit e paraqitur më poshtë, e cila quhet në shkencë Rrasa e Lemnit, është gjetur në Ujdhesën¹ e Lemnit, në hyrje të Ngushicës së Dardaneleve, në Detin Egje. Ky ishull, siç e përmend Herodoti, fillimisht ka qenë banuar nga pellazgët, që i kanë dhënë edhe emrin ishulli Lemni, i cili më vonë me pushtimin grek u quaj Lemnos. Rrasa e gurtë me mbishkrimin pellazg është gjetur në fshatin Kamin në ujdhesën e Lemnit nga pjesëtarët të Shkollës Arkeologjike Franceze të Athinës në vitin 1886 dhe është vendosur në Muzeun Historik të Athinës. Të dhënat për të janë botuar po këtë vit në buletin e kësaj shkolle. Sipas arkeologëve mendohet, që gdhendja në gur e tekstit të vajeve i përket shekujve 9-8 p.e.r., dhe jo shekujve 6-7 p.e.s., siç jepet në disa studime si N. Vlora 2004. Kjo është dokumentuar nga punimet arkeologjike në këtë rajon.

Mbishkrimi i Lemnit është shkruar me abecen pellazge dhe sot pranohet se është shkruar në gjuhën pellazge, pra në shqipen e vjetër. Fillimisht dijetarët provuan zbrërthimin e këtij mbishkrimi me ndihmën e gjuhës greke, latine dhe perse, por dështuan. J. Thomopulo, Z. Majani dhe N. Vlora me ndihmën e gjuhës shqipe bënë të mundur zbrërthimin e plotë të këtij mbishkrimi, që vërtetuan praninë e gjuhës shqipe në këtë mbishkrim.

Transkriptimin e saktë dhe të plotë të shkrimit të Rrasës së Lemnit e kemi dhënë më sipër bashkë me shpjegimet tona, por këtu poshtë po japim vetëm dy rreshtat e sipër të këtij mbishkrimi të mahnitshëm, që ka arritur në ditët tona.



Fig. 24 - Rrasa e Lemnit, gjetur në vitin 1886 në Ujdhesën e Lemnit në detin Egje.

Fig. 24 - View of the Lemnian Stela

Shkrimi në rrasën e Lemnit:

Drejtimi i leximit ←
←
ZI ASHT ZI MARAZ /hidhërim/ I MADH →

Duke krahasuar të dy këto shkrime të vjetra: shkrimin Linear B me atë të rrasës së Lemnit, vejmë re afërsi në mjaft drejtime. Rreshti i parë i shkruar në Rrasën e Lemnit është shkruar nga e djathtë në të majtë. Shkrimi i Rrasës së Lemnit, duke qenë më i ri, është shumë më i qartë për tu kuptuar. Shprehja e njëjtë: I Z A I Z ← = → Z I A Z I është shkruar në rreshtin e sipërm të Rrasës së Lemnit, po ashtu si dhe në Rrasën e Linearit B, të dhënë më sipër. Në Rrasën e Linearit B, po të lexojmë nga e djathta në të majtë rreshtin e sipërm të germave, vëmë re se germat e para janë të pakuptueshme, por në gjysmën e dytë të rreshtit të sipërm qartë lexojmë germat: I Z A I Z ←, fjalë që në transkriptimin e sotëm të shqipes do të shkruheshin: → Z I A Z I = ZI asht ZI.

Germa "I" dhe "A" të Rrasës së Mikenës kanë shtesa të vogla si pika dhe vijëza të vogla, në krahasim me germat në Rrasën e Lemnit, që janë më të thjeshta dhe më të afërta me germat e sotme të shqipes. Këto ndryshime, sigurisht rrjedhin nga fakti, që të dy shkrimet janë shkruar me diferencë kohore prej disa shekujsh njëra nga tjetra, por megjithatë janë fare të kuptueshme për ne sot.

Germa të përbashkëta midis dy rrasave: rrasës më të vjetër të shkrimit të Linearit B (rreth shekullit 14 p.e.r.) dhe asaj më të re të Rrasës së Lemnit (shekujt 9-8 p.e.r.) janë Z, A, I, TH, Y (me një ndarëse të shkurtër vertikale në pjesën e sipërme). Pjesa më e madhe e germave të përdorura në rrasën e Linearit B janë tani për tani të panjohura për ne, sepse më tepër kanë pamjen e shkrimit vizatimor.

Por shkrimi i mësipërm i fjalëve pellazge dhe shqipe I Z A I Z ← = → Z I A Z I = në gjuhën e sotme shqipe ZI ASHT ZI, vërtetohet që gjuha e shkruar në Linearit B është gjuha pellazge/shqipe. Ky shkrim përbën rastin tjetër të provuar të shkruar të gjuhës pellazge/shqipe.

Gjuha e përdorur në Qytetërimin e Mikenës gjatë periudhës së bronzit, që është zbuluar në veri të Peloponezit, përbën rastin e veçantë për nga vjetërsia e shkrimit të gjuhës pellazge/shqipe ndeshur deri më sot. Është hera e parë, që nga shkrimi Linear B vërtetohet fjalë të një gjuhe të lashtë dhe kjo është gjuha pellazge/shqipe (Peza 2009). Ky është zbulim mjaft i rëndësishëm shkencor, arritur gjatë studimit me vëmendjen më të madhe të rrasave argjilore, në të cilat është ruajtur ky shkrim i vjetër evropian. Gjuha pellazge e përdorur dhe e shprehur në këtë shkrim, është plotësisht e vërtetuar, si nga leximi në të i shprehjes pellazgo-shqipe I Z A I Z ← = → Z I A Z I ashtu edhe duke e krahasuar shkrimin e kësaj shprehje

edhe me një shkrim tjetër më të ri, siç është shkrimi në Rrasën e Lemnit, të cilat përkohë plotësisht mjaft qartë, që përbëjnë të njëjtin shprehje dhe të shkruar në të njëjtën gjuhë, gjuhën pellazge por në kohë të ndryshme.

Gjuha pellazge nga rrjedh gjuha shqipe, është gjuha e vjetër e përdorur në Ujdhesën e Kretës dhe në të gjithë vendin e quajtur Pellazgja. Siujdhesa e Ballkanit dhe ujdhesat e Detit Mesdhe, Azinë e Vogël dhe Afrika e Veriut, gjatë periudhës së bronzit, gjatë mijëvjeçarit të dytë p.e.r. Pas kësaj bëhet fjalë për periudhën, që në histori quhet nga disa dijetarë periudha e pushtimit dorian, për qenien e së cilës ka dyshime të forta, që përkon me kohën gjatë periudhës së fundit të bronzit fillimit të periudhës së hekurit. Dorët në vetvete nuk kanë bërë asnjë pushtim /invazion/, sepse kanë qenë pjesë e vetë komunitetit të atij vendi. Dorët kanë qenë njëri nga fiset më të shquara pellazge dhe përmenden nga Homeri në Kretë si dhe janë shquar si lundëtarët të shkëlqyer dhe ndërtues të mëdhenj. Sipas të dhënave të fundit, ata janë shquar gjatë fundit të mijëvjeçarit të dytë dhe fillimit të mijëvjeçarit të parë për ndërtimin e mjaft kolonive gjatë bregut të Detit Mesdhe dhe të mjaft kalave nëpër Ballkan si p.sh. kalaja e Dorzit në Pezë, një kala tjetër në afërsi të Librazhdit, që mban po të njëjtin emër.

Zbulimi i shprehjes pellazge/shqipe I Z A I Z ← = → Z I A Z I = ZI asht ZI në njërin prej rrasave të shkrimit të Linearit B është me rëndësi të madhe për shkencën në përgjithësi dhe për gjuhësinë tonë në veçanti. Me këtë njoftim vërtetohet me saktësi se në shkrimin Linear B të kohës së bronzit ndodhet shprehja e shkruar e gjuhës pellazge/shqipe dhe për rrjedhojë gjuha e përdorur në rajonin e Egjeut gjatë kohës së bronzit ka qenë gjuha pellazge/shqipe. Ky përfundim nuk është arritur në bazë të hipotezave të mundshme, por në bazë të gjetjes së shprehjes së saktë pellazge/shqipe në njërin nga rrasat e Mikenës. Njëkohësisht gjatë kësaj analize del e qartë se rrasat e Linearit B të Mikenës përbëjnë dokument mjaft të rëndësishëm për lashtësinë e shkruar të gjuhës pellazge/shqipe, rrjedhimisht në gjuhët evropiane. Kjo përkon në histori me periudhën e bronzit, përafërsisht në shekujt 16-12 p.e.s. Nga ana tjetër zbulimi i faktit, se shkrimi i Linearit B është në gjuhën më të vjetër evropiane pellazgo/shqipe, vërtetohet se edhe Qytetërimi i Mikenës, pjellë e të cilit ishte shkrimi Linearit B, i përket gjithashtu popullit pellazg.

Kështu rruga e gjatë e shkrimit të gjuhës shqipe, në bazë të dokumenteve që zotërojmë sot, do të përmbledhjet në zinxhirin e gjatë, ku hallkat kryesore janë:

- shkrimi në kulturën pellazge Vinçë-Turdas në Ballkanin Qendror gjatë mijëvjeçarit 6 p.e.s. (Peza & Peza, 2011, 2012),
- shkrimi Linearit A i Kretës para shekullit 16 p.e.s. (ende i pa deshifruar),
- shkrimi i Linearit B, shekujt 16-12 p.e.s. (L. & L. Peza, 2007, 2009),
- shkrimi në rrasën e Lemnit, shekulli 9-8 p.e.s., autorë të ndryshëm
- poemat epike të Homerit "Iliada" viti 750 p.e.s. (L. Peza 2006),
- poema epike e Homerit "Odhisea" viti 700 p.e.s. (L. Peza 2006),
- mbishkrimi Dipylon i Athinës i vitit 740 p.e.s. (Peza & Peza 2012),
- mbishkrimi i Korinthit shekulli 8 p.e.s. (Peza & Peza 2012),
- mjaft rrasa varresh gjetur në Durrës, Apoloni, Butrint, Itali etj. të shekujve 4 p.e.s. dhe fillimit të erës së re (N. Vlora 1984-1992),
- Mozaiku i Mesapikut, Vlorë, shekujt 6 (I. Mati & N. Stilo, 2005 etj.),
- Formula e Pagëzimit, nga viti 1462 dhe vazhdon më tej deri në ditët e sotme.

Por fillimet e zhvillimit të gjuhës pellazge-shqipe janë qysh gjatë periudhës së gurit të lashtë, gurlashtit. Kështu që del qartë se gjuha shqipe është gjuha më e vjetër evropiane e folur dhe e shkruar para të gjitha gjuhëve të tjera. Më pas zhvillohen gjuhët e tjera evropiane, të cilat në një farë mase gjatë formimit të tyre, janë ndikuar nga gjuha pellazge.

Dy librat më të vjetër, dy veprat letrare më të vjetra evropiane që kanë arritur në ditët tona janë: Iliada dhe Odhisea të Homerit, që përfaqësojnë tregime gojore, që kanë kaluar nga një brez tek tjetri, të formuluar me shkrim gjatë shekullit të 8-7 p.e.r. Fillimisht këto vepra u shkruan në gjuhën pellazge e nivelit të Rrasës së Lemnit. Kjo ishte gjuha e vetme në Ballkan dhe në rajonin e Egjeut gjatë kësaj kohe. Më pas, rreth shekullit të 4 p.e.r., ato u transkriptuan në greqishten e vjetër.

Për herë të parë botuar në gaz. Republika, dt. 2 dhjetor 2007

(Pjesë nga libri "DRITË E RE MBI PELLAZGËT DHE GJUHËN E TYRE")

¹ Ujdhesë apo ishull janë të dyja fjalë të gjuhës shqipe me origjinëpellazge, fjala Ishull= ish + uj, ka hyrë në shumë gjuhë perëndimore si isle (island), isola, ile, isla,

Persekutimi i martirëve..., qëndresë dhe shenjtëri

Nga VISAR ZHITI

...sulmi për shkatërrimin e tempujve të fesë nisi në 6 shkurt 1967, gjysmë shekulli më parë, në dimrin e diktaturës më të madhe në vendin më të vogël në të gjithë perandorinë komuniste.

Shqipëria kështu u shpall vendi i parë dhe i vetëm ateist në botë...

E them qysh në krye, kjo nuk ishte vepër e shqiptarëve, por e djallit, që krijoi një klimë urrejtje dhe persekutimi që ditën e parë kur u instalua diktatura si vazhdim ndryshe i Luftës II Botërore, që rrëronte vlera e godiste mbartësit e tyre.

Fëmënia e brezit tim kishte mbaruar kur sapo kishte nisur, kur na çuan në rresht për të parë se si më të mëdhenjtë, me hov revolucionar, te detyruar e të mashtruar, iu vërsulën kishave dhe xhamive dhe i prishën të gjitha. Disa i shndërruan në magazina ushtrie, në pallate sporti, kinema, kur dhe kinematë tona, me të mbaruar Lufta II Botërore, u përdorën për gjyqe politike, dënomin kundështarë ideologjikë dhe klerikë e ditur.

Kam parë se si dogjën Biblat, Kuranet, grumbujt e ikonave. Unë fsheha disa ikona nga kisha që u prish në rrethinë. Më thirrën në drejtori, më thanë t'i dorëzoj. Kujtoj oborrin e shkollës, një pastruese i çau me sopatë ato ikona, bëri në vandak me dru për sobën e mësuave.

Shqipëria ka qenë shumë e pasur me ikona mesjetare. E kuçja e Onufrit është famshme në botë. Sot në muzeun e ikonave në qytetin të Korçës, është dhe një Krisht gjithë vrima-vrima, jo se është brejtur nga koha, por janë vrime plumbash, të shpjegon ciceroni. Regjimi e kishte dhënë që të përdorej si tabelë qitjeje në stërvitjet ushtarake.

Diktatura, që dënonte dhe ikonat, mendoni si i ka dënuar besimtarët. Po klerikët vetë?

Kujtoj që gjyshi im lutej shpesh në errësirë gjatë mbrëmjeve, kurse nëna ime shante Stalinin si të ishte furxhiu i lagjes që ia kishte djegur bukën.

Gjyshi i një shoku tim ishte prift ortokoks e nuk lejohet më që të ishte prift e kishte dalë urdhëri t'i hiqin mjekrrat, s'lejoheshin për askënd se mund të maskoheshin agjentë të imperializmit dhe revizionizmit. Gjyshi i shokut tim nuk doli më nga shtëpia e tij, u vetburgos e nuk e hoqi mjekrrën. Shkonim në oborrin e shtëpisë së tij për ta parë, sa e gjatë ishte bërë, se gjë tjetër nuk kishim, as ekspozita.

Më pas unë munda të shkoj student në një qytet më të madh, në Shkodër, me kulturë veneciane, me tradita të forta kombëtare e katolike, nga kishin dalë poetë dhe heronj, ndërkaq tashmë të asgjësuar, por kujtoj ndonjë pedagog që na thoshte me mburrje se në ato auditore ishin bërë gjyqe të hapura e ishin dënuar priftërinj reaksionarë.

Do të dënoheshin katolikët e mëdhenj, nga ata që kishin studiuar në Itali e Europë, përkthyesit e Homerit dhe të Dantes, po dhe poetit kombëtar shqiptar, Padre Gjergj Fishta, françeskan, "Homeri i fundit në Ballkan, i propozuar nga amerikanët për çmimin Nobel, do t'i dënohej vepra e gjithë, së pari iu ndalua e burgosëshe po të flisje për të dhe meqënëse autori nuk jetonte më, varrin brenda në kishë ia prishën dhe eshtrat ia futën në një thes dhe ia hodhën në lumin Drin.

Në kohën kur isha student, kujtoj prapë që u dënua me burg një vajzë shumë e bukur, gjimnaziste, se mbante një kryq në qafë e besonte në Krisht. Më vonë atë vajzë do ta bëja personazhin kryesor të romanit tim, i botuar dhe në italisht "Il visionario alato e la donna proibita" e më kanë thënë se ajo, tani është emigrante në Itali.

Në burg, ku punonim si skllëvër në minierat primitive, gjeja kohë dhe rrija me priftërinjtë e burgosur, me Zefin e Kolecin, mësoja fshehurazi me ta italisht, aq sa mundej dhe flisnim për shenjtët, gjithmonë fshehurazi. Festoheshin fshehurazi festa fetare e bëhej fshehurazi dhe ndonjë pagëzim, që po të merrej vesh, edhe pushkatoheshin.

Aty ishte dhe një meshtar i heshtur, që pastronte tryezat e mencës së burgut dhe kur mundej, jepte ndonjë copë bukë fshehurazi, sidomos të rinjve, që kishin uri më shumë. Kishte bërë 17 vjet burg dhe do të pësonte akoma dënime të tjera. Ishte Dom Ernest Simoni Troshani, që vitin e shkuar Papa Françesku e shpalli kardinal.

Në burg, mes tmerrit flisnim dhe për tmerrin që kishin kaluar para nesh, së pari për t'i dhënë forcë e kurajo vetes, pastaj dhe për të mos harruar.

E nisën me Dom Lazër Shantoja, s'ishin bërë as 100 ditë që fitimtarët kishin marrë pushtetin dhe e pushkatuan. Esperantisti i parë shqiptar, autor shkrimesh të shumta, përkthyes i Gëtes, Shilerit, Leopardit, etj. Në fakt pushkatuan gjysmën e tij, se gjysmën e trupit ia kishin sharruar gjatë torturave.

Atë Anton Harapi, sociolog dhe autor romanesh, filozof, etj. Kur po e çonin në pushkatim, tekta ai kujdesej që zhguni të mos i bëhej me baltë, oficeri i tha, se baltë do të bëhesh dhe ti, kot e ruan... Dua të jem i pastër siç isha gjatë gjithë jetës, u përgjigji...

At Gjon Shllaku, duke pushkatuar atë, na dukej se vranë dhe tre universitetet e tij, ku qe lauruar, në Holandë, Belgjikë e Francë.

Vëllezërit Aleksandër Sirdani e Marin Sirdani, pasi i torturuan, i shëtiten të copërluar për të tmerruar njerëzit.

Vranë dramturgun Dom Ndre Zadeja... e mua më vjen turp të them: etj, etj, sepse janë jetë njerëzore, janë vepra, janë emra martirësh që ndriçojnë në terr...

Ndërkaq pushkatuan dhe klerikë të feve të tjera, një poet bektashian, Baba Ali Tomori.

Edha ata që vdiqën nëpër burgje, zëre se pësuan pushkatime të ngadalta, të përditëshme.

Dua të kujtoj priftin emblematic, shkrimatrin Ndoc Nikaj, që mori mësim në dy shkolla, në atë të fransëskanëve e të jezuitëve në vendlindje në Shkodër. Qysh i ri nisi të shkruajë letërsi fetare, shkencore, historike e politike e libra shkollorë. Ai është autori i romanit të parë shqiptar. Historia e letërsisë shqipe në diktaturë pranonte si të tillë një roman të tij patriotik, në fakt para tij është një tjetër roman, i shkruar po prej tij, I lënë në dorëshkrim, si shumë romane të tjerë të tij. "Marcja" titullohet, mbaruar në vitin 1889, por nuk e përmëndnin, ishte dënuar me heshtje, sepse ka subjekt fetar, ku gërshtohen bota reale me atë hyjnore, me personazhe biblike, Abrahami, Sara, Davidi, Marcja që e varrosin të gjallë se donte Krishtin, personazh është dhe papa me origjinë shqiptare, Klementi XI, etj.

Dhe ky "Balzak shqiptar", At Ndoc Nikaj, burgoset në vitin 1946 me akuzën se donte të përmbyste me dhunë pushtetin e komunistëve. Dhe ishte 82 vjeç kur e arrestuan. Mbas 5 vjetësh vdes në burg.

Tjetër fat pati kardinali i parë shqiptar, Mikel Koliqi, ndërkohë dhe muzikant i shquar. E kaloi gjithë jetën burgjeve dhe internimeve, 45 vjet në baltë. Në fshatin ku punonte si rob, në qendër, në një pemë ishte vënë një altoparlant që natë e ditë transmetonte propapagandën e çmendur të partisë në pushtet, por të dielave paradite, një Zot e di se pse, transmetonte një orë muzikë klasike, Bah, Mozart, Bethoven, Verdi dhe ai, prift Koliqi, e kishin parë tek dilte i vetëm, edhe në dimër, mes shiut për të dëgjuar paksa muzikë klasike. Dhe mërmëriste lutje Zotit...

Dhe nga lutjet tona, besoj, ra perandoria komuniste ra. Nga nga qendresa jonë, nga përpjekjet tona me martirët në krye.

Ishte Papa Gjon Pali II, ai që e emëroi Kardinal Mikel Koliqin, atë që dëgjonte muzikë në shi, që sigurisht nga qielli i vinte dhe një muzikë tjetër ajo hyjnorja, që e dëgjonte vetëm ai.

Ndërsa Papa Françesku, nga i cili kam patur fatin ta dëgjoj dhe vetë të më thotë: "E dua shumë Shqipërinë", kur erdhi në Tiranë, na porosi të gjithëve: "Mos harroni plagët..."

(Vijon në faqen 13)



La persecuzione dei martiri resistenza e santità

di VISAR ZHITI

...l'attacco per la distruzione dei templi della fede iniziò il sei febbraio mille novecento sessanta sette, mezzo secolo or sono, nell'inverno della dittatura più grande nel paese più piccolo di tutto l'impero comunista.

L'Albania così si proclamò il primo e l'unico paese ateista al mondo.

Lo dico sin d'ora, che questa non fu opera degli albaesi, ma del diavolo, che creò un clima di odio e persecuzione dal primo giorno quando si installò la dittatura come un proseguito alternativo alla Seconda Guerra mondiale, che calpesta valori e colpiva i loro portatori.

E così siamo cresciuti nell'odio, nella lotta di classe, con il respiro del diavolo.

L'infanzia della mia generazione era già finita quando era ancora al suo inizio, quando ci portarono in fila per farci vedere come i più grandi,

con impeto rivoluzionario, obbligati con inganno, si avventarono contro le chiese e le moschee e le abbatterono tutte. Alcune vennero trasformate in magazzini militari, in palestre sportive, in cinema, allorché anche i nostri cinema, alla fine della Seconda Guerra Mondiale, venivano adoperati per i processi politici, per condannare gli oppositori dell'ideologia e i chierici istruiti.

Ho visto bruciare le Bibbie, i Corani, cumuli di icone. Io ho nascosto alcune icone della chiesa distrutta nei dintorni. Venni convocato dalla direzione e mi imposero di consegnarle. E ricordo che nel cortile della scuola, un'addetta alle pulizie distruggeva quelle icone con un'accetta, ne faceva un fascio di legna per la stufa degli insegnanti.

L'Albania era ricca di icone medievali. Il rosso di Onufri è celebre nel mondo. Oggi nel Museo delle icone a Korça, c'è anche un'immagine di Cristo tutta buchi e non perché rosa dal tempo, ma perché perforata dai proiettili. Il regime l'aveva data come tirassegno per le esercitazioni militari.

La dittatura, che condannava le icone, pensate come ha condannato i credenti. E i chierici?

Ricordo che mio nonno pregava spesso nell'oscurità della notte, mentre mia madre malediceva Stalin come fosse il fornaio di zona che le aveva bruciato il pane.

Ricordo che il nonno di un mio amico era un prete ortodosso, quando non era più permesso essere prete, ed era venuto l'ordine di tagliarsi la barba; nessuno poteva portare la barba, vi si potevano mascherare agenti dell'imperialismo e del revisionismo. Il nonno del mio amico non uscì più di casa, si autocondannò al carcere e non si tolse la barba. Andavamo nel cortile della sua casa per vederlo, per vedere quanto fosse diventata lunga la sua barba, perché non avevamo divagazioni alternative né esposizioni.

In seguito, da studente, ebbi la possibilità, non data a tutti, di trasferirmi in una città più grande, a Scutari, città dalla cultura veneziana, dalle forti tradizioni nazionali e cattoliche. Proprio da questa tradizione cattolica, poi annientata, nacquero poeti ed eroi. Eppure ricordo che qualche cosiddetto professore ci diceva con orgoglio che in quelle aule si erano tenute sessioni giudiziarie aperte al pubblico, che avevano condannato preti reazionari.

Si sarebbero condannati grandi cattolici, persone che avevano studiato in Italia e in Europa, traduttori di Omero e di Dante, ma anche poeti nazionali albanesi, il francescano Padre Gjergj Fishta "L'ultimo Omero dei Balcani", candidato dagli Americani al Premio Nobel, la cui opera sarebbe stata condannata in blocco, con minaccia di carcerazione per chi ne parlasse, anche se l'autore non era più in vita, la sua tomba dentro la chiesa era stata distrutta e le sue ossa, messe in un sacco, erano state gettate nel fiume Drin.

Quando ero studente, ricordo ancora che venne condannata al carcere una ragazza molto bella, una liceale, perché portava una croce al collo e credeva in Cristo. In seguito avrei scelto quella ragazza

come la protagonista del mio romanzo pubblicato anche in italiano con il titolo "Il visionario alato e la donna proibita" e mi hanno detto che ora lei è emigrata in Italia.

In prigione, dove lavoravamo come schiavi nelle miniere primitive, trovavo il tempo di incontrare preti carcerati, Zef e Kolec, con i quali studiavo di nascosto l'italiano, per quanto era possibile, e parlavamo dei santi, sempre di nascosto. Di nascosto si celebravano le festività religiose e qualche battesimo, che se si fosse venuto a sapere, correavano il rischio della fucilazione.

Li vi era anche un sacerdote silenzioso, che puliva i tavoli della mensa dei carcerati e quando poteva, dava qualche pezzo di pane di nascosto, specialmente ai giovani che avevano più fame. Aveva già subito 17 anni di galera e li sarebbero ancora inflitte altre pene. Era Don Ernest Simoni Troshani, che a Novembre ultimo scorso Papa Francesco lo creò cardinale.

In galera, in mezzo all'orrore parlavamo degli orrori subiti dai nostri predecessori, in primis per dare forza e coraggio a noi stessi, e poi per non dimenticare.

Incominciarono con Don Lazër Shantoja, non erano passati nemmeno 100 giorni da quando i vincitori avevano preso il potere, e lo fucilarono. Il primo cultore albanese dell'esperanto, autore di molti scritti, traduttore di Goethe, Schiller, Leopardi, ecc... In realtà, fucilarono solo una metà del suo corpo, avendo segato l'altra metà durante le torture.

Padre Anton Harapi, sociologo e autore di romanzi, filosofo, ecc. Quando lo stavano conducendo alla fucilazione e si preoccupava che la tonaca non s'infangasse, l'ufficiale gli disse che si sarebbe infangato anche lui, inutile preoccuparsene... Voglio essere pulito come sono stato per tutta la vita, gli rispose...

Padre Gjon Shllaku... Quando lo fucilarono, sembrava che fucilassero insieme tre università, dove si era laureato, in Olanda, in Belgio e in Francia.

I fratelli Aleksandër Sirdani e Marin Sirdani, dopo averli torturati li portavano in giro stritolati per terrorizzare le gente.

Uccisero il drammaturgo Don Ndre Zadeja...

E mi vergogno di dire ecc., ecc., perché si tratta di vite di uomini, si tratta di opere, si tratta di nomi di martiri che risplendono tra le tenebre...

E intanto fucilarono anche chierici di altre religioni, un poeta bektashi, Baba Ali Tomori.

Anche la morte in prigione di altri detenuti, per quanto non di fronte a un plotone di esecuzione, non è stata che una fucilazione lenta, giornaliera.

Voglio ricordare il sacerdote emblematico, lo scrittore Ndoc Nikaj, che aveva studiato in due scuole, dai francescani e dai gesuiti in patria, a Scutari. Fin da giovane si era dedicato a scrivere opere di letteratura religiosa, scientifica, storica e politica, nonché testi scolastici. È l'autore del primo romanzo albanese. La storia della letteratura albanese nel periodo dittatoriale riconosceva come tale un suo romanzo patriottico; in realtà c'è un altro romanzo prima di questo, scritto sempre da lui, lasciato manoscritto, come altri suoi romanzi. S'intitola "Marcja", terminato nel 1889, ma non veniva ricordato, condannato al silenzio, perché di argomento religioso, intrecciato di vita reale e vita celeste, di personaggi biblici, Abramo, Sara, David, Marcja sepolta viva perché amava Cristo; tra i personaggi anche un papa di origine albanese, Clemente XI, ecc...

E questo "Balzak Albanese", Padre Ndoc Nikaj, viene imprigionato nell'anno 1946, con l'accusa che voleva abbattere con violenza il potere dei comunisti. E aveva ottantadue anni quando lo arrestarono. Dopo cinque anni morì in prigione.

Altro destino toccò al primo cardinale albanese, Mikel Koliqi, tra l'altro illustre musicista. Passò tutta la vita tra prigionieri e internamenti, quarantacinque anni nel fango. Al centro del villaggio dove lavorava come uno schiavo, su un albero era collocato un altoparlante che notte e

(segue a pagina 13)

Scoperto anno di nascita del poeta albanese sangiorgese Giulio Variboba

Di COSMO LUDONE

La ricerca dello scrittore - giornalista Cosmo Laudone, arbereshe di San Giorgio Albanese in provincia di Cosenza, non finisce mai di stupire. Presidente emerito della pro loco sangiorgese "Jul Variboba", nonché autore di decine di pubblicazioni, il Cavaliere dell'Ordine al Merito della Repubblica Italiana, Cosmo Laudone, ha rintracciato importanti fonti documentali presso archivi pubblici e privati sulla comunità di appartenenza. Conoscitore profondo dello scrittore di lingua albanese, Giulio Variboba, dopo aver scoperto nel 1977 l'atto di morte del poeta, risalente al 1788, pubblicato in L'atto di morte di Giulio Variboba, 1977, Ludone Cosmo, ha rinvenuto di recente anche la data di nascita che risale al 16 aprile 1725.

L'importante scoperta si può desumere dalla documentazione sotto riportata:

- Ritratto eseguito con la tecnica dell'incisione a bulino di D. Giulio Variboba del 1756, recante la scritta "Rev.mo D. Giulio Variboba del Ven. le Collegio Italo Greco Corsini in S.cto Benedetto de Ullano in Provincia di Calabria Citra"

Dopo l'intestazione del titolo, nella parte centrale abbiamo la data di nascita: "Natus die 16 Aprile 1725". La lastra al bulino venne incisa da Giuseppe Vasi in Roma nel 1756, come si può leggere sul lato destro e sinistro, subito dopo il rigo intestativo della nascita. Il ritratto è appartenuto al Collegio di Sant'Adriano in San Demetrio Corone, proveniente con certezza dall'archivio del Collegio Corsini di San Benedetto Ullano (1734-1794), rintracciato oggi giorno in famiglia privata a San Demetrio Corone (Cs).

I dati sopra riportati vengono confermati da altri due fonti documentali.

- Il catasto onciario dell'Università di San Giorgio in Corigliano del 1743, nel distretto di Rossano, custodito presso l'Archivio di Stato di Napoli (Regia Camera della Sommara. Patrimonio Catasti onciari, nr. Busta 9072, f. 148r), dove risulta che nella rivela degli "Ecclesiastici cittadini secolari", presentata da D. Giovanni Arciprete Variboba di anni 59, sono compresi Francesca Minisci, moglie di anni 50 e Giulio, giglio chierico di anni 18, abitanti "in casa propria sita nella contrada delli Variboba" e confinanti con la casa di Martino Variboba...".

- Si evince chiaramente che il figlio dell'arciprete D. Giovanni Variboba, il chierico Giulio Variboba, di anni 18, nacque nel 1725, essendo il Catasto onciario di S. Giorgio in Corigliano ultimato nel 1743, come risulta sul frontespizio del Catasto in questione.

- Parte della rivela di D. Giovanni Arciprete Variboba (Ecclesiastico cittadino secolare), come si può ricavare dal Catasto onciario dell'Università di San Giorgio in Corigliano del 1743, custodito presso l'Archivio di Stato di Napoli (Regia Camera della Sommara-Patrimonio Catasti onciari, nr. Busta 9072, f. 148r).

Ritratto di "D. Giulio Variboba della Terra di San Giorgio in Corigliano, ecclesiastico in Roma". Sottostante, possiamo leggere la data di nascita, espressa in caratteri romani: "Natus die XVI Aprile MDCCXXV"



La lastra al bulino di Giulio Variboba, incisa da Giuseppe Vasi nel 1756. (Cosmo Laudone)

Anche questo ritratto apparteneva al Collegio di Sant'Adriano e dalle prime notizie certe in nostro possesso, è appartenuto insieme ad altri dipinti allo scrittore albanese Luigi Gurakuqi (1879-1925), all'epoca dei suoi studi nel collegio italo - albanese di San Demetrio Corone (1897). Altre fonti documentali in merito, saranno rese note quanto prima a conferma della straordinaria scoperta che pone fine e mette in luce la questione dell'anno di nascita di uno dei più grandi poeti della letteratura albanese.

La conferma della datazione sopra riportata, si può evincere in parte, anche dalle ricerche inedite compiute dallo storico Vincenzo Librandi di Vaccarizzo Albanese, autore dei primi due volumi "Vacarici: Vaccarizzo Albanese: genesi storica di una comunità, Famiglie, avvenimenti e luoghi della memoria".

In un atto notarile del 27 ottobre 1739, dallo scrittore rintracciato, che ringraziamo per la gentile concessione, è riportato "la donazione, da parte del padre sacerdote, a Giulio Variboba, di vari fondi agricoli e di una casa" in procinto di "conseguire la prima tonsura". La tonsura solitamente veniva ricevuta a 14 anni, come emerge anche da un altro atto del 1829 rinvenuto dal Librandi, quando un certo Nicola Masci di Michele, alunno del Collegio di Sant'Adriano, nato nel 1815, riceveva a 14 anni la chierical tonsura (1). Emerge, quindi chiaramente, da tale documentazione, stabilire nel 1725 l'anno di nascita di Giulio Variboba.

Tratto da Vincenzo Librandi: VAKARICI: Vaccarizzo Albanese: genesi storica di una comunità. Famiglie, avvenimenti e luoghi della memoria, vol. 5 (1759- 1763) inedito.

Ritratto di "D. Giulio Variboba della Terra di S. Giorgio in Corigliano, ecclesiastico in Roma", nato il 16 Aprile 1725. (Cosmo Laudone).

Persekutimi i martirëve..., qëndresë dhe shenjtëri

(Vijon nga faqja 12)

Janë shumë. E pamundur të rrëfihen të gjitha dhe koha nuk do të mjaftonte.

Lejomëni të tregoj së fundmi dhe një torturë.

Fol, i bërtisnin në qeli dom Mark Hasit, fol! Pse hesht? S' do të flasësh? Lidhëni, nxirrjani gjuhën me zor, - ulëriu shefi i policies... Ia di emrin, por nuk meriton t'ia permend, djalli vetë ishte.

Shtrijani mbi tryezë gjuhën, fort, ashtu mbajani, se s' do që të flasë. Dhe... dhe, ah! Nguli thikën e tij mbi të.

Ku?

Mbi gjuhë. Po, po, ashtu bënë. Thika dridhej, por jo dora e djallit... dhe gjaku i ngrohtë rridhte.

Këtë torturë nuk ia kishin bërë askujt. Vetëm një prifti. Përveç të tjerave, ishte urrejtja e diktaturës kundër gjuhës liturgjike shqipe, të lashtë dhe të bukur, se kishte filluar gjuha e diktaturës, e ashpër dhe vrastore.

Në Shqipëri, që kishte më pak se 3 milion banorë, gjatë epokës së diktaturës komuniste, në harkuan kohor 1944-1991:

U pushkatuan me gjyq e pa gjyq 5.577 burra, 450 gra, ndërsa 998 burra dhe 45 gra vdiqen në burgjet politike. Ende nuk u dihen varret.

308 veta u çmendën nga torturat çnjerezore. Por

jo vetëm ata...

50.000 familje u internuan, ku 7.022 njerëz vdiqën në atë baltë.


Sipas studimeve të deritanishme del se në çdo "tri ditë" një shqiptar ekzekutohej me ose pa gjyq si "armik i popullit dhe partisë". Çdo javë një "i burgosur politik" vdiste në burg. Çdo dy ditë internoheshin tre persona për motive politike.

Sipas një llogarie timen, në Shqipërinë e diktaturës, shqiptarët bënë rreth 914.000 vite burg dhe 256.146 vite internim, pra më shumë se 10 mijëvjeçarë vuajtje dhe martirizim. Është e pabesueshme dhe marrameëndëse. Kërkoj ndjesë për tmerrin që solla, me këtë statistikë nga ferri i dikurshëm mbi tokë.

Por tani plagët janë bërë pasuri jonë, diamantet tanë. U ngajnit plagëve të Krishtit. Dhe ashtu si Krishti, edhe Kisha jonë katolike në Shqipëri tashmë është ringjallur...

Djali është prapsur.

Qiriri i besimit, që nuk u shua kurrë në shpirtin e shqiptarëve, duke ndezur zemër për zemër, tani është zmadhuar në një ditë të madhe për të gjithë. Ja, 38 martirë nga tanët u lunturuan vitin që shkoi, ndërsa mbi kryet e Nënë Terezës tonë vezullon aureola e shenjtës. Po bie ditë tjetër e re nga Qielli për ne. Amen!



L'atto di morte di Giulio Varibobba

Nella chiesa parrocchiale di S. Giorgio Albanese si conserva un ritratto del Varibobba con la seguente scritta: D. Giulio Varibobba, sacerdote italo - greco della terra di S. Giorgio, diocesi di Rossano, morto di apoplessia in Roma e un età di anni 64 il dì 31 dicembre 1788 nella ven. chiesa di S. Maria sopra Minerva dell'Ordine de' Predicatori, dopo aver recitato il SS. Rosario e aver ricevuta la benedizione del SS. Sacramento.

Nei due studi più recenti sul nostro personaggio sono stati riferiti questi dati, ma è stato osservato che non esistono documenti sicuri sulla sua data di morte del Varibobba. Veramente la didascalia del ritratto è molto circostanziata e non v'è motivo di metterne in dubbio il contenuto senza una ragione valida. E che quella data e quei particolari erano veri sono ora confermati dall'atto di morte che qui appresso pubblichiamo.

Il ritrovamento di questo documento è tutto merito del signor Cosmo Laudone, anch'egli di S. Giorgio Albanese, che da qualche tempo s'è dedicato allo studio delle figure più rappresentative del suo paese. Naturalmente il primo appuntamento è stato con D. Giulio Varibobba e, avendo appreso che il poeta era morto nella chiesa romana di S. Maria sopra Minerva, vi si è recato con la speranza di rintracciare più ampie notizie in merito, magari coadiuvato da qualcuno dei Padri domenicani che officiano la chiesa. Per la verità non vi ha trovato niente come, del resto, era capitato ad altri che prima di lui vi erano andati con lo stesso scopo. I suggerimenti, però, ricevuti l'hanno indotto a rivolgere altrove le sue ricerche e questa volta con esito positivo.

Nell' archivio del Vicariato di Roma sono

conservati i libri appartenuti alle parrocchie soprese della città ed è precisamente in uno di questi, proveniente dall'ex parrocchia di S. Francesco di Paola ai Monti, che viene registrata la morte del Varibobba avvenuta alla data e nelle circostanze sopra indicate.

Con molta probabilità il Varibobba s'era recato alla chiesa di S. Maria sopra Minerva per partecipare alla funzione vespertina di ringraziamento alla chiusura dell'anno che si svolgeva con solennità nella cappella del SS. Mo Salvatore. E qui, durante la cerimonia, verso le ore 16,45 (= alle ore 23 e 30 del documento) avvenne la repentina conclusione di una travagliata ed amara esistenza. Il giorno ed anno successivo il cadavere veniva trasportato e seppellito nella chiesa dei Santi Sergio e Bacco, detta anche di S. Maria del Pascolo.

Liber mortuorum ab anno 1787 usque ad an. 1802, p. 73.

December 1788. Anno Domini 1788 die 31 decembris, hora 23 cum dimidio: R. D. Julius Varibobba, sacerdos huius parochiae aetatis suae an. 63, orans in ecclesia S. Mariae supra Minervam ante Sanctissimi Salvatoris immagine repentina morte correptus cessit in humanis agere, sacramentali absolute et sacri olei unctione refectus. Eiusdemque cadaver sequenti die, scilicet prima januarii 1789 fuit delatum de proprii parochi S. Francisci de Paula benigna permissione ad ecclesiam S. Maria de Poscolo PP. Ruthenorum S. Basilii Magni absque ulla nec minima parochialium jurium laesione, sed votis annuus Rectoris illius laci, in eiusdem ecclesia fuit expositum, humatum, inique expectat universae carnis resurrectionem.

(Arch. Del Vicariato di Roma, Parrocchia di S. Francesco di Paola, vol. VIII)

La persecuzione dei martiri resistenza e santità

(Vijon nga faqja 12)

giorno trasmetteva l'insensata propaganda del partito al potere, ma la domenica mattina, dio sa perché, trasmetteva musica classica, Bach, Mozart, Beethoven, Verdi ed egli, il prete Koliqi, era stato visto uscire solo, anche d'inverno, sotto la pioggia per ascoltare un po' di musica classica. E mormorava preghiere a Dio...

E per le nostre preghiere, credo, è caduto l'impero comunista. Per la nostra resistenza, per i nostri sforzi, con i martiri in prima fila.

Era stato il Papa Giovanni Paolo II a nominare cardinale Mikel Koliqi, colui che ascoltava la musica sotto la pioggia, e certamente dal cielo gli veniva un'altra musica, la musica celeste, che sentiva solo lui.

Mentre Papa Francesco, che ho avuto la fortuna di sentire personalmente dirmi "Amo molto l'Albania", quando venne a Tirana, raccomandò a tutti: "Non dimenticate le piaghe..."

Permettetemi di raccontarvi in ultimo anche un'altra tortura.

Parla, urlavano dentro la cella a Don Mark Hasi, parla! Perché taci? Non vuoi parlare? Legatelo, tiratelo fuori a forza la lingua, - urlava il capo della polizia... Conosco il suo nome, ma non merita di essere qui ricordato, il demonio in persona era.

Allungategli la lingua sul tavolo, forte, tenetelo così, che non vuole parlare. E... e, ah! Infilò il suo coltello su di essa.

Dove?

Sulla lingua. Sì, sì, così fecero. Il coltello tremava, ma non la mano del demonio... e il sangue caldo sgorgava.

Questa tortura non l'avevano mai praticata sugli altri. Solo ad un sacerdote. Oltre tutto, era l'odio della dittatura contro la lingua liturgica albanese, antica e bella, perché era ormai cominciata la lingua della dittatura, aspra e assassina. Sono

molte. Impossibile parlare di tutte, non ci sarebbe tempo sufficiente. Ho ricordato soltanto alcuni nomi, davanti ai quali ci inchiniamo tutti. In Albania, che aveva meno di tre milioni di abitanti, nel corso della dittatura comunista, nell'arco di tempo 1944-199:

- Vennero fucilati con processo o senza processo 5.577 uomini, 450 donne, mentre 998 uomini e 45 donne morirono nelle carceri politiche. Ancora non si sa dove queste persone siano sepolte.

- 308 persone, a causa delle torture disumane, persero la ragione. E non soltanto loro...

- 50.000 famiglie vennero internate, e 7.022 persone morirono in quel fango.

- Dagli studi fatti finora emerge che ogni tre giorni un albanese veniva giustiziato, con o senza processo, come "nemico del popolo e del partito". Ogni settimana un "prigioniero politico" moriva in prigione. Ogni giorno venivano internate tre persone per motivi politici.

- Secondo un mio calcolo, nell'Albania della dittatura, gli Albanesi hanno fatto 914.000 anni di prigione e 256.146 anni di internamento, cioè oltre un milione di tormenti e martirio. Una cosa incredibile e sbalorditiva. Chiedo scusa per il terrore che ho causato con questa statistica dall'inferno che c'era una volta sulla terra.

Ma ora le piaghe sono diventate la nostra ricchezza, i nostri diamanti. Assomigliano alle piaghe di Cristo. E come Cristo, anche la nostra chiesa cattolica in Albania ormai è risorta...

Il diavolo si è arretrato. Il lume della fede, che non si spense mai nell'animo degli albanesi, accendendosi cuore a cuore, è diventato ormai grande luce per tutti. Ecco, 38 martiri dei nostri vennero beatificati l'anno scorso, mentre nel capo della nostra Madre Teresa risplende l'aureola della santità.

Luce nuova sta scendendo dal Cielo per noi. Amen!

Mbi druidët, druidizmin dhe kuptimin e emrit “druid”

Nga BUJAR KULE

Të dhënat mbi Druidët janë të pakta dhe vijnë tërësisht nga autorë heleno-romakë.

Pjesën më të madhe të këtyre të dhënave i kemi nga Gaj Jul Çesari (100 – 44 p.e.s.), i cili, në librin “Lufta Galike” do të përshkruante rrjedhën e ngjarjeve dhe përshtypjeve që përjetuan legjionet romake që ai komandonte, gjatë ekspeditës ushtarake për pushtimin e Galisë. “Në Cali janë dy, grupet e njerëzve më të rëndësishëm të cilët nderohen më shumë se të tjerët. Njëri prej tyre është ai i druidëve dhe tjetri ai i kalorësve. Druidët janë ruajtësit e besimit dhe si të tillë, kryejnë ceremonitë e kurbanëve publike dhe atyre private dhe u japin shpjegime çështjeve të ndryshme që lidhen me besimin e tyre, arsye kjo, për të cilën, një numër i madh të rinjsh mblidhen rreth druidëve për të marrë mësimë Thërritën (Druidët!) për të dhënë gjykimin e tyre mbi të gjitha konfliktet publike dhe private dhe nëse kryhet ndonjë krim, vrasje, nëse lind ndonjë kundërshti në lidhje me trashëgiminë e pasurive apo mbi ndarjen e tokave, janë sërishmi druidët ata që duhet të vendosin mbi dënimet apo vlerën që duhet paguar për fajin e kryer.” (Gaj Jul Çesari, “Lufta e Galisë” VI, 11 – 15)

Sipas Gaj Jul Çesarit, Druidët besonin në pavdekësinë e shpirtit që pas vdekjes së trupit në të cilin strehohet, emigron apo gjente strehë në një trup tjetër. Për këtë arsye, Druidët mendonin se ishte e kotë, e gabuar dhe e palogjikshme t'i frikësoheshe vdekjes. Gjithashtu, Druidët u jepnin mësimë të rinjve edhe mbi natyrën, yjet dhe lëvizjen e tyre në qiell, mbi madhësinë e universit dhe të tokës sa dhe mbi esencën dhe pushtetin e hyjnive. Straboni (64 p.e.s – 24 e.s) në “Geographia” i përmend Druidët si një nga tre grupet e njerëzve, të cilët ndër fiset kelte nderoheshin më shumë se askush tjetër... “Në të gjitha fiset janë tre grupe njerëzish të cilët nderohen më shumë; Bardët, Vatët dhe Druidët. Bardët janë këngëtarë dhe poetë, Vatët lexojnë të ardhmen me ndihmën e kurbanëve kushtuar hyjnive, ndërsa Druidët, studiojnë shkencat e natyrës dhe filozofinë e moralit. Këta (Druidët!) konsiderohen si më të drejtët mes njerëzve dhe si rrjedhojë atyre iu besohen zgjidhjet e problemeve që shqetësojnë individët apo të gjithë bashkësinë...” (Strabone Geographia, IV, 2, 4.)

Mungesa e informacioneve mbi Druidët dhe mbi besimin fetar të fiseve kelte, besim fetar ku kryerja e ceremonive ishte e lidhur ngushtë me emrin e Druidëve, do ta përqendronte ndër shekuj vëmendjen e studiuesve të historisë në dy drejtime, apo më saktë, në përpjekjen për t'iu përgjigjur dy pyetjeve kryesore....

Cili ishte kuptimi i emrit “druid”?

Cili kishte qenë qëndrimi i shtetit romak ndaj Druidëve dhe deri në çfarë mase ky qëndrim, kishte ndikuar në zhdukjen e Druidëve dhe Druidizmit, pra, të besimit dhe traditës kulturore që mbartnin Druidët? Plini Plak në “Historia e natyrës” (libri XVI), do ta lidhte emrin “druid” me fjalën “drus” që në dialektet e greqishtes antike do të thoshte “lis”, duke shpjeguar se për Druidët, lisi ishte një pemë e shenjtë. Gjuhëtarët dhe historianët modernë do të përipiqeshin ta gjenin kuptimin parësor të emrit “druid” (druwid) tek prapashtesa “wid” e cila në të gjuhën sanskrite (e konsideruar nga gjuhëtarët akademik si gjuha më e ngjashme me hipotetiken “gjuhë nënë” indoevropiane) do të thoshte “shikoj” apo “dituri”, fjalë e gjuhës sanskrite e cila në latinisht do të shfaqej në formën “videre” – “shikoj” dhe në gjermanisht në formën “wissen” – “dituri”, duke arritur në përfundimin se; “dru-wid” do të thoshte “dituria e lisi” apo ndoshta “forcë (e simbolizuar nga lisi) dhe dituri”, kuptime këto që do ti shtynin etimologët të pohonin që kuptimi parësor i emrit “druid” ishte “ata që dinë gjithçka”. Sigurisht, nëse etimologët dhe historianët të cilët për shekuj ishin munduar të zbulonin e kuptimin të emrit “druid” do të kishin njohur gjuhën shqipe, do të zbulonin se thesari i fjalëve të kësaj gjuhe e cila pa hezituar mund të cilësohet më e mistershme sa edhe më e pastudiuara ndër të gjitha gjuhët e quajtura indoevropiane, do t'i dhuronte lehtësisht dhe në një mënyrë krejtësisht të natyrshme dhe të logjikshme kuptimin parësor të emrit “druid”. Në thesarin e fjalëve të gjuhëve shqipe, gjejmë si fjalën “dru” e cila dëshmonte që hipoteza e Plinit mund të ishte krejtësisht e vërtetë, ashtu edhe fjalën “tru”, që në formën “truid” i dhuronte një shpjegim krejtësisht të kënaqshëm edhe kuptimit parësor që gjuhëtarët dhe historianët modernë do t'i jepnin emrit “druid”... “Ata që dinë gjithçka!” Mos ndoshta midis të gjitha këtyre versioneve kuptimore

të emrit “Druid” ekzistonte një lidhje e ngushtë? Mos ndoshta kuptimi i ngjashëm që i dhuronin emrit “Druid” gjuhë të folura nga popuj të ndryshëm të Evropës antike dëshmonte për ekzistencën aq të përfolur të një kulturi të besimit në një “dru” të shenjtë që ishte në gjendje të dhuronte diturinë?

Lidhja e ngushtë e ekzistencës së Orakullit të Dodonës me atë të një lisi apo të një pylli lisash të shenjtë në mitet pellazge, qenësia në mitet skandinave e “Yggdrasilit” dhe në mitet gjermane e “Irmisuli” të përmendura si pemë (me shumë gjasa pemë lisi) që u dhuronin heronjve të miteve të sipërpërmendur diturinë e së shkuarës dhe të së ardhmes, dëshmonin për ekzistencën e këtij kulturi antik dhe për përhapjen e tij nga brigjet e Mesdheut deri në Skandinavi dhe Britani. Çfarë dëshmonte ekzistenca dhe përhapja e këtij kulturi antik? Mos ndoshta për qenësinë e një qytetërimi evropian i cili kishte paraprindër në kohë lindjen e qytetërimeve helene dhe romake? Cili ishte emri i këtij qytetërimi?

Cili ishte emri i popullit apo i fiseve që e kishin përhapur këtë qytetërim nga brigjet e Mesdheut në mbarë Evropën? Dukej se këto pyetje do të ngeleshin pa përgjigje deri kur gjuhëtarët dhe historianët do të vazhdonin të injoronin studimin e gjuhës shqipe dhe zbulimin e historisë së saj, duke nënvlehtësuar kështu, edhe mundësinë që pikërisht në këtë gjuhë, të fshihej ajo, “hallka e humbur”, zbulimi i së cilës do të mundësonte së fundmi shkrimin e plotë dhe bindës të historisë së gjuhëve të popujve evropianë.

Edhe pse, përgjithësisht, shteti romak është bërë e zakonshme të përmendet nga historianët për virtytin e tolerancës ndaj besimit të popujve të pushtuar, çuditërisht historia dëshmon sesi, ndaj Druidëve, shteti romak nuk do të tregojë aspak i tillë.

Oktavian Augusti do të mohonte Druidëve të



drejtën për të marrë shtetësinë romake dhe do të ndalonin qytetarët romak të kryenin ritet e besimit të Druidëve. Me shumë gjasa, ligjet e Oktavianit të cilat i mophonin Druidëve të drejtën e çdo lloj mbrojtjeje ligjore të mundësuar nga shtetësinë romake dhe ndalimi me ligj i praktikimit të besimit të Druidëve, nuk kishin qenë të mjaftueshme për deri sa, Senati i Romës, me anën e një ligji të aprovuar në kohën e perandorit Tiber, vendosi të nxirrte jashtë ligjit Druidët dhe besimin e tyre. Mbas disa shekujsh përndjekjeje nga ligjet perandorake që i detyruan Druidët të kryenin veprimtarinë e tyre në mënyrë ilegale, në fund të shekullit të III dhe në fillim të shekullit të IV, krishterimi në formën e besimit zyrtar dhe më pas edhe të vetëm të Perandorisë Romake, e pati të lehtë të zhdukte krejtësisht edhe gjurmët e fundit të mbijetesës së besimit të Druidëve. Përse shteti romak ishte treguar aq i vendosur në nxjerrjen e ligjeve kundër Druidëve dhe besimit të tyre? Duke anashkaluar si të pavlefshme shpjegimet e propagandës të shtetit romak që e justifikonte persekutimin ligjor kundër Druidëve dhe Druidizmit me ritualet e kurbanëve njerëzore të kryera nga Druidët, (edhe sikur kjo akuzë të ishte e vërtetë, ajo të ngjan gësharake ndërsa mëson se edhe vetë Shteti Romak kryente rituale të tilla), arsyeja e vërtetë e persekutimit të Druidëve dhe Druidizmit nga shteti romak ishte roli politik, administrativ, moral dhe kulturor që Druidët kryenin në shoqërinë e popullsisë kelte. Druidët ishin shtresa intelektuale, e cila ishte e nevojshme të zhdukej për të mundësuar konsolidimin e pushtetit të shtetit romak mbi territoret e pushtuara të populluara nga Keltët. Por ndoshta... Persekutimi i Druidëve dhe Druidizmit nga ana e shtetit romak lidhej edhe me arsyen që, modeli i organizimit të shoqërisë të propozuar nga Druidët dhe ai e shtetit romak, ishin dy modele krejtësisht të ndryshme dhe prania e diturisë së ekzistencës se njërit do të thoshte vdekje e sigurt për tjetrin...

(Për informacione të mëtejshme mbi Druidët, historinë dhe besimin e fiseve kelte, lidhjen e tyre me legjendën e Graalit, lexoni; “Graal... Shpirti i humbur i Evropës dhe historia e mohuar e Alba – Gens).



Manastiri i Zvërnecit dhe historitë rreth tij

Nga ILIRJAN GJIKJA

Vendosur në ishullin e Zvërnecit kisha e Shën Marisë e ngjan një anije të vjetër që lundron e vetme në lagunën e Nartës. Duke e vizituar nga afër duket sikur ora ka mbetur në këtë vend prej kohësh. As fëshfërimat e gjetheve të pyllit aty pranë dhe zhurma e valëve nuk e prishin qetësinë e saj shekullore. Vetëm këmbanat e “kanë këtë privilegj”. Herë pas herë tingëllimat e tyre që paralajmërojnë festat fetare apo ditët e shënuara duket sikur na kujtojnë ngjarjet e së kaluarës dhe njëherë që prehen në varrezën aty pranë.

Manastiri i Shën Marisë së Zvërnecit është një prej manastireve e njohur bizantinë në rajonin e Vlorës. Ai ndodhet në një vend të spostuar në një ishujt e lagunës së Nartës. Largësia nga qendrat e banuara, izolimi dhe vendi i mbrojtur e bënin këtë vend të përshtatshëm për ngritjen e një objekti të tillë. Pikërisht edhe themeluesi i jetës manastiriale, Pakomi, në të tilla vende e nisi aktivitetin e monakizmit dikur në Egjiptin e shekullit të IV. Të vendosur në manastire të veçura në të jetonin murgjit, njerëz që i largoheshin jetës së përditshme dhe kërkonin në vetmi paqen dhe qetësinë. Detyra e tyre ishte që t'i luteshin Zotit së bashku dhe pjesën tjetër të kohës ta kalonin duke ju përkushtuar zejeve, shkrimit të librave, apo veprimtarive të tjera humane. Pakomi përcaktoi edhe rregullat e para të këtij shërbimi siç ishin betimi, besimi, dhe bindja ndaj kryemurgut, të cilat u shoqëruan me krijimin e manastireve të para, të cilët ishin institucione të veçanta që vepronin brenda kishës. Por “jeta e murgjëve” nisi zyrtarisht në fund të shekullit të V-të, kur murgu italian, Benedeto i Norçias, formuloi “Rregullin e Mjeshtrit”, i cili rregulloi veprimtarinë e jetës monastike. Pikërisht në kohën e sundimit të perandorit Justinianit (527-565) monakizmi dhe ngritja e manastireve mori një përhapje të gjerë (Pierre Milza, Historia e Italisë, SH.B. Dituria, Tiranë 2012, f. 158). Diku rreth shekullit të VI-të, kjo traditë nisi të aplikohet edhe në vendin tonë, duke krijuar një rrjet të gjerë manastirësh ku vetëm në rajonin e Vlorës, ku ruhen sot si kisha të tilla ato të Zvërnecit, Marmiroit dhe bregdetit të Himarës.


Sipas studjuesit Aleksandër Meksi, kisha e Shën Marisë së Manastirit të Zvërnecit, është e tipit “kryq i lirë” me kupolë. Ajo mbart në vetvete dy faza ndërtimi, duke u veçuar në pjesën e vjetër dhe atë të re. E vjetra përbëhet nga naosi (salla) dhe narteksi (parasalla). Naosi ka formën e një kryqi të lire dhe dhe përbëhet nga absida, një protezis gjysmërrethor dhe diakonikonin. Pjesën më të madhe të tij i zë tamburi me kupolën, i cili është ndërtuar me gurë e copa tullash të vendosur me laç midis tyre. Ndërsa narteksi është pjesa tjetër e ndërtimit të vjetër që përfaqësohet nga një zgjatim katërkëndor. Ngjitur me të ndodhet edhe pjesa më e re e kësaj kishë që përbëhet nga ekzonarteksi (portuku) dhe këmbanorja. Ekzonarteksi është ndërtuar me të njëjtën teknikë si pjesa e vjetër e kishës dhe është shtuar më vonë. Fasada e tij përbëhet nga shtatë harkada të mbështetura në gjashtë kolona, të cilat janë ndikim i arkitekturës romake në atë bizantine. Në pjesën perëndimore të kishës ndodhet këmbanorja, e cila mund të jetë e të njëjtës kohë ndërtimi me ekzonarteksin (Aleksandër Meksi, Arkitektura mesjetare në Shqipëri, Tiranë 1983, f. 128-129). Për përcaktimin e kohës së ndërtimit të kësaj faltore kristiane ekzistojnë disa mendime. Aleksandër Meksi argumenton se kisha i perket shek XIII-XIV. Ndërsa studjuesit austriakë, Helmut dhe Herta Bushhausen, mendojnë se koha e ndërtimit të saj i përket shekullit të X (Bushhausen, 1976). Një tjetër studjues, Krauthemer, mendon se ky tip e ka marrë stilin arkitektonik nga mauzoleumet romake dhe është ndërtuar larg qëndrave urbane midis shekujve X-XI. Kjo ide duket interesante sepse çuditërisht brenda kishës në naos ndodhet në dyshemenë e tij edhe një pllakë varri, për të cilin, studjuesi Theofan Popa, aludon për një prej anëtarëve të familjes fisnike Karanxha.

Një hipotezë e hedhur e hedhur nga Popa mbështetet tek shkrimet e historianes së njohur bizantine Ana Komnenës. Tek shkrimet e saj ndeshet edhe emri i Argiros Karanxhas, i cili ishte komandant i gardës perandorake bizantine. Ai u dërgua në vitin

1091 nga perandori Aleks Komneni me mision në Durrës, i paisur me dy letra. Njëra prej tyre ishte për dukën e Durrësit, Joan Komnenin, ndërsa tjetra ishte për parinë e këtij qyteti. Argjiro Karanxha u nis drejt këtij qyteti me qëllim të dyfishtë. Si fillim ai do të dorëzonte letrën e parë e cila i kërkonte dukës Joan, që të shkonte në Kostandinopol për të dhënë shpjegime pasi dyshohej për veprimtari komplotiste. Qëllimi kryesor i Argjiros ishte ta bindte atë që të nisej drejt kryeqytetit ndërsa ai vetë të merrte drejtësinë e Durrësit. Ndërkohë që letra e dytë me të cilën perandori e kishte ngarkuar Karanxhasin ishte tepër sekrete. Atë ai do ta përdorte në rast se vërtetohej fakti se duka Joan ishte vërtet komplotist. Atëherë Argjiroja do ta hapte këtë letër në prani të parisë së Durrësit për të arrestuar Dukën Joan, që ishte njëkohësisht edhe nip i perandorit. Por në këtë mision u përdor vetëm letra e parë. Joan Komneni ju bind vullnetit të perandorit dhe u nis drejt vendodhjes se tij në Filipol të Bullgarisë. Këtu perandori Aleks e priti dhe pasi u bind se akuzat e përhapura për të nipin ishin të rreme e nisi përsëri drejt Durrësit ku e “thërriste detyra”. (Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek X-XV, Tiranë 1975, fq fq 107). Këtë dëshmi na jep në librin e saj “Aleksiada” historiania bizantine Ana Komnena për misionin e komandantit Argjiro Karanxhas në vitin 1091 (Alexias, vol II. Lib VIII, 7.8 f. 19-23). Argjiro duhet të ketë qëndruar në Durrës për një periudhë të shkurtër pothuajse dy mujeve. Për fatin e tij nuk dihet gjë se ç’ndodh më tej. Ndoshta varri brenda kishës së Shën Marisë në manastirin e Zvërnecit i përket atij. Gjithsesi një hipotezë të tillë e hodhi studjuesi Theofan Popa në librin e tij: “Mbishkrime të kishave të Shqipërisë”. Sipas tij ajo është një pllakë guri gëlqeror, me gjatësi 1.87 m dhe gjerësi prej 0.67 m. Mbishkrimi është vendosur në një fushë të sheshtë kurse pllaka anash është zburuar nga imitimi i dy kolonave korintike, sipër të cilave qëndron një hark. Mbishkrimi përbëhet nga tre rreshta dhe përmban këtë tekst: “Këtu prehet Kondos Karanxhas, burrë fisnik me preardhje prej një fisi fisnik, degë fisnike” (Theofan Popa, Mbishkrime të kishave të Shqipërisë, Tiranë 1998, f. 145-146). Poshhtë mbishkrimi dora e e një skulptori ka gdhendur me shumë art një kafkë njeriu, rrethuar prej një gjarpri e të kurorëzuar prej dy kockash simbol i cili nuk është shpjeguar deri më tani.

Por historitë rreth këtij manastiri nuk përfundojnë këtu. Në librin e tij “Kalaja e Kaninës dhe shkrime të tjera”, një autor modern si Eqrem Bej Vlora, citon një kronikë anonime normane të titulluar “Breve cronica normanna”. Sipas saj gjatë fushatës normane të vitit 1081, kalorësi i shquar i shquar i Perëndimit, Boemundi i Tarentit, pasi pushtoi Vlorën rrethoi edhe kështjellën e Kaninës. Në pamundësi për ta marrë me luftë, njerëzit e tij përdorën një tjetër taktikë. Ata e bindën gruan e komandantit bizantin që për një shpërbim të mirë të vriste të shoqin dhe t’u hapte portat e fortesës. Gruaja tradhtare veprimi sipas porosisë dhe u shpërblye për veprën e kryer. Por kur në Vlorë mbërriti nga Italia e Jugut, Robert Guiskardi, i ati i Boemundit ngjarjet morën një tjetër rrjedhë. Pasi dëgjoi për këtë ngjarje, kalorësi i shquar norman u revoltua nga kjo veprë e ulët dhe urdhër, që gruan tradhtare ta burgosnin në Manastirin e Zvërnecit (Eqerem Bej Vlora, Kalaja e Kaninës dhe Shkrime të tjera, Koçi, 2004, f. 32). Ngjarje të tjera që lidhen me këtë objekt janë edhe Marigo Pozion. Në vitin 1932 në varrezën e vogël të këtij Manastiri u varros qëndistarja e flamurit të pavarësisë. Por historia më interesante është ajo e gjetjes së ketij varri, i cili pas furië ateiste të shkatërrimit të objekteve fetare, që nisi në vitin 1967 ishte braktisur dhe askujt nuk i shkonte ndër mend se ku mund të ndodhej ai. Ndërkohe diku në mesin e viteve 1980 në adresë të Seksionit të Kultures së Komitetit Ekzekutiv të rrethit të Vlorës erdhi një leter. Atë e dërgonte një plak nga Kolonja, i afërm i Marigo Pozios, i cili këmbëngulte se në varrezën e këtij manastiri ndodhej varri i Marigose, i cili tek pjesa e poshtme kishte një kryq hekuri të ngulur në tokë. Kjo letër bëri që të nisnin kërkimet dhe kështu u gend varri i saj, që sot përbën një tjetër vend pelegrinazhi për shqiptarët dhe një vlerë të shtuar të këtij manastiri.

Fshati me “Kashtore” në Kastoria (Kostur) - Etimologji




Nga MILI BUTKA

Qyteti i Kastorias është i ndërtuar mbi qafën e një gadishulli të vogël që depërton në Liqenin e Orestias në lartësinë; 620 m. mbi nivelin e detit. Sipas të dhënave historike Kastoria është i ndërtuar në shekullin e 5 BC larguar nga qyteti i lashtë “Keleton” historiani romak Livio ketë emërtim e barazon me emrin “liqen” (Celeton). Në këtë vend ishin padyshim mbetjet e Keletrosë së lashtë që kishte pranuar pushtimin e Gotëve.

Në periudhën e hershme bizantine ishte praktikë e zakonshme braktisja e një qyteti të vjetër “romak” dhe zhvendosjen e saj në “Kala” apo vendndodhjen e fortifikuar të natyrshme për tu mbrojtur nga pushtuesit. Për emrin e Kastoriasë, ka shumë versione. Në gjuhën bullgare “Kastoria” do të thotë; “Kostur = Kështjellë”. Por kjo teori bije poshtë, sepse emri Kastoria është i përmendur edhe para shfaqjes së sllavëve në Maqedoni. Sot Kastoria është një qytet modern prej rreth 20.000 banorë me mbishkrime të panumërta; Cirilliko alfabet.

Në tekstet e mëvonshme historike gjendenet e shkruar si qyteti “Kaistoria”, ndërsa historianët zyrtarë bizantine dhe kronistët përmendin liqenin dhe qytetin vetëm nga shekulli i 11-të, si i Kosturit. Në kullën e kështjellës bizantine të Kastoriasë, shumë afër murit dhe dy kullave, ngrihet një nga monumentet më të rëndësishme bizantine të “Maqedonisë”, i sili quhet: “Koumpelidiki i Virgjërshës” dhe pranohet se ky emer vjen nga fjala; “Button” (?) e që do thotë “Kube” Kur niveli i liqenit filloi të bjerë, pjesë të rëndësishme i ndërtimeve tradicionale u shfaqën duke sjellë në sipërfaqe një zgjidhje parahistorike mbi këtë liqen. Gërmimet e A. Keramopoulou u ndaluan në vitin 1940, por ata arritën të zbulojnë një numër të madh të mjeteve të gurit dhe copa qeramike. Fshati me Kashtore në Kastoria i vendosur në bregun jugor të liqenit u zbulua rastësisht në vitin 1932. Ky është vendbanimi i pari mbi liqeni i gërmuar në Greqi. Shtëpitë e zbuluara kishin forma rrethore dhe drejtkëndëshe, të ndërtuara krejtësisht prej druri, kallamishte dhe balte mbi platforma druri grumbull të kryqëzuara.

Aty u gjend gjithashtu edhe një pllakë druri



Το πρώτο γραπτό κείμενο της Ευρώπης, αποτυπωμένο σε ξύλινη επιγραφή από προϊστορικό ανθρώπινο της νεολιθικής εποχής, που βρέθηκε στο λιμναίο προϊστορικό οικισμό του Διαστημού της Καστοριάς.

shkruar me elemente lineare të inçizuara e cila daton rreth 5000 vjet para Krishtit dhe mund të jetë një formë e hershme e të shkruarit. Këto zbulime në Dispilio janë të njohura si dëshmi të çmuara të jetës së organizuar në liqenin e Kastorias, duke transferuar njeriun modern 7000 vjet më parë, nëpër këto shtëpi tradicionale, në ose jashtë liqenit, njeriu neolitik kishte ndërtuar kulturën kryesisht të bazuar atë në baltë dhe dru si prurje në pyjet fqinje për të pasur si pajisje armën e ushtës, sëpatë prej druri dhe hobe lëkurë mepredha balte. Veç kësaj e kërkuara, domosdoshmeria ndjenja e fortë e mbijetesës, këta njerëz kanë përdorur gjithashtu brirë të kafshëve, si shata për lëvrim tokës, grepa bri dhe rrjeta të endura prej liri, anije të prodhuara nga trunjt e mëdha të pemëve, duke përdorur lëkurën e kafshëve të ngrohta për në dimër; krijuan kështu shata edhe nga eshtra të forta lope dhe vargjet prodhuara për harqet nga zorrët prej derri. Shkencëtarët e kualifikuar të Universitetit Aristotel të Selanikut arritën të rindërtonin një kopje të fshatit neolitik duke udhëtuarë si vizitor prapa në kohë dhe përjetimin kështu me të gjitha referencat historike.

Tashmë një pyetje të vetme: Kur ende kalat apo kështjellat nuk kishin lindur dhe ky vend quhej “Kaistoria”, ky vend banim i hershëm krejt i ndërtuar prej druri, kalamishte, kashte dhe prej balte, kur ende dhe veglat e punës apo armët e luftës gjithashtu ishin prej druri, koske, dhe topa prej balteja a mundej të quhej; “Kaistoria = Kostur = Kështjellë” apo u quajt ashtu thjeshtë si ende në gjuhën shqipe ku Barakat prej druri mbuluar me kallamishte apo; “Kashte quhen – Kashtore – Kaistoria” ... Kastoria - ky popull i veçantë së pari dallohen shumë mikpritës për vizitorët dhe shumë konkurrues me njëri-tjetrin, veti kjo e besnikut mikpritës – shqiptar!



Rrënjët Ilire në Saksonin e Ulët të Gjermanisë



FAMILIA ME E VJETER NE BOTE JETON NË HARZ.(Rrëshirëz)

Nga STEFAN PRINZ,
Redaktor i Gazetes Neue Osnabrücker Zeitung

Për rreth 3.000 vjet kjo Familje nuk eshte zhvendosur nga Vendbanimi. Eshtë e pabesueshme qe, rreth 120 Breza jetojnë në një qytet të vogël në Saksoninë e Poshtme-Harz te Gjermanise Perendimore. Ata konsiderohen si Familja më e vjetër në Botë. Manfred Huchthausen 62 vjecar nga Isenbergu qe jeton se bashku me Familjen e tij dhe eshte prind i dy femijeve, eshte kopje e një paraardhësi i cili jetoi këtu e rreth 3.000 vjet më parë, trupi i te cilit u gjend ne nje Shpelle gelqerore-kristalore jo larg nga shtepia e tij në një fshat të qetë e te vogel në ultësirën e Harz, Saksoni i Ulët.

Pra vertetohet se, babai i tij, gjyshi, dhe stërgjyshi i tij nuk jane zhvendosur nga kjo zone. Në kete vend kane jetuar të paktën 120 gjenerata të tjera të familjes se tij. Familja Huchthausens jeton edhe sot ne Harz dhe është e pabesueshme rreth 3.000 vjet në këtë luginë. Ata, konsiderohen si familja më e vjetër në botë. Familja - Huchthausen jane njohur gjithmone si familja me e vjeter ne kte vend. Vetëm disa vite më parë, rastësisht Arkeologët kishin zbuluar Skelete te njerëzve nga Epoka e Bronzit, në afërsi të shpellës Lichtenstein (guri-ndricues) dhe vetëm dy kilometra larg nga shtëpia e Manfred Huchthausenit. Nëse pemët në kopsht nuk do te pengonin pamjen, ju mund të shihni shpellën nga dritarja e dhomës.

Zbulimi i ketij njeriu ishte një dhuratë nga Perëndia për kërkuesit shkencore. Pothuajse shumë skelete nga Epoka e Bronzit digjeshin para varrimit simbas tradites qe vazhdon edhe sot. Vetëm trupi i ketij Burri, i gjendur ne nje shpelle të vogël në Harz ka mbetur i paprishur për arsye të pashpjegueshme. Analizat e gjenomit i moren Shkencëtarët e Institutit te Zoologjise dhe Antropologjisë në Universitetin e Göttingenit. Ata krahasuan përbërjen gjenetike të të vdekurit me rezultatet e mostrave të ADN-së te marra nga familjet në rajon.

“Rezultati më goditë ne koke “, thotë Manfred Huchthausen dhe tregon letrën e dërguar me postë: gjenomi (geni-i trashëgimis) i rreth 160 banorëve nga kjo zone kanë lidhje familjare me njeriun e gjendur në shpellë. Por, vetëm tek dy persona kufizohet probabiliteti i sigurisë se testit te ADN,

- Njëri prej të cileve është Manfred Huchthausen. Asnjë familje tjetër në botë nuk mund të jetë aq e pasur me prova shkencore që tregon të kaluarën nga zbulimet e deritanishme Arkeologjike. Për mua ishte një moment shumë prekës, kur pashë kafkën e paraardhësit tim, shprehet Manfredi. Ky Paraardhës ishte ndoshta i pari ne kete luginë të vogël, për shkak se studiuesit qe zbuluan trupin e

tij, nuk tregojne gjurmë të prishjes ose kalbjes. Një shenjë që tregon qarte se ky njeri, relativisht është ushqyer mirë dhe ndoshta të tjerët mund të kene punuar për te. E vecanta eshte se në të njëjtat zona ndeshemi në emrat e vendeve të cilat ende janë të adresuara si ilire, të tilla si Rasch dhe Bach, Parthnum,Thüringia dhe Heseni Verior edhe pse te kufizuara nga Saksonia e Ulët, jane te shenuara sipas rendit alfabetik te fiseve ilire që kane banuar midis mijëvjeçarit të 2-të. para lindjes se Krishtit dhe fillimi i shekullit të 7-të mbas lindjes se Krishtit.

Peizazhi i lashtë i Illyris dhe zonave të veçanta në Gjermanin Perendimore e deri ne Holande, eshte pershkruar nga Historiane te njohur si Astrid Van Nahl, Lennart Elmevik, Stefan Brink, ne vitin 2004 ne “Historia e fiseve ilire”, por ato ndodhen te shtjelluara me detaje dhe ne koleksionet e librave historike qe ndodhen ne Saksenin e ulët A-G te Professoreve Bernhard Fabian, Felicitas Marwinski, Friedhilde Krause, Eberhard Dünninger, Paul Raabe.

Bad Grund. Pasardhesi i familjes më te vjetër në botë Manfred Huchthausen i provuar gjenetikisht, ka më shumë pasardhës. Në shpellën e Lichtensteinit në Bad Grund në malet Harz nga gërmimet Arkeologjike, jane zbuluar eshtrat e njerëzve të tjerë nga Epoka e Bronzit, qe janë paraardhësit e të cilëve ende jetojnë në rajon. Në shpellë, nga te dhenat me te reja, jane gjendur edhe 60 Kufoma te tjera qe janë në përputhje me zbulimin e burrit qe ka jetuar rreth 3.000 vjet më parë. Keshtu tha Drejtuesi i Qëndres Arkeologjike ne Bad Grund, Ortrud Krause. Nga gërmimet e reja jane zbuluar gjithashtu edhe punime te qeramikes, bizhuteri, mbetje bimore dhe kocka te kafshëve. Te dhenat u shpallen në Shtator. Shkencëtarët në Universitetin e Göttingenit kane provuar dhe percaktuar me ndihmën e testeve të ADN-së, që në zonën Bad Grund në Lichtenberg sot jetojne pasardhësit e të vdekurit rreth 3000 vjet më parë. Historia e kësaj familjeje mbi 120 breza u përhap në 2013 nga qendra kerkimore shkencore me përvojë. Ndër të tjera, skeletet e njerëzve nga Epoka e Bronzit nga zbulimet e fundit ndodhen te ekspozuara me shenimet perkatese ne muzeun shtesë te Qytetit.

E rëndësishme është gjithashtu, se ekspertët kanë zbuluar sende te panjohura më parë per epoken e lashte te Bronzit në shpellë vazhdon te shpjegoje Krause, por kohët e fundit eshte zbuluar edhe një Kapanxhe pesë metra e thellë qe eshte ekspozuar ne Muze dhe tregon për këtë periudhe. Zbulimet e para të rëndësishme janë bërë nga arkeologët në shpellën e Lichtenbergut në vitin 1980 dhe Shpella ishte një vend i adhurimit për njerëzit në epokën e bronzit. (p.d.a)

(Perktheu Ylli Krasniqi Berlin)



Antishqiptarizmi si profesion fitimprurës

Nga ISMAIL KADARE


Rasti i Konicës, më mirë ndoshta së çdo tjetër, na kujton cilësitë e shqiptarit: edhe kur ngjitet në lartësitë subline, herë pas here, që nga thellësitë e racës, i vijnë vrullet zëmërake. Por më shumë se kjo, rasti i Konicës shtron një pyetje madhore në këtë fund mijëvjeçari: ç'imazh kanë për vetveten shqiptarët?

Është një çështje themelore që kapërcen dukshëm anën kulturore e etikë. Ky çmim i vetvetes lidhet me vlerësimin që ata i bëjnë kombit të tyre në përgjithësi, ai lidhet me vlerësimin e atdheut, së fundi ai lidhet me çështjen themelore se sa janë ata të vendosur të mbrojnë ekzistencën e tyre si komb në rruzullin e shqetësuar botëror. Nuk është as shpikje poetesh, as propaganda nacionaliste, e aq më pak komuniste, të thuhet se vëndi ynë, Shqipëria, ka qënë disa herë në buzë të humnerës. Traktatet për ta ndarë atë midis fqinjëve, programet e doktrinat për ta shpërbërë kombin shqiptar janë aty, në arkivat e shumë shteteve, me data, me vula, me emra. Dhe shumë prej tyre nuk janë aspak të vjetra. Ato kanë në fund vitet 1913, 1918, 1938, e disa janë fare të reja.

Në këto kushte, në kushtet kur tërbimi nationalist antishqiptar merr përmasa të tilla, saqë në mars të vitit 1997, në demonstratat e Shkupit njëzëri kanë guxim të ulërijnë « shqiptarët në krematorium!» kuptohet që të jesh antishqiptar është fare e lehtë, madje është shpesh fitimprurës. Kështu, dhe kurrsesi ndryshe, mund të kuptohet vala antishqiptare që shpërtheu rrotull Shqipërisë dhe brënda në Shqipëri kohët e fundit. Kështu shpjegohet përse një grusht intelektualësh renegatë shqiptarë u bënë befas të përkëdhelurish e disa forumeve ndërkombëtare dhe, ç'është më e keqja, zëdhënësit për problemet shqiptare.

Shkurt, antishqiptarizmi u kthye në profesion. Është kjo frymë e sëmurë që ndihmoi për rrëzimin e strukturave të shtetit shqiptar brënda dytri javësh, e cila bëri që gjeneralë dhe oficerë shqiptarë, në mënyrë të turshme, të braktisin postet e tyre, për të përfutur një azil politik në Itali, që vulgu shqiptar t'u vërë zjarrin tempujve të kulturës shqiptare. Në kushte të tilla, të ulërish ende se në Shqipëri ka patriotizëm të tepruar, se letërsia shqipe është nacionaliste etj, është me të vërtetë thirrje e hapur për tradhti të hapur tashmë ndaj atdheut.

E gjithë kjo lidhet me një sërë pyetjesh themelore: a janë shqiptarët patriotë më shumë se ç'duhet, apo përkundrazi, janë ftohur me vëndin e vet? A mos po e mbiçojmë pa të drejtë veten



dhe vëndin e tyre, a mos përkundrazi e përcëmojnë pa të drejtë veten dhe atdheun, me fjalë të tjera: a e duan këtë vënd që u ka dhënë emrin qysh prej dy mijë vjetësh, apo ëndërojnë ta këmbëjnë me një tjetër vënd, ëndër e mbrapsht kjo që ka ngritur krye aty-këtu në kohën tonë? Në prag të mijëvjeçarit të tretë, shqiptarët janë të detyruar të nxjerrin ende mësim nga drama e tyre, që ndodhet ende në zhvillim.

Në kushtet e një klime të ashpër ndërkombëtare, kur ata, i vetmi komb i ndarë tragjikisht në Europë janë të detyruar të durojnë mospërfilljen botërore për gjëmën që u ka rënë në kokë, në kushtet e vetmisë së tyre, të trysnisë së një propagande dashakeqe që e ka përbaltur imazhin e tyre në botë, duke e paraqitur herë si popull të dhunshëm, herë fundamentalist, herë barbar e herë të lajthitur, shqiptarët janë të detyruar, midis të tjerash, të bëjnë një zgjidhje e sqarim themelor në ndërgjegjen e tyre lidhur me patriotizmin. Mendimit të mbrasthtë që e ngatëron patriotizmin me nacionalizmin, që e paraqet antipatriotizmin si balsam kundër nacionalizmit, ata duhet t'i përgjigjen me një JO të prerë. Patriotizmi nuk është nacionalizëm dhe antipatriotizmi është po aq i rrezikshëm sa shovinizmi.

Ata që i japin shpesh këshillat kundër patriotizmit, e kanë siguruar ndërkaq patriotizmin në vëndet e tyre, dhe si gjithë të velurit i lejojnë vetes luksin të nazetohen më të. Ndërkaq, sovranitetin për vëndin e tyre e kanë siguruar gjatë shekujve, pa kursyer

asgjë, madje as forcën e armëve. Askush nuk shqetësohet në Francë kur presidenti e mbaron çdo fjalim me fjalët « Rroftë Franca! », dhe askush nuk acarohet në ShBA kur në të gjitha meshat bekohen shteti amerikan, presidenti i vëndit dhe ushtria amerikane.

Le të pranojmë me trishtim se në kreu Gadishullin Ballkanik, në kohën kur shumica e vendeve u përfshinë nga valët e egra nacionaliste, te shqiptarët ndodhi e kundërta. Kjo ishte një rënie në kurth nga më të turpshmet për një komb. Ishte thënë që, pasi u përpoqën t'i japin botës shëmbullin grotesk të popullit të parë pa fe në botë, majmunët e vëndit tonë u joshën nga mbrapshtia tjetër: të japin shëmbullin e popullit PA ATDHE.

Thyerja morale e popullsisë shqiptare në këtë fund shekulli ishte një nga humbjet më të rënda të tij. Ajo ishte, me sa duket, rrjedhoja më tragjike e diktaturës sfilitesë komuniste në Shqipëri dhe e terrorit shtazarak sërëb në Kosovë e vise të tjera të Jugosllavisë. Thyerjet morale janë të njohura në jetën e popujve. Ashtu siç janë të njohura ringritjet. Për t'u ringritur, kombit shqiptar i duhet të tendoset e të nxjerrë nga thellësitë gjithë rezervat që ka skajuar aty, ato rezerva, që popujt, sipas një teknologjie të lashtë, i ruajnë për ditë të zeza e i nxjerrin në stinë fatkeqësish.

Raportet më atdheun zënë në këtë rast vëndin kryesor. Shqipëria s'ka nevojë për ekzaltimë vulgare, por aq më pak ka nevojë për përcmim. Mendimi se Shqipëria dhe shqiptarët kanë qënë

tepër të himnizuar nga kultura shqiptare, ndaj tani duhet t'i rrezojmë në baltë për t'i sjellë në vete, është doktrinë e antishqiptarizmit. Kultura dhe mendimi i një populli qëndron gjithmonë në një lashtësi të shquar për ku përipiqet të tërheqë e ta ngrrejë gjithë kombin. Dy shekuj më parë, Gjermania e Gëtes dhe e Shilerit ishte shumë larg Gjermanisë së prapambetur e fshatarake e, megjithatë, askush nuk e cilëson mendimin gjerman si elitist ose ekzaltues.

Nisur nga kjo, mund të thuhet pa droje se mendimi rilindas shqiptar, ndonëse tepër i lartë në krahasim me gjëndjen reale të popullsisë shqiptare, ishte plotësisht i përligjur. Nga ana tjetër, duke e pranuar nevojën e plotësisht të këtij mendimi me një vision kritik e qortues (korrigjues), duke e pranuar, pra, si të drejtë në thelb prirjen kritike të Konicës, megjithatë në emër të një të vërtete madhore, duhet thënë se kritika e tij kundërthënëse ishte në përgjithësi e tepruar dhe e parakohshme. Vetë ai e dëshmon këtë, jo vetëm me atë pjesë të veprës së tij që është mbujtur plot dashuri e përgjërime për Shqipërinë, por edhe me veprimtarinë si ambasador i vëndit të vet në ShBA, detyrë që ai e kreu shkëlqyeshëm për një kohë të gjatë. Ambasadori me i kulturuar e më brilant i kohës në Uashington, ai bëri çmos të paraqiste Shqipërinë e qytetimin shqiptar në dritën më të mirë të tij, duke e mbrojtur nga keqkuptimet e nga përcmimi, që ajmë, ishte ngritur disa herë vetë t'ia shprehte vëndit e popullit që e kishte lindur. (f23-28)

MBI DREJTPESHIMIN

Kombi shqiptar në këtë fund shekulli vazhdon të përjetojë orën e ligë të tij. Ai është i goditur rëndë në trupin e vet, ngaqë është i ndarë e i shpërndarë në tri shtete. Por ai ka marrë goditje psikike po aq të rënda, në mos më tepër: ai është i thyer moralisht. Ringritja morale e popullit shqiptar është aksioni më i ngutshëm në këtë kohë të rëndë. Ai është çelësi, pa të cilin nuk mund të ndërmerret asnjë veprim tjetër shpëtuës. Në qoftë se populli shqiptar do të vazhdojë ta përcmojë e ta përbaltë vetveten, në qoftëse ai, në mënyrë iracionale, do të synojë drejt shpërnguljes, qoftë nga trojet e tij në Kosovë, qoftë nga trojet e shtetit shqiptar, në qoftëse ai do të vazhdojë të ngrrejë dorën kundër strukturave shtetërore të tij, të çfarëdolloj ngjyre politike të jenë ato, ai do të ecë drejt greminisë. Kahu i mbarë i një kombi nis nga ai vetë, ashtu siç nis zezona e tij. Mendimi që kombi shqiptar do të ketë për vetveten, në

(Vijon në faqen 24)

MONOGRAFI

Kronika e eksodeve dhe vendbanimet arbëreshe në Itali 1272 – 1278

Nga PROF. DR. LUTFI ALIA

1272 – 1278: Pas rënies të Principatës së Arbërit (1255), më 21 shkurt të vitit 1272, në skenën e historisë arbërore shfaqet Regum Albaniae, me mbret Karl I Anzhuin (Carolus I, dei gratia Rex Napoli, Siciliae et Albaniae). Mbreti Karl I Anzhuin, mobilizoi shumë albanezë në shërbim të ushtrisë në Durrës dhe në gardën e oborrit mbretëror në Napoli. Kuptohet nuk kemi të bëjmë me emigrim të banorëve, por me transferimin e një grupi ushtarakësh albanezë, të cilët nuk u kthyen në vendlindje, por morën familjet e tyre dhe u sistemuan përfundimisht në Napoli dhe në qytete të tjera të mbretërisë. Mbreti Karl I dhe pse u premtoi fisnikëve arbërorë mbrojtje dhe vetqeverisje sipas ligjeve lokale, nuk e mbajti fjalën dhe për të shmangur revoltat, mori peng disa fisnikë, të cilët i internoi në Itali, disa prej tyre dhe i burgosi. Ne vitin 1278, rezultojnë të burgosur në Terni një grup fisnikësh, mes tyre Duka Tanush Dukagjini (Dux Ginus Tanusius Albanensis), ndërsa në Anversa, ishin të burgosur 5 fisnikë ndër ata edhe Duka Tanush Skura i Kunavisë (Dux Tanusius Scura).

1368 – 1410: Dyndjet sllave dhe presionet e tyre për konvertimin e popullatës në ortodoksë, i detyroi disa familje nga Drishtu, Danja dhe Shkodra, të braktisin trojet dhe të emigrojnë në Venecia. Në vitin 1368,



Refugjatë albanezë nga Parga, që zbarkuan në Pulja. Pikturë e vitit 1826 e FrançeskoHayez

në kishën San Severo të Sestiero di Castello të Venecias, komuniteti albanez hapi shkollë e devotshmerisë (Scuola di Devozione), që funksionoi deri në fund të vitit 1443. Studiuësi Ilia Karanxha, në shkrimin "Shkolla e shqiptarëve në Venedik", botuar në Zemra-shqiptare.net, tregon se më 21 qershor 1368, Këshilli i të Dhjetëve në Venedik, i dha lejen disa "personave të devotçëm" të krijojnë një "scuola", që do t'i dedikohet Shën Gallos në kishën e Shën Severo. Sipas Lucia Nadin (2008), këta të devotshëm ishin drishtanë, të cilët e vazhduan veprim-

tarinë e tyre si bashkëvllazëri deri më 10 shtator 1443. Sipas Zef Valentinit, Serenimisës nuk i pëlqeu entuziasmi i më se 200 albanezëve, për të formuar bashkëvllazërinë e tyre, andaj arsyeja e vërtetë e mbylljes së shkollës ishte "që këta të mos guxojnë më të mblidhen në të ardhmen." (G. Valentini: Acta Albania Veneta p.III, t. 18, doc. 5029/P. Xhufi : Dilemat e Arbërit 2006, f.246). Në fund të shekullit XIV, arbërit u përballen me sulmet e para të hordhve osmane, që pasi morën një pjesë të Moresë, Kosturin dhe Ohrin, në vazhdim pushtuan Beratin dhe

Lushnjën. Më 18 shtator 1385, Balsha II me reparte kalorësish i sulmoi turqit në Savër të Lushnjës, por u thye dhe Balsha II mbeti i vrarë. Pas kësaj fitore, turqit morën Krujën e më pas pushtuan dhe treva të tjera në veri të vëndit. Në këto situata të ndërlikuara, një pjesë e popullatës të territorëve të pushtuara, për t'i shpëtuar reprazaljeve të barbarëve turqë, emigroi drejt Italisë. Fluksi i parë i albanezëve ishin 60 familje nga Shkodra, Lezha, Durrësi, Mati, të cilat u vendosën në Venecia, Trieste dhe Istria. Historiani Pietro P. Rodotà në veprën "Dell'origine, progresso e stato del rito greco in Italia; vol 3, Roma 1775" shkruan: "... sulmet turke i tronditën albanezët, një pjesë e të cilëve, për t'i shpëtuar nënshtrimit dhe ndëshkimit të osmanëve, i braktisën trojet e veta dhe ikën në Itali. Ndër refugjatët e parë, që zbarkuan në brigjet italiane në vitin 1396 janë 10 familje albaneze, të drejtuara nga Miko Dragovik. Këto familje u shpërndanë në Venecia (në fshatin Peroi), në Trieste dhe në Istria, ku u vendosën në komunat e Parenzo, Pola, Umago. Në gjysmën e parë të shekullit XV, filloi emigrimi dhe nga trojet jugore arbërore. Tajani shkruan: "Në vitet 1399 – 1410, grupe familjesh albaneze, të drejtuara nga fisniku Gjergj Matranga (Giorgio Matranga), zbarkuan në Siçili dhe u vendosën në trojet rreth Palermos. Krahas impenjimit në punë bujqësore dhe me blegtori, një pjesë e burrave u vunë në shërbim të ushtrisë dhe te

gardës te mbretit aragonez Martino (1399-1409)". Tajani F. Albanesi in Italia. Cosenza. Casa del Libro. 1969.

1413: Në muajin maj të vitit 1413, princi Gjon Kastrioti, i doli para ushtrisë turke e pas luftimesh të ashpra në Shkallë të Matit, ushtria albaneze u thye, duke lënë në fushën e betejës shumë të vrarë. Pasi morën kështjellën e Shkallës, hordhitë osmane i pushtuan fshatrat për rreth, duke masakruar banorët, ndërsa disa grupe familjesh, që i shpëtuan reprazaljeve, zbritën në Durrës e me ndihmën e anijeve veneciane ikën në Siçili, Marke dhe Venecia. Grupi i familjeve që shkoi në Siçili, u sistemua në trojet e komunës Mezzojoso.

1444: Ushtarët e kapëdanit Demetrio Reres, që i dërgoj Skënderbeu në ndihmë të Alfonsit V Aragona, u vendosën përgjithmonë me banim në Siçili dhe në Kalabri.

1461: Reparti me 2800 kalorës, që shkuan në ndihmë të Mbretit Ferrante I Aragona i Napolit, nuk u kthyen në vëndin e tyre, por qëndruan në Itali te shpërndarë në disa komuna në Pulia. Në verën e vitit 1462, pas fitores të ushtrisë albaneze kundër aleatëve të kontit Orsini, në betejën pranë qytetit Troia në provincën e Foggia (Foxhia), mbreti Ferrante I e konsolidoi pushtetin dhe për të kompensuar kontributin e Skanderbeut, i dhuroi feudet e San Giovanni Rotondo, Monte Sant Angelo, Terni etj, të cilat nga ajo kohë janë përnjëzë të familjes Kastrioti. Në këto

(Vijon në faqen 20)

Tirana ose kryeqyteti me histori të fallsifikuar

Nga NDOC SELIMI E XHEVAT UKSHINI

Emri i kryeqytetit të Shqipërisë Tiranë vazhdon të interpretohet me shtrembërime e gabime të mëdha të realitetit historik. Për fat të keq edhe në literaturën europiane e më andej deri në periudhën e tanishme qytetin e Tiranës e njeh si një qytet që qenka themeluar nga një shqiptar i turqizuar i quajtur Sulejman Pashë Bargjini prej Mulleti. Si depërtoi në literaturën europiane ky version historik për themelimin e Tiranës?

Edith Durham, pasi njihet me historinë e këtij qyteti, ashtu si ia serviren vendasit, thotë: "Tirana është themeluar me 1600 nga një bej i pasur, i cili i vuri këtë emër për kujtim të një fitoreje të turqëve në Teheran të Persisë." (E. Durham "Bregua e Ballkanit" Tiranë, 1991, fq. 92).

I njejtë shpjegim është shkruar edhe te "Enciklopedia Europiane", botimi italisht, ku thuhet: "Tirane da Teheran, nome che le diede, quando la fondo al principio del secolo XVII, il generale turco Suleyman Pascià..." (Tiranë prej Teheran, emër që thuhet i është vënë kur e themeloi princi i shekullit XVII, gjenerali turk Sulejman Pasha.) ("Albania" botuar në "Enciclopedia dei popoli d'Europa", Enciklopedia e popujve të botës, 1965 fq. 390.) Gjithashtu, deri në ditët e sotme përmendet edhe një legjendë tjetër, sikur në bregun e Lanës po "tjër ranë" (po hidhej ranë), gjë që edhe kjo nuk ka asnjë bazë shkencore. Pa themel duket edhe interpretimi tjetër, sikur ky vend u popullua prej të ardhurve nga malet e shpjegohet me "të ranët" të zbriturit në fushë. Së fundi është hedhur edhe një ide tjetër, që toponimi Tiranë vjen prej një kalaje me emrin Trikan të përmendur nga Prokop (shek VI), që shkruesit e tanishëm e lidhin me Tyros që në greqisht do të thotë bylmet (Theheranda), që mund të ketë një lidhje me toponimin Tiranë.

Le të japim disa ide më të qarta të këtij toponimi duke u nisur nga literatura jonë dhe ajo botërore. E quajmë të pamundur që emri Tiranë të jetë pagëzuar nga S.P.Bargjini, pra të jetë huazuar prej emrit Teheran, sepse Tirana ka një histori shumë më të lashtë. Njëqoftëse është e vërtetë se jeniçeri S.Bargjini u kthye në shekullin e XVII në vendlindjen e tij si pasha turk dhe bëri disa ndërtime, ky fakt nuk dëshmon asgjë për themelimin e qytetit.

Emrin Tiranë e përmend Marin Barleti mbi 14 herë tek "Historia e Skënderbeut" (Infobotues, Tiranë, 2005) qysh në shekullin e XV duke evidencuar faktin se kishte dy Tirana: e Madhja dhe e Vogla. (shiko faqet 28,32, 47, 214, 217, 220, 231, 234, 250, ...e deri te 480.). Po kështu edhe F.S.Noli në veprën e tij "Historia e Skënderbeut" thotë: "Fortesat e Gjon Kastriotit qenë Kruja, e cila ishte kryeqytet i principatës, Petrela afër Tiranës, Petralba..." (Noli vep. 4, Akademia e shkencave, Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë 1989, fq 69). Në faqen 109 të po kësaj vepre thuhet: "Skënderbeu ...sapo mori lajmin që Ali pasha po afrohej, mbloodhi ushtrinë e doli në fushë... pranë Kasharit një fshati afër Tiranës Vogël..." dhe në shpjegim Noli vazhdon:

"Tirana e vogël ishte afër Krujës. Në këtë vend lindi Justiniani, perandori roman i Bizantit, i cili ndërtoi afro 20 kisha, në Shqipëri të Mesme" (po aty fq. 107). Sipas Biemmi-t, cituar nga Kristo Frashëri thotë: "Ushtria turke e tërhoqi rrethimin në Fushën e Tiranës, tetë milje larg Krujës..." dhe Biemi vazhdon, se Skënderbeu kaloi në



Kisha e Shën Mërisë Bzare viti 1202.

rivistë ushtrinë e tij pranë Kasharit, fshat i Tiranës Vogël "Presso Cassar vilaggio di Tirana minore". (K.Frashëri "Historia e Tiranës" vol.I Toena, fq. 63)

Në rranzë të Dajtit, në anën e majtë të lumit dhe Grykës së Tujanit ngrihet një kala me të njëjtin emër, Kalaja e Tujanit, që sipas studiusve i takon shekullit të IV para Krishtit dhe ishte si një portë hyrëse për koridorin Durrës-Tiranë-Dibër. Duke shtjelluar toponimin Tujan na çon deri në kohën e etruskëve dhe sipas "Dizionario Illustrato della Civiltà Etrusca" të Mauro Cristofani, fq. 304 thuhet: "Është një hyjni etruske e barabartë me Afroditë greke e Venere romake. Mund të ketë edhe një rrënjë paralele e quajtur "tyrannos" dhe "Tiranno" (që ka prejardhje ilire, shën. ynë) dhe sinjifikohet si thjeshtë me "signora" "zonjë". Kjo hyjni është nderuar qysh 480 vjet para Krishtit dhe ka pasë një përhapje të jashtëzakonshme në Iliri e gjetkë duke krijuar edhe kult. Këtë e vërtetojnë edhe shumica e kishave me këtë emër. Jo rastësisht një e teta e kishave të vendit tonë kanë marrë emrin e Venerandes, që në popull është e Shëna Premtes (Prendës) e deri te emri i përgjithshëm europian e me andej Ana (Anna).

Po kështu këtë emër e gëzon edhe dita e pestë e javës (venerdi, dita e venerandes te latinët) dhe e premtë (e prende, gegnisht) te ne shqiptarët. Tujan ose Turan është hyjni e dashurisë dhe e pjellorisë dhe ishte e martuar me Laran, çuditërisht me një afrimitet me Lana (lumi që përshkon Tiranën). Duke u njohur me toponimet dhe objektet mbrojtëse dhe të kultit që mbështjellin Tiranën dhe rrethojat dalim në konkluzion se ky qytet e meriton plotësisht emrin "Zonjë" (sinjora) dhe moshja e kësaj zonje është mbi dymijë vjeçare.

Përveç vendit të begatë fushor të lënë nga një gjë deti prehistorik, Tiranën e rrethojnë mbi dymbëdhjetë kalë mbrojtëse si Kalaja e Ndroqit, e Petrelës, e Tujanit, e Prezës, e Lalmit, e Dorësit, e Dajtit, e Presqopit, e Shën Gjergjit, e Berzhitës, e Priskës, e Tiranës etj. (që i takojnë shek VI të kohës Justinianit I) e deri te Kalaja e Krujës ("që

ndodhet përballë Tiranës Vogël" – thotë Barleti). Tirana dhe rrethinat e saj janë të mbushur me emra shënjtore të krishterë duke qenë kështu dëshmitare e përqafimit të Krishtërit menjëherë pas shpalljes zyrtare të kësaj feje. Kështu kemi fshatrat Shën Pal, Shën Mëri, Shën Gjergj, Shën Gjin, Përroi i Shën Mëhillit, qafë Kishë, Shën Ndoi i madh dhe Shën Ndoi i Vogël (dy maja shkëmbinjësh), Qafë Shmark, Fushë Kishë si dhe mozaiku i Tiranës me vlera të mëdha historiko – arkeologjike në Shqipëri e më andej.

Si më e përmendura kishë është ajo e Shën Mërisë në fshatin Brar që datohet e vitit 1201. Në këtë kishë gjatë gërmimeve është gjetur një varr me pesë harqe që i takon pjestarëve të një familje me një epitaf dhe mbiemrin Sguuro. Të pesë harqet kanë nga një kryq dhe përfaqësojnë pesë të vdekurit e familjes, ku e sqaron edhe epitafi në greqisht që thotë: "Kujto o Zot shërbëtorin tënd Sevastin Mihal Sguron me bashkëshorten e fëmijët". Këtu ndodhen edhe 8 varre të tjerë të besimit katolik dhe sipas specialisteve Tirana ka vazhduar me këtë rit fetar deri në shekullin e XV, kur fillon konvertimi i banorëve të saj në fe tjetër. Me keqardhje mësuam se ky objekt i një rëndësie të veçantë u shkatërrua këtë vit nga punimet ndërtuese të eskavatorëve.

Pukevil na bën të ditur se "Justiniani rindërtoi Tyranon, Aulonon, Musionin" dhe më poshtë në spjegimin që u bën thotë "Tyrana – Turkana, fortesë në Epirin e Ri" (Pukevil, "Udhëtime" vëll. 1, fq 373). Në testamentin që Gjon Muzaka u le të bijëve në vitin 1510 thotë: "Karl Topia ishte zot i dy Shkurive, i Fizines dhe Plevishtit në Taransen e Vogël, Kanabi, Forka..." (pra Tirana e Vogël, Krraba dhe Farka). (Emanuelo Polito, "I Musachi di Berat" Muzakajt e Beratit, Paris – Lecce – Pergola Mansavium, 1996, fq 126).

Në relacionin e vitit 1570 një autor anonim venedikas shkruan: "...fushat e Tiranës, që ndodhen midis kështjellës së Petrelës dhe qytetit të Krujës". (...le pianure della Tirana, che sono fra il castello di Passrella e la citta di Croia) sipas I.Zamputit "Dokumente te shekujve XV-XVI për historinë e Shqipërisë" vëll I, Tiranë, 1989. Në vitin 1431–32 bëhen disa regjistrime prone nga venecianet dhe rezultojnë se Tirana kishte 60 qendra të banuara, 1000 shtëpi dhe 7300 banorë. Po ashtu në regjistrin e kadastrës turke të vitit 1583, treva e Tiranës rezultojnë me 110 qendra banimi, 2900 shtëpi dhe 20000 banorë.

Të gjitha këto statistika dhe të tjera që ekzistojnë, por mungojnë në këtë shkrim, i takojnë viteve para 1614, që na serviren si themelimi i qytetit të Tiranës.

Duke u kthyer te Sulejman Pashë Bargjini rrezultojnë se ai në shek. e XVI kishte shkruar jeniçer në ushtrinë turke, arriti gradë madhore deri te Pashë dhe me vonë kthehet në vendlindjen e tij Mullet (o fshatin Bargjin afër Tiranës, që tani nuk është më). Në vitin 1614, u jep parate një

grupi tregtarësh tiranas për të ndërtuar po në Tiranë një xhami, një furrë dhe një hamam. Sami Frashëri në Enciklopedinë Osmane të Shkencës së Përgjithëshme thuhet se objektet e ndërtuara prej tij (S.P.Bargjini, shën. i aut.) "si një trashigimi përkujtimore e historisë së Tiranës" (Saimir Lolja artikull "Tirana e lashtë dhe përvjetorët e tij si kryeqytet", 02/ 2014). Këto statistika flasin për një popullim të mjaftueshëm edhe për një qytet para se të vinte Pasha Bargjini dhe ndërtimi i këtyre objekteve nga ana e tij u bë për shkak se kishte popullim Tirana. Ky nuk dëshmon asgjë për themelimin e Tiranës si qytet. Përkundrazi, fakti se ai paratë për ndërtim ua dha tregtarëve flet më së miri për ekzistencën e mirëfilltë të qytetit, të cilit tani iu shtuan tre objekte që nuk i kishte më parë. Pas mbarimit të këtyre objekteve mund të flitet për një qytet i formës osmane me xhami e hamam. Sulejman Pashë Bargjini me një mbiemër kristian, tregon që edhe ai vetë i përkiste dikur ashtu si gjithë rajoni besimit të krishterë, por që e kishte braktisë përballë raprezaljeve turke kundër shqiptarëve. 400 vjet më vonë për këtë shërbim shteti shqiptar i sotëm i bën përmendore, i thurr lëvdata, i atribuon themelimin e Tiranës e aq me tepër zhbën historinë duke i ndërruar emrin Tiranës ilire me Teheranin aziatik. Në vazhdim të disa të dhënëve po mundohemi të tregojmë në stil telegrafik ritet e ngadalëshme të ecjes së qytetit tashmë gjysëm anadollak në kohën e mëpastajme. Dy shekuj më vonë, Tiranën e sundojnë Toptanët të ardhur nga Kruja. Më 1780 ndërtohet kisha e Shën Prokopit dhe 9 vjet më vonë nis punimet xhamia në qendër e financuar nga Et'hem Beu e përfundon me 1821.

Kulla e sahatit ndërtohet me 1830 dhe është e lartë 35 m.

Ndër lagjet më të vjetra të Tiranës janë lagja e Pazarit dhe Bami. Vite ma parë kjo lagje është



Mozaik i shek. IV i një kisha paleokristiane. Qyteti i Tiranës

quajtur "Vorri i Bamit", që është varri i Ibrahim Kokonozit, por në të folmen tiranese është quajtur Bim e pastaj Bam. Sipas statistikave Tirana si qytet më 1703 kishte 4000 frymë, më 1909 kishte 15.000 frymë, më 1938 kishte 38.000, më 1945 kishte 60.000 frymë. Theksojmë se popullimi i Tiranës është bërë sipas periudhave të sundimitarëve jo tiranas të këtij qyteti e krejt vendit. Toptani solli në Tiranë krunatë e zonën përreth, mbreti Zog solli dibranët e matjanët, E. Hoxha e komunizmi sollën gjithë jugun dhe së fundi ndërrimi i sistemeve solli malësoret e të gjitha krahinave. Sot Tirana gëzon 830.000 banorë. Tirana shpallet kryeqytet i Shqipërisë më 8 shkurt 1920, sipas vendimeve të Kongresit Lushnjës dhe merr statusin përfundimtar më 31 dhjetor 1925.

Deri në kohën e pushtimit italian dhe koncesioneve të dhëna këtij shteti, Tirana kishte ritimin e zhvillimit shumë të ngadalshëm. Ndërtimet moderne italiane që shihen sot e kësaj dite u takojnë marrëveshtjeve me Italinë dhe kjo e fundit jo se do të bënte një qytet modern shqiptar, por i interesonte për idenë e një bashkimi të mundëshëm e aneksimit të saj më vonë. Më 17 nëntor të vitit 1944 forcat partizane hynë në Tiranë duke zhvilluar dy ditë beteja me gjermanët në ikje e sipër, ku morën pjesë brigada e parë e katërta dhe e gjashta. Tirana është i vetmi kryeqytet i Europës lindore e juglindore që nuk u ndihmua nga ushtria e kuqe për tu çliruar, por për fatin e zi të kombit tonë, më pas u inkuadrua në kampin komunist.

Në fund shtojmë se historianëve tanë dhe shkencës sonë shqiptare i bie detyrë urgjente të inicojnë përmes ndërhyrjeve në institucionet përkatëse që të bëhen korrigjimet e nevojshme për sa i përket shpjegimit të drejtë të prejardhjes së emrit të Tiranës, për heqjen përfundimtare nga "Enciklopedia Europiane" e çfardo lidhje me Teheranin dhe vënien e identitetit iliro-shqiptar të qytetit mijërvjeçar të Tiranës në vendin që i takon sipas të vërtetës historike.



Basorelieve të gjetura në zonën e Tiranës

KRENARI SHQIPTARE

Emigranti shqiptar, kandidat për Kryetar Bashkie në Parma

Nga **NDUE LAZRI**
President i Federatës Nazionale të Shoqatave Shqiptare në ITALI (FNAI)

E takuam një buzëmbërme në një qendër tregtare të Parmës. Ishim bashkë me mikun e kolegun tim Klodian Cami. Ai e kishte kohën të kufizuar për shkak të takimeve të shumta të planifikuara me qytetarë të Parmës, takime që zhvillohen thuhet çdo ditë e në të cilat ai vlerëson figurën e çdo qytetari të Parmës, qofshin italianë, apo emigrantë të integruar të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Parma. Është fjala për avokatin shqiptar, GENTIAN ALIMADHI, i cili është bërë figurë protagoniste e mediave dhe e publikut jo vetëm për qytetin e Parmës apo për shtypin e mediat shqiptare, si edhe për mediat nacionale italiane e sidomos për gazeta të mëdha e prestigjioze si "Repubblica". "Corriere della sera" etj. Emigranti që ka ardhur me gomone në Itali në vitin 1993, tashmë është një qytetar italian i spikatur, me kulturë e me formim profesional, me aktivitet në avokaturë që ecën cilësisht, me një njohje të gjerë e të thellë të qytetit të Parmës, të kulturës e monumenteve të tij, të traditave të shumta, por edhe të nevojave e kërkesave po aq të shumta në sfidat e reja përballë krizës e zhvillimeve bashkëkohore. Pikërisht në këtë kontekst, Alimadhi bëhet një figurë protagoniste, sepse në mënyrë private e pa patur në xhep asnjë tersedër partie, ka shpallur kandidaturën e vet, fillimisht në primariat e Partisë Demokratike për të caktuar kandidatin për deputet që do të paraqesë qendra e majtë në zgjedhjet e ardhshme administrative në Parma e pastaj për të synuar postin e qytetarit nr 1 të Parmës, pra të kryebashkiakut. Hapi i parë, mbledhja e gati 1000 firmave, nga 500 të nevojshme për të nisur garën, tregoi se Alimadhi është një sfidues serioz, me rëndësi të shëndosha dhe i njohur nga qytetarët e Parmës. Ai është i ri, 44 - vjeçar, në kulmin e energjive dhe të formimit të tij të gjithanshëm kulturor e profesional, por edhe në fushën politike me ide të qarta për të ardhmen e qytetit ku jeton, për prioritetet për të cilat qyteti dhe popullsia e tij kanë nevojë. Ai flet me synime konkrete e jo me slogane elektorale për trafikun e rendin në qytet, për luftën kundër drogës e degradimit, për infrastrukturën në Parma e rreth saj, për punësimin dhe sidomos për inkurajimin dhe futjen e brezit të ri në njohjen dhe zgjidhjen e problemeve që ka qyteti.

Na bëri përshtypje, se gjatë kohës kur po pinim kafe, shumë qytetarë italianë që po bënin pazarin në atë qendër tregtare, vinin dhe e takonin, e përshëndesnin dhe i shprehnin simpatinë e përkrahjen e tyre në këtë sfidë që ai ka marrë mbi supë. Figura të tilla mund t'i quajmë pa hezitim krenari shqiptarë, pasi njerëz si Alimadhi dëshmojnë që emigrantët shqiptarë kanë sjellë me vete e kanë akumuluar edhe në emigracion vlera të vërteta intelektuale e njerëzore dhe janë të gatshëm e të përgatitur të konkurojnë e kandidojnë për të gjitha nivelet e administratës lokale e shtetërore dhe të klasës politike, e cila sot më shumë se kurrë ka nevojë për transformime e ndryshime



të thella, ka nevojë për zëra e fytyra të reja, ka nevojë për njerëz të pastër e të pakorruptuar. E një nga këto figura është avokati shqiptar GENTIAN ALIMADHI.

Në këto momente, kur nga primariat, që do të zhvillohen me 19 shkurt, na ndajnë pak ditë, të gjithë ne duhet ta shprehim këtë krenari shqiptare, duke mbështetur me të gjitha mënyrat bashkëatdhetar tonë. Tek figura e tij në një farë mënyre është secili prej nesh. Vërtet, jo të gjithë mund të shkojmë e të votojmë në Parma, por mund ta përhapim këtë material e materiale të tjera të tilla që flasin për Alimadhin, në profilet tona e në gjithë rrjetet sociale, që t'i bëhet sa më shumë jehonë. Përse të mos kemi edhe ne një kryetar bashkie, në një qytet të rëndësishëm italian, siç është Parma. Në Parma jetojnë rreth 5000 shqiptarë. Janë një forcë e madhe në jetën prodhuese e shoqërore të Parmës, por mund të jenë një forcë e madhe sfiduese e të bëjnë një surprizë të bukur në politikën italiane, duke mbështetur Alimadhin. Sëpari duke folur në opinion me të gjithë miqtë italianë e me emigrantët e komuniteteve të tjera. E pastaj duke marrë pjesë masive në votimet për primarie e duke votuar për shqiptarin GENTIAN ALIMADHI. Le ta tregojmë veten sa më të bashkuar në këtë moment e të tregojmë se vërtet bashkimi ynë bën fuqinë e ta detyrojë politikën italianë t'i hedhë syte edhe tek njerëzit me vlerë që ka komuniteti i emigrantëve shqiptarë e që mund të sjellë oksigjen e frymë të re në politikën e këtij vendi.

Urimet më të mira për fitore bashkëatdhetar tonë.

Tjetër shqiptar kandidat për kryetar bashkie



Sa më shumë që interesohemi për integrimin e emigrantëve shqiptarë në realitetin ekonomik e shoqëror të shtetit italian, aq më tepër fakte të bukura, domethënëse e entuziazmuere mësojmë. Këtë radhë na takon të zbresim aty ku mbaron Italia qendrore dhe fillon jugu i saj, në rajonin e Abruzzos. Dhe bëhet fjalë për një mik e aktivist tonin të palodhur në Federatën e shoqatave shqiptare FNAI, sipërmarrësin Luan Hallulli. Luani është propozuar nga një listë qytetare e komunës ku ai banon, si kandidat për kryetar bashkie në zgjedhjet e ardhshme administrative. Me thjeshtësinë që e karakterizon, ai nuk na e kishte bërë të ditur këtë fakt. E mësova nga gazetata e zonës, të cilat shkruanin fjalët më të mira për Luanin jo vetëm si sipërmarrës i ndershëm me aktivitetin e tij, por edhe si një qytetar shembullor, që bie në sy për mirë me gjithë familjen e tij në zonë.

Dhe Luani është vërtet i tillë. Ka 20 vjet që jeton e punon në Prato Peligna në provincën e Aquilas. Që në fillim, ai me bashkëshorten e tij, Rovena, ranë në sy të qytetarëve italianë si emigrantë me dëshirën e mirë për të punuar e jetuar ndershmërisht dhe për t'u bërë pjesë integritive e jetës italiane. Vitet kalonin. Luani filloi aktivitetin e tij si sipërmarrës, ku punësoi disa emigrantë të tjerë shqiptarë dhe punonin gjithnjë në respektim të ligjeve, rregullave dhe ambientit. Rritej figura e tij si sipërmarrës, por edhe si qytetar (ai tani ka edhe shtetësinë italiane). Rritej edhe familja e tij. Lindën njëri pas tjetrit Lorena, Jessica dhe Murati. Një familje që e shikon gjithnjë të bashkuar, gjithnjë në harmoni e që gëzon respektin dhe simpatinë e banorëve të zonës.

Luani është natyrë shumë e gjallë dhe aktive. Pasi krijoi shoqatën italo-shqiptare me qendër në Abruzzo, me të cilën mbron dhe propagandon vlerat historike, kulturore e gjuhësore të vendit tonë, ai filloi të aktivizohej edhe me federatën, ku është zgjedhur nga asamblea në këshillin drejtues të saj. Por jo vetëm kaq. Ai është shumë aktiv dhe i interesuar edhe për realitetin ekonomik e shoqëror të zonës ku jeton. Gjithnjë i pranishëm në aktivitetet dhe eventimentet që organizon komuna, madje jo si një pjesëmarrës pasiv apo thjeshtë spektator, por edhe duke dhënë mendime e duke ngritur probleme që kanë të bëjnë me respektimin e rregullave në zonë dhe përmirësimin e nivelit të jetesës. Mendimet e sugjerimet e tij të pjekura binin në sy të qytetarëve italianë, që thonin shpesh herë midis tyre: "Luan ha ragione" (Luani ka të drejtë).

Ishin pikërisht këto cilësi njerëzore të tijat që nxitën një grup qytetarësh italianë të kërkonin

disponibilitetin e tij për të vënë kandidaturën për kryetar bashkie në zgjedhjet e ardhshme administrative. Luani e dha disponibilitetin. Lista qytetare që mbështet emrin e tij, i kërkoi një projekt-program për të vënë në jetë gjatë legjislaturës së ardhshme. Paraqitën projekt-programe edhe kandidatë të tjerë, por shumica miratoi programin paraqitur nga Luani, si program më realist, me vizion konkret mbi problemet aktuale dhe të ardhmen e zonës etj. Kësisoj kandidatura e tij për kryetar bashkie u bë zyrtare.

Luani nuk është njeri i bujshëm dhe nuk sillet si politikanët me premtime e fjalë të mëdha. Ai flet me fjalë të thjeshta me qytetarët, të cilët e ndalin edhe në rrugë, apo e ftojnë për një kafe. Për pikat e programit, nuk u thotë që duhet t'i bëni ju, por ejani e t'i bëjmë sëbashku. Sepse ai e konsideron veten gjithnjë si njëri nga ata, një qytetar të thjeshtë që kërkon të bëjë më të mirën e mundshme për komunën ku jeton. Është kjo mënyrë komunikimi që e ka bërë të fitojë simpatinë e besimin dhe të hyjë në zemrat e njerëzve.

Në shqiptarët ndihemi krenarë me figura të tilla. Por nuk mjafton të ndihemi krenarë. Duhet që në fushatën elektorale të bashkohemi dhe ta mbështesim fuqimisht kandidaturën e Luanit. Jo vetëm me fjalë e propagandë, por para së gjithash duke marrë pjesë masive në votime (ata që kanë të drejtën e votës) dhe duke votuar për Luanin. Kështu japim edhe një sinjal bashkimi e qytetarie të lartë jo vetëm përpara komunitetit shqiptar, por edhe përpara qytetarëve italianë. Pjesëmarrja jonë e lartë në votime, krijon më shumë shanse për Luanin, sepse dihet pjesëmarrja e ulët e italianëve në nomenete të tilla e sidomos në zgjedhjet administrative.

Suksese bashkëatdhetar tonë, Luan Hallulli. Le të behmi të gjithë sëbashku pjesë e suksesit të tij.

Luan Hallulli - Associazione italo-albanese, centro abruzzo luan1977@icloud.com

Prato Peligna, Abruzzo. Piccolo imprenditore. Provincia di Aquila. Ne çdo event ne komunë, gjithnjë presente. Jep kontributin në jetën politike te zones. Ka 20 vjet ketu. Njihet mire nga komuniteti italian dhe respektohet. Moshë 40 vjeç. Bashkeshortja Rovena. 3 fëmijë, Lorene, jessica e Murat. Ishte një grup qytetarësh italianë që i kerkuan disponibilitetin per te vene kandidaturen. I kerkuan edhe një program per zonen ku banon, ne njohje te realitetit dhe nevojave. Programi i tij fitoi ne shumice dhe eshte shpallur kandidatura e tij nga një liste civike e jo nga partite politike.

'Fitorja si e Pirros' dhe qyteti i ndërtuar me urdhër të Pirros

(Vijon nga faqja 9)

Antigonea, qyteti i ndërtuar me urdhër të Pirros për nder të gruas së tij si shenjë e dashurisë së tij, u dogj brenda një nate me urdhër të gjeneralit Romak Emilius Paullus (Pal Emili) në vitin 167 Para Krishtit si hakmarrje dhe në shenjë urrejtje, për aleancën e një pjese të fiseve Epirote me Maqedonasit, që luftuan kundër Romakëve.

Si një histori gërmimi nisi puna me gërmimet e kryera nga arkeologët shqiptarë në vitet 60-70 në afërsi të fshatit Saraqinistë çoi në identifikimin e qytetit të fortifikuar të Antigonesë. Identifikimi është i bazuar në zbulimin e katërmbëdhjetë monedha bronzi me mbishkrimin "Antigoneon", që gjendet në një nga shtëpitë Siti është i vendosur në majë të kodrës në anën lindore të luginës së Drinos. Antigonea shtrihet në një kodër rreth 700 metra mbi nivelin e detit dhe ishte në një pikë e rrethuar plotësisht nga një mur të fortifikuar vlerësuar në katër kilometra në perimetër, me përhapjen e qytetit që mbulon shumë hektarë. Agora e qytetit është gërmuar dhe një stoa, 59

m e gjatë dhe 9 m të gjerë është sjellë në dritë. Monedha nga shtete të ndryshme të qytetit janë gjetur në gërmimet, ato u përkasin: Kërkyra (Korfuzit), Apollonia, Dyrrachium, Orikumit, Ambracia .Shumica e monedhave janë bërë prej bronzi, por disa monedha argjendi. Janë të dukshme mbetjet e një bazilike Paleokristiane, të zhvarrosura gjatë gërmimeve në vitin 1974.

Mark Cartëright të Ancient History Encyclopedia, shkruan: Pirro (edhe Pirro ose Phyrhus, c 319 -. 272 pes) ishte mbreti i Epirit në mes të 306 dhe 302 pes dhe një herë në mes të viteve 297 dhe 272 pes. Ka korrur fitore të mëdha kundër ushtrive të Maqedonisë dhe Romës, ai konsiderohet si një nga komandantët ushtarakë më të mirë në histori dhe të favorshëm është krahasuar me Aleksandrin e Madh nga gjeneralët të tillë si Hannibal. Për shkak të humbjeve të mëdha të pësuar gjatë betejave të tij i ka dhënë shkëlqyeshëm emrin e tij me shprehjen e një "fitore e Pirros" e cila i referohet çdo suksesi ushtarak i cili vjen me një kosto të lartë për fituesit.

Dëshironi të **BOTONI PAK KOPJE LIBRI**, por nuk mundeni sepse shtypshkronjat ju kërkojnë të paguani për një tirazh të madh...

Tani nuk është nevoja të prisni...

JU OFROJMË BOTIME NGA 1 KOPJE E VETME!

Njëllonj si në shtypshkronjë...

Çmime të favorshme dhe shpejtësi!

Telefono: **068 65 08 441** ose shkruaj email: **mbootime@gmail.com**

Piloti që mposhti vdekjen

Ngjarje e vërtetë me Bardhyl Tom K. Lubonjën

Nga AGIM BACELLI

Një grup aviatorësh ishin ulur në barin pranë Zonës Nr. 1 të fluturimeve në Rinas dhe bisedonin rreth vështirësive të fluturimeve natën. Ishte mbremje e bukur qershori. Të gjithë kishin shumë ide se si mund të përballoheshin me sukses lundrimet ajrore pa orientues tokësorë duke u mbështetur vetëm në instrumentat e kabinës. Të gjitha këto ide ishin të mbështetura në librin "Instruksione të Fluturimit Natën". Bardhi tha se, "Jo çdo gjë është parashikuar nga rastet e veçanta të fluturimit natën. Mendoj se e rëndësishme është të dihet se, fluturimimi edhe pa motor mund të bëhet por kurrën e kurrës pa njohje dhe pa aftësi të veçanta fluturimi që vijnë nga kthjellësia e mëndjes në situatë më të rënda si dhe nga guximi i pilotit." Pilotët e miratuan Bardhin dhe këtu u mbyllën diskutimet pasi u thirrën nga zv/komandanti i regjimentit, Serafin Shegani, i cili sapo u ul në tokë nga një kontroll meteorologjik në ajër.

"Djema, koha është mjaftë e mirë dhe e përshtatshme për fluturime natën në kondita të thjeshta meteorologjike, - tha Serafini dhe vazhdoi, - duhet të keni parasysh që daljen ta bëni, për siguri, para kodrave të Kasharit. Tani do të fluturojnë të gjithë ata që janë në planin "Muzg" dhe më pas, në orën dhjetë të natës do të fillojmë me Bardhyl Lubonjën dhe me radhë të gjithë djemtë që do bëjnë kalimin 'Pilot i Klasit të Dytë në Mig-21'. Dakort? Jeni të gjithë në gjendje të mirë shëndetsore dhe psikologjike? (U dëgjua një "po" nga të gjithë.) Urime!"

Komanda e regjimentit kishte vendosur t'ju jepete çdo piloti nga një fluturim kontrolli në reth me Uti-Mig-15, para fluturimit vetëm me Mig-21. Me këtë mënyrë fitohej vetëm kohë, (eleminohej rulumit, tërheqja, fikja e lëshimi i motorit, furnizimi me karburant, ajër, etj.) por nga ana tjetër krijoheshin mundësia edhe për disa gabime të ndryshme, të cilat në aviacion shpesh përfundojnë me fatalitet. Teknikët dhe specialistët punonin shpejt dhe saktë në një kohë relativisht të shkurtër për kontroll rutinë. Ndrimi i pilotave në kabinën e parë bëhej në "pistën e ngritjes dhe uljes" sa më shpejt të ishte e mundur sepse vinin aeroplanë të tjerë në ulje. Dinamika e fluturimeve në këtë rast është e jashtëzakonshme dhe elemionohet si me urdhër vonesat, bisedat e kota, sorollatjet dhe mëdyshjet. Dëgjohet vetëm një zë, ai i Udhëheqësit të Fluturimeve (UF) dhe 'zëri i avionëve'. Teknikët, specialistët, radistët, armëtarët dhe mekanikët e avionëve dëgjojnë vetëm urdhrat e Drejtuesëve e Zonave 1, 2 dhe 3. Shoferët me makinat e ndezura janë në dispozicion të teknikëve të avionëve. Dita ose nata e një fluturimi i ngjet një sheshbeteje. Një urdhër apo veprim i gabuar kushton rëndë. Veprimet e pilotit, i cili do zëvendësojë pilotin e parë bëhen me "shpejtësi rufeje" si lidhja e parashutës, ripat e sedilës, kontrollat e ndryshme, vendosja e radiondërlidhjes me UF dhe me pilotin në kabinën e dytë, mbyllja e kabinës, sigurimi dhe hermetizimi i saj, etj. Serioziteti i punës dhe përqëndrimi i të gjithë aviatorëve, i japin Zonës I pamjen e vërtetë luftarake.

Ora 22:00, Bardhyl Lubonja si përherë i qeshur, por këtë radhë pa fjalë, pa atë zërin e tij karakteristik korçar dhe burrëror, i drejtohet pistës së toku me teknikun Bib Lleshi të cilin e pyet mbi gjendjen e agregatit. Tekniku i raporton me zë të lehtë se gjithëçka është në rregull. Sparaka UTI-Mig-15 me numer 3-38 e me pilotët Gizdar Veipi dhe të ndjerin Sefedin Tomçini mbriti në brezin e ngritjes. (Aeroplani pas uljes, kthehet në 180 gradë dhe shkon në "start", ku fillon ngritja e aeroplanit. Piloti i kabinës se pare, Sefedini zbriti nga kabina dhe Bardhi zuri vëndin e tij. Në këtë kohë shumë të shkurtër, e cila u kushtëzua dhe nga aeroplani tjetër që vinte në ulje dhe që ishte shumë afër, veprimet duheshin bërë sa më të shpejta gjithashtu tepër të saktë. Bile Bardhi

s'pati kohë ta 'përshendste dhe përkëdhelte' avionin si çdo herë tjetër. Tekniku e ndihmoi të lidhej duke i kujtuar shprehjen që Bardhi e përdorte dëndur në kësi rastesh, "Çdo idiot mund ta ngrerë avionin në ajër por vetëm një pilot i aftë e sjell përsëri atë shëndoshë e mirë në tokë". Qeshën të dy. Por jo gjithëmonë çdo gjë shkon në mënyrë perfekte. Kështu ndodhi dhe në këtë rast. Urdhëri i UF ishte i prerë; "Nisu!" Vërtetë, një aeroplan tjetër, që vinte në ulje ishte shumë afër, (mbi Prurësin e Afërt) Bardhi dhe G.Veipi nuk i kushtuan vëmëndjen e duhur të rikontrolonin veprimet e bëra në nxitim e sipër dhe i dhanë gazit në maksimum për të kryer ngritjen e për të evituar kalimin në rreth të dytë të avionit që po vinte në ulje e kështu do kursenin një sasi karburanti. Gjatë akselerimit të shpejtësisë



në piste, Bardhi vuri re se ajri i kabinës ishte jo si zakonisht me kabinë të hermetizuar, por më i fresket, por nuk kishte goditje, apo trokitje të fanarit si zakonisht kur është e pa hermetizuar kabina. Me qënë se parametrat e tjera, sidomos të motorit ishin në rregull dhe me që Gizdari që ishte dhe komandanti nuk reagoi, Bardhi vendosi të vazhdojë ngritjen pa u menduar gjatë. Avioni u shkëput nga toka. Bardhi mbylli rrotat dhe filloi të bëjë veprimet e tjera të nevojshme pastaj mori lartësi në vijë të drejtë. Në lartësinë 100-120 m rufeshëm shkëputet fanari i kabinës së parë duke shkakuar një zhurmë të madhe, si eksplozion bombe. Bardhi nuk e humbi mëndjen, mendoi se është më mirë të shikojë çfarë ka ndodhur dhe të reagojë për shpëtimin e vetes dhe shokut (komandantit) i cili nuk reagoje fare, si dhe avionin. Bile, në kohën e komunizimit, shpëtimi i vetes ishte sekondare para shpëtimit të "pasurisë së popullit"; avionit. Me sytë që i digjnin nga goditja e rrymave të forta të ajrit, Bardhi mundi të shikojë se vetëm pjesa e lëvizëshme e fanarit të kabinës ishte shkëputur dhe zhdukur në errësirën e natës. Për disa sekonda, ai nuk ishte në gjendje të mërte vesh se çfarë po ndodhte, nuk kuptonte e nuk shikonte asgjë, megjithse mendohej që ti hapte sytë. Kishte kuptuar vetëm se trupi ju shty me tërsëllëm prapa nga goditja e ajrit. Për momentin ndjeu se koka ju përplas me forcë në "jastëkun" e butë të kokës të sedilës. Në rast tjetër, sikur koka të kishte qënë pak mënjane dhe të takonte sadopak anash në mbështesën e blinduar të "jastëkut", e cila është çelnic me trashësi 2 cm, do ishte fatale për pilotin Bardhyl Lubonja. "Hajde debil! Mblidh veten!" i bërtiti vetes. "Përqëndrohu! Mblidh tërë forcat dhe bëhu gati të përballosh gjithëçka që mund të ndodhë. Nëse avioni do të ulet dhe ti do të shpëtosh, je i vetmi që mund ta bësh këtë gjë, askush tjetër. Gizdari në kabinën e dytë nuk ndihet fare. Ndoshta që goditur nga shkëputja e fanarit apo ndoshta i kishte rënë të fikët nga goditja e papritur e ajrit. Ndoshta...Ai s'përgjigjej as në radio.

Bardhi po fluturonte pa fanar dhe po

përballohej me trysinë e madhe të ajrit, e cila e mbante të "gozhduar" në mbështetjen e ndënjës. Mendohej më kot të shikonte jashtë por ishte e pamundur në errësirën e natës dhe nën goditjen e rrymave të ajrit. Ato bënin që përveç natës të shtonin më shumë pengimin e pamjes, qoftë edhe të shikonte instrumentat e avionit për të parë se në ç' pozicion fluturonte. Me shumë vështirësi filloi të përkulet përpara, sa më afër xhamit ballor, me qëllim të mbrohej disi nga rrymat e fuqishme të ajrit. Me këtë veprim, pas disa momentesh i vjen shikimi. Menjëherë tmerohet me atë "skënë" që po shikonte. Aeroplani ishte futur në pikadë të thellë, me mënjanim rreth 60 gradë dhe shkonte në drejtim të një grupi dritash në tokë që i afrohej me shpejtësi të madhe. Në këtë moment të frikshëm ai mendoi se ishte fundi i jetës së tij dhe për një çast të vetëm u tremb. Por trembja nuk zgjati dhe nuk ja prishi mëndjen dhe guximin që të reagojë. "Hajde Bradh! Provo se je një trim dhe i zoti të shpëtosh avionin! Përndryshe, merr atë që meriton ti bashkë me Pasurinë e Popullit..."

Duartë s'po i reagonin. Ndiente një dhimbje e zjarmi në gjoks, zemra po i rihite si çekan nga emoncionet dhe nga frika që shkakton kur shikon fundin. Befas në kokë i shkrepri zjarri i shpëtimit që i erdhi sigurisht po nga zemra. "Do shpëtoj! Nuk do vdes. Ti avion do më bindesh mua sespe nuk ke tru, truri jot jam unë!" Ishte hormoni i adrenalines që kishte "vërshuar" nëpërmjet rrymës së gjakut në gjithë arterjet e venat e trupin, për të stimuluar e mobilizuar në maksimum sistemet e organizimit të shpëtimit. Siç duket, edhe në rastet më të rënda, mëndja e trupi u komandokan nga qetësia, guximi dhe veprimi për të shpëtuar. Thonë se të gjithë njerëzit që kanë parë vdekjen me sy do kenë ndërjet të njëjtën gjendje tejet emocionale e të frikëshme por jo të gjithë kanë braktisur frikën dhe pasivitetin dhe fatkeqësisht ata kanë marrë shpërblimin e keq të tyre. Gjithëmon njeriu merr atë shpërblim sipas asaj që ai bën kur ka përballë jetën apo vdekjen. Nëse thuhet që jeta është luftë, lufto! Nëse thuhet që vdekja është vdekje, munde! Ishin instrumentat, por më shumë, dhe të parat në ndihmë, ishin dritat e qëndrës të Kasharit që e ndihmuan jashtzakonisht të përcaktonte shpejt pozicionin e aeroplanit. Menjëherë pa në panelin e instrumenave aviohorizontin e mrekullueshëm, me ndihmën e tij përcaktoi shpejt pozicionin egzak dhe shumë kritik të aeroplanit. Aviohorizonti tregonte kënde maksimale të tangazhit dhe mënjanimi. Me veprime jashtzakonisht të shpejta dhe të sakta ari të nxjer aeroplanin në fillim nga mënjanimi (kreni) dhe më pas nga ajo pikadë e thellë vrasëse, që deshte të vriste dy pilotët dhe të shkatronte "sparkën" e bukur të Bardhyl Lubonjës. Ishte dhe fat sepse, në vëndin ku ishte drejtuar aeroplani me dy pilota te shokuar në të, ndodhën dritat e Kasharit që e bënë pilotin të kuptonte se avioni po shkonte drejtë tokës. Këtyre dritave shpëtimtare, të mrekullueshme, ai jua dedikoi jetën e tij dhe nuk i harron kurrë. Sot, Bardhi nuk provon fare të flasë për guximin dhe veprimet e tij me një gjakftohtësi të admirueshme që nuk e ka gjithëkush. Menjëherë mori lartësinë e duhur, nxorri aeroplanin në fluturim horizontal dhe u fut i qetë në rreth për ulje. Pas atij veprimi ai ndjeu një lehtësim të madh, dhimbja dhe goditjet e zemrës i pushuan. Ankthi ju largua fare, bile filloi të ndihet i gëzuar dhe padashur filloi të këndoi një këngë korçare. "O vemi o s'vemi/ atje ku dielli dhe bota nuk na sheh!..." Bardhi po fluturonte jo si zakonisht në rreth në lartësinë 500 m sepse ishte pa fanarin, pjesën e lëvizëshme të kabinës. Kontrollioi dhe u sigurua se motori dhe aparaturat e tjera të aeroplanit, të gjitha punonin normalisht. Qeshi dhe tërë avioni u drodh e u turr si ajo delja e zënë në faj nga bariu dhe që s'di se ku të fshihet.

"Hajde gene! Te dua më shumë se veten. Kemi qene dhe do te jemi përsëri bashkë."

KRIZA EPOKALE Mohimi i realitetit historik

Nga prof. NEBI AGOLLI, Durres

Realiteti historik është i gjallë, është një realitet konkret, një realitet i veçantë që dallohet nga shkallët e tjera të qenies, i cili jeton në përputhje me ligjet e veta, i cili njeh të mirën e tij dhe të keqen e tij, dhe në të cilin nuk zbatohen kriteret teorike e të mirës dhe të keqes. Në natyrën e realitetit historik, shihet ligji i tij i të mirës jo racionalisht konform me ligjin e të mirës të realitetit individual. Në realitetin historik që nuk mund të shihet vetëm përmeshja e fatit individual të njeriut, të masave, ku mekanikisht kombinohen veprimet individuale dhe kolektive arbitrare njerëzore; mund të shihet plotësimi i fatit të komuniteteve, të kombeve, të njerëzimit dhe të botës si një realitet konkret, si organizma reale. Njerzit kanë mohuar realitetin historik, ata nuk kanë parë një jetë të brendshme organike. Realiteti iu ka shpetuar nga dora dhe kështu që në duart e tyre mbeten vetëm lecka abstrakte të realitetit, mbetje të qenjes. Njerzit janë bërë atome dhe shoqëritë në një mekanikë atome, në një kolektiv i papërcaktuar atome. Në këto atome shpërbëhet çdo qenje. Por në të vërtetë njeriu nuk është atom, por individual, individualitet, një qenie që dallohet. Megjithatë ka vetëm atome dhe masa. Njerzit kanë dashur të nënvenin të gjithë historinë në votimin universal, dhe paraprkishtë se masat nuk e njohin historinë e tyre. Nuk mund të aplikohet në histori votimi universal dhe nuk mund të bëhet moral në lidhje me historinë. Realiteti historik është një realitet i mbyllur, nuk është dera e kyçur i një burgu. Në realitetin historik ka mangësi të realitetit suprem shpirtëror, fuqi që rrjedh nga tre dimensionet drejt dimensionit të katërt. Kjo mangësi hedh poshtë të gjitha doktrinat racionaliste të procesit historik, duke thyer të gjitha ligjet e logjikës së sociologjisë racionale. Edhe arrijtet e larta krijuese të procesit historik janë shkelur në këtë botë. Në procesin historik botëror veprojnë jo vetëm forcat e brendëshme shpirtërore, por edhe forca misterioze, të cilat nuk kanë asnjë kalkulim, forca të mira dhe forca të errëta. Çdo rend historik-naturor humbet hapin, shpërbëhet, humbet konturet e tij dhe hyn në një dimension të pafund. Rendi historik-naturor, në fakt, nuk mund të përmbajë jetën absolute. Çdo fitim i jetës absolute është një pasazh përtej kufijve të rendit historik-naturor.

Historia është vetëm një nga gradët e realitetit absolut. Por realiteti absolut nuk mund të depërtojë plotësisht në histori. Historia ka një kuptim absolut, një origjinë absolute dhe një fund absolut. Të gjitha qëllimet e historisë janë relative në krahasim me qëllimin absolut, të gjitha qëllimet shndërrohen vetëm në mjete. Relativi është një manifestim i absolutit, por absoluti nuk mund të jetë tërësisht në relativ. Absoluti në vetvete nuk mund të jetë i përmbajtur. Ai mund të përmbajë realitetin historik, por realiteti historik nuk mund të jetë absolut. Mungesa e matësisë mes absolutit dhe relativit, nuk mund të mendohet si mbyllje e sferës të relativit, izolimi i historisë nga realitetet supreme. Relativi manifestohet në absolutin, kërkon absolutin. Mbi këtë bazohet arsytimi i relativit dhe të drejtat e tija. Relativ është përbrendësisht i nevojshëm që të dal në pah plotësia e absolutit. Prandaj relativit nuk mund të ndahet nga absoluti dhe në kundërshtim me të. Muk mund të mendohet bota si ballafaqim i jashtëm i absolutit. Por, kur relativit absolutizohet, vuajtja e botës lidh shpirtin. Në thellësi të jetës shpirtërore të njeriut, jepet dhe zbulohet absoluti. Njerziti, të zhytur në realitetin absolut, nuk janë skllëvër të botës, nuk janë pre e mbretërisë të relativit. Është vetëm në parashikimet e jashtme të jetës së tyre që ata imagjinojnë se i përkasin plotësisht mbretërisë të relativit. Jeta absolute është kalimi në një nivel tjetër, një tjetër dimension të qenurit. Sipas masës që kanë në thellësi, njerëziti i përkasin një realitet tjetër. Logjika objektive e jetës njerëzore zbulohet në dy aspekte, në aspektin fetar dhe atij natyror. Si për të vërtetën, edhe për dimensionin shpirtëror arrihet duke filluar nga bota natyrore. Lidhja në mes jetës njerëzore dhe të gjithë jetës natyrale është identifikuar, ndonëse edhe në mënyrë të kufizuar dhe të pjesshme. Nëse natyra është burimi i gjithë pasurive, njeriu është vetëm një prej tyre. Si njësi i natyrës, njeriu nuk mund të konsiderohet si "pronar" i të njejtës natyrë. Nuk mund të dhunojë natyrën. Në botën natyrore është e mundur për të aplikuar kategoritë e diversitetit dhe ripërsëritjes. Jeta njerëzore ka një bazë misterioze, si ajo e të gjithë natyrës organike, nga të cilat nuk mund të ndahet bota njerëzore. Në botë, në jetën historike dhe natyrore, është e mundëshme mrekullia, është i mundëshëm rigjenerimi, është i mundëshëm çlirimi nga vuajtja e botës dhe nga barra e historisë, është e mundëshme të thyehen pragat e nevojshmerisë logjike. Bota e lashtë nuk njohte limitet e forcave natyrore. Nuk ishte në gjendje t'i dallonte. Në botën e lashtë hyjnia lidhej me fenomenet natyrore, dhe nevojshmëria natyrale ishte i kufizuar nga vërtetësia hyjnore. Historia mbitëgjitha ka një domethënie simbolike, ajo është plot me shenja të një realiteti tjetër, hyjnor.

Në rrëfimin e krishterë është përfshirë një deklaratë e të drejtave të shpirtit njerëzor shumë e veçantë, e miratuar nga Perëndia. Organi mistik, unik dhe i tërë krishterimit, hierarkik në rendin e tij, manifestohet në shkallë të ndryshme, ka bërthamën e vet dhe periferinë e saj. Për krishterimin Mbretëria e Perëndisë është fundi i historisë, është përfundimi i historisë, është kapërcimi i kufijve të historisë. Për krishterimin kërkimi i Mbretërisë së Perëndisë në histori, në realitetin historik, në tokë është një gabim, një iluzion optik. Mbretëria e Perëndisë është përtej historisë dhe sipër historisë, por jo në histori. Krahasuar me tri dimensionet e historisë është dimensionit i katërt. Nuk mund të kërkohet dimensionit i katërt në tre dimensionet e hapësirës. Pra Mbretëria e Perëndisë, në kuptimin e saj më të thellë, nuk mund të kërkohet në histori. Por megjithatë ndërgjegjia njerëzore e kufizuar kërkon Mbretërinë e Perëndisë brenda historisë.

(vazhdon ne numrin e ardhshëm)

THIRRJE E SHOQATËS ESPERANTISTE TË SICILISË Esperanto dhe Qytetërimi

Pergatiti per botim - BARDHYL SELIMI

Sistemi shoqëror njerëzor aktualisht reflekton lidhjet e egra të ndërsjella, të cilat në natyrë gjallesat i mbajnë ende nga nevoja për mbijetesë, si individë apo si lloj.

Në planetin tonë, ku mishi i gjallë duhet të ushqehet me mish të gjallë për të mbijetuar, njerëzit e lashtë i interpretonin të dridhurat e zemrës për shkak të pusive dhe fundeve tragjike të jetës, si një dëshirë dhe kënaqësi të zotave, kështu që ata e vlerësuin si të nevojshme nënshtrimin e tmerrshëm ndaj bërjes së riteve të flijimeve për t'i bërë ato më të favorshme. Ne, gjahtarët e zotë, me përvojë për dënime dhe falje, ndërsa i përçmojmë ata si barbarë, vijojmë të llupim sipas zingjirit ushqimor. Në këtë sferë të bukurisë dhe vdekjes, në Tokën e dashur që na vret, por që mendohet që ne do e vrasim, ne njerëzit, me një idealizëm kokëfortë, kemi menduar se jemi të aftë ta përmbysim këtë proces shtazarak, që na e ka kaluar neve natyra, me anë të qytetërimin paqësor dhe jo të dhunshëm, por duke e keqkuptuar.

Një dramë e gjatë kjo e gjinisë njerëzore, të kalosh përmbri shtazërisë! Qëkur ne u përpoqëm të largohemi nga kjo, duke pasur sukses vetëm përgjysëm, njerëzit e lashtë, që janë ende te ne, po na e shqyejnë psikikën tonë. Dhe kjo dyfrësi torturuese e brendëshme, pasqyrohet në demokracinë e gënjeshtër, që ne njohim. Njeriu i skicuuar mund të krijojë vetëm një demokraci hipokrite, që është një mëtim absurd për t'ju nënshtruar asaj, nga e cila nuk mund të çlirohet: dmth nga mbizotërimi, që shmag çfarëdo rregulli, që e pranon vetem vetveten dhe nuk është i aftë të respektojë cilëndo: instinkti i saj kryesor është të shqyejë, duke favorizuar kështu urdhërin e lashtë për kënaqjen e plotë të atij që ftohet në shtëpi, pa qenë i shkëputur nga ato që e brejnë nga brenda, sikurse në të kundërt njerëzit e zakonshëm janë detyruar të jenë.

Qytetërimi i mbizotërimit ka qenë një ide genialisht e çmendur, eksperiment për hibridizimin, që prodhoi atë përbindësh luminisht, që është mbizotërimi i fshehtë.

Ky është çelësi për të kuptuar botën e djeshme dhe të sotme, luftën dhe paqen e gënjeshtër, gjahtarët dhe pretë e xhunglës së gjelbër dhe të hirtë, dmth tregut. Të kuptosh ndërgjegjen qetësuese të atij që realizon fljimin sistematik të kafshëve, që bën gjenocid, që shkakton uri, që pushton, përvetëson, skllavëron, u mohon të drejtat, drejtësinë dhe çfarëdolloj rendi, duke u dehur nga kjo; ai vepron absolutisht në vijën e parimeve të dhunshme dhe të pamëshirshme, që vlejné që nga Krijimi: ai është përbri kundërtshënëve, sepse e tërë ekzistenca e tij merr pjesë në pafalsinë logjiko- gjeometrike, të barazpeshuar dhe të akullt, që është një ligj i brendëshëm.

Të gjitha Kartat Kushtetuese të vlefshme kanë të bëjnë me epokën e vjetër të mbizotërimin hipokrit, sipas prejardhjes dhe përmbajtjes. Pothuaj të gjithë ata që sot nderohen me titujt e ekspertëve kushtetues, në mënyrë të habitshme pa aftësi kritike, janë vetëm dijetarë të një kodi të pavlerë, që ka të bëjë me një botë tjetër. Kushtetutat nuk duhet të saktësohen apo të përditësohen, ato duhet të përmbysen fare, të zevëndësohen: prandaj kemi nevojë për mendimtarë të një lloji tjetër. Këta njerëz të së ardhmes, ekspertë të pamësuar me të drejtën juridike, duhet të kenë një shikim dhe genialitet epror, por edhe një shpirt kritik. Megjithatë kjo nuk është gjithçka: ata duhet të zotërojnë guximin e shpirtave të lartë, për të përmbysur konceptimin për të drejtën, për themelet e jetës, për qiellin tonë të ngushtë dhe madje mënyrën për ta konceptuar revolucionin, që është kryesisht i tipit mendor.

Por mbase as kjo nuk mjafton: ata kanë nevojë edhe për kurajo për vuajtje. Bashkimi i jashtëzakonshëm i mendjes dhe i zemrës, që ne e quajmë qenie njerëzore, nuk heq dorë dhe nuk mundet t'i nënshtrohet egërsisë sistematike natyrore dhe shoqërore; dhe nuk mund të humbasë dëshirën për harmoni. Një harmoni e tillë quhet paqe por kuptimi i saj është tjetërsuar. Paqja nuk ka një domethënie të tillë të rëndësishme, që kanë ndërmend t'ja japin asaj. Paqja është një gjendje pa luftë, një pushim beteje ndërmjet luftëtarëve, që mbeten të tillë, luftëtarë; ajo aspak nuk është një ndryshim i përfundimtar i mendjes dhe i psikikës: ajo mund të jetë pak a shumë e vazhdueshme por një fakt zhvillimor. Megjithatë, kjo fjalë tani është thuarje me domethënie boshe: dhe ligjëruessit, me këmbëngulje, e përdorin atë, teveqelët e shijojnë. Të tjerë turpërohen prej saj. Sidoqoftë, kush nuk e sheh që në të vërtetë ekziston një vështirësi objektive për të rënë në bashkëujdi, që të ndërpritet çfarëdolloj gjendje lufte dhe të fillohet me të vërtetë bashkëpunimi ndërmjet njerëzve, bashkësive dhe kombeve?

Këtu nuk e mohojmë që të pushtetshmit duan



bashkimin por ne themi, që ata duan bashkimin e perandorisë së vet. Ja në çfarë shkëmbi nënujor ka ndodhur shkatërimi ynë. Ku është zelli diplomatik për të arritur ujditë e nevojshme, themelore, të fundit? Diplomacia ende tani merret me aleanca për të fuqizuar palët. Jo për paqen, qoftë edhe të mjerë.

Që prej disa vjetësh, po dëgojmë dhe po u drejtohem poetëve, duke pasur ndërmend të besojmë se ata kanë shqisa perceptimi më të zhvilluara. Ju, o poetë, që jeni zëri i popullit, e juaja është përgjegjësia kryesore për të kapur horizontet e dykuptimta të realitetit, duke grisur pardsynë e errët që mbulon gjithçka dhe bëhet zë për popullin. Sot poeti nuk mund t'i lejojë vetes të jetë thjesht një poet provincial, një kënaqësi sjellës, shpesh vetëm nga kënaqësia e vet. Ai është njeri nga ata, që duhet të përgatisë botën e re. Urdhëroni e pyesni veten tuaj përse i afruam të dy flamujt e bukur të poezisë dhe Esperantos! Kini parasysh faktin, që miliona intelektualë në botë e përdorin kohën e vet për ta shpënë përpara Esperanton! Oh, po, thonë që Esperanto është favorizuese e paqes! Më saktësisht, ajo është një yll, një diell që rrezaton harmoni. Ajo është një fole aksi, një bashkuese boshtesh, një diapazon për akordimin e shpirtërave.

Sidoqoftë, le të jemi më praktikë!

Këtu po e interpretojmë në një mënyrë të re rolin dhe aftësinë vepruese të Esperantos. Dhe Sicilia nuk është vetëm vendi ku ka lindur kjo nismë dhe ide, por është simboli, shenja, pa një kufi territorial konkret, një kategori mendore. Mijëra shoqata veprojnë në botë për një përparim qytetar, mendor dhe material. Veprimtaria e tyre, edhe pse ajo mund të duket e efikase, nuk është dhe nuk mund të jetë zgjidhje për faktin e thjeshtë, se këta veprimtarë plot merita nuk janë të lidhur midis tyre ndërsjellazi dhe, veç kësaj, ata nuk bashkëpunojnë, thuhaj se ata marrin pjesë në një regjim konkurrencial, që, kuptohet, duhet të ishte një qëndrim i pa akordueshëm me parimet e tyre. Ata, që bëjnë përpjekje shumë të mëdha për shoqërinë, ndihmojnë duke dhënë ndjenjen se demokracia është në funksionim të plotë, pa e vënë atë në funksionim; edhe ata vetë, madje të dobishëm për disa. Sidoqoftë kjo është një lëvizje që, çmohet, e gjysëm miliard njerëzish. Një forcë pozitive dhe shumë e rëndësishme, që e nënvlerëson vetveten. Megjithatë ajo mund të na shpëtojë. Demokracia është kryesisht bashkëpunim, që duhet të mësojmë ta vemë në përdorim. Në bashkëpunim është çelësi i revolucionit të vetëm të vërtetë të çdo kohe: qytetërimi paqësor. Revolucionet e dhunshëm nuk janë revolucione por rikonfirmim, ose popullor ose aristokratik, i sistemit që ekziston tashmë, primitiv, të egër dhe çnjerëzor, ngritur mbi kundërshtinë e

aspiratave për mbizotërim.

Me anë të Esperantos, falë idesë së saj të brendëshme vëllazërore dhe shpirtit të veprimit për realizimin e vetë çështjes, jemi të mendimit se është e mundëshme të ndihmojmë në formimin e lidhjeve të virtutshme midis atyre që veprojnë për qytetërimin, që është një i vetëm. Të gjitha qytetërimet, që thonë se kanë qenë para tonit dhe i yni vetë, nuk janë aspak qytetërim por shoqëri barbare, për këtë ne duhet të vetëdijesohejmë. Kjo ftesë qetësuese dhe jomëdyshuese nisët nga Sicilia. Asnjë shpallje e paqes, asnjë bashkëpunim për paqe! Një qytetërim harmonik. Një demokraci e rangut të lartë. Në se jeni i të njëjtin mendim me ne, ju jeni sicilian dhe esperantist. Përdallimi i shoqatave duhet të jetë mbrojtës, sepse ai garanton pavarësinë e tyre dhe është një mënyrë veprimi thelbësore e lirisë demokratike dhe e procesit zhvillimor. Izolimi, ku ato veprojnë, mund të tejkalohet shpejt: të gjitha shoqatat në botë, që kanë qëllime të njëjta, mund t'i bashkërendisin veprimet e veta.

Dega e Sicilise Esperantiste do lejojë shkëmbimin e menjehershëm të informatave, thirrjeve. Nga cilido vend i botës po nisët ideja, veprimi, shpejt ato do bëhen të njohura kudo, do botohen në shkallë botërore. Shoqëritë që nuk kanë asnjë esperantist, të përipiqen të gjejnë vullnetarë që ta mësojë atë (kurset janë pa pagesë), që të mund të ndërveprojnë me gjithë të tjerat. Revista përmes internetit në esperanto, që mund të shkruhet dhe përdoret në çdo qoshe të botës, do jetë informuesja më e lirë që është krijuar ndonjëherë.

Problemet shoqërore dhe zgjidhjet e mundëshme do shfaqen atje. Shoqatat do mund të përkthejnë në gjuhët vendore dhe të venë në faqet e tyre të internetit atë që e konsiderojnë të dobishme për një përhapje më të saktë në botën ku ata veprojnë.

Në fund të fundit fermenti i vullnetit të mirë do ketë organin e vet informativ; dhe nuk do jenë revista për vrasjen dhe dhunën, skandalin dhe gënjeshtërën. Populli duhet në fund të fundit të kalojë, një herë të favorëshme, nga kultura e dëshpërimit në kulturën e këndëshme. Sicilia Esperantiste bashkohet ndërsjellazi me institucionet esperantiste dhe të gjitha organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare me strukturat demokratike, që e shpien përpara esperanton dhe paqen, zhvillimin e bazuar, respektin ekologjik për njerëzit, etnitë dhe të gjitha qeniet, ashtu edhe për gjuhët dhe dialektet. Me institucione të tilla dhe me të gjitha lëvizjet qytetare, që përipiqen ta shpien përpara kulturën dhe kulturën për të vërtetën, Sicilia Esperantiste do të bashkëpunojë sipas parimit "të bëjmë bashkë atë për të cilën biem në ujd". Ajo do jetë në anën e të gjitha institucioneve që pranojnë të kenë si qëllim përhapjen e Esperantos. Kjo në perspektivë për të krijuar, sipas mundësisë, bashkimin e forcave që veprojnë për një zhvillim qytetar. Shoqërizimi në rritje për përparimin e bazuar, lëvizja ekologjike në rritje dhe ajo që pengon fuqinë financiare duke denoncur spekulimin duhet t'i gjejë bashkësitë në anën e vet për të pamundësuar ndarjen e rrezikshme, që shkakton oportunitetin e përbashkët në kërkimin e barazpeshave qytetare më të larta. Fjala Sicili merr këtu një përmasë ideale, bëhet një përkatësi simbolike. Kudo që jetoni, çdo njeri, që e bashkëmendon këtë interpretim të ndryshimeve shoqërore dhe rolin qytetues të Esperantos, është për ne Sicilian.

Intelektualët e veçantë, shoqatat, institucionet, bashkësitë, ta përvetësojnë Sicilinë Esperantiste. Ajo lind për këtë motiv. Jo për ta marrë ju, por është marrë për ju.

Kronika e eksodeve dhe vendbanimet arbëreshe në Itali 1272 - 1278

(Vijon nga faqja 16)

komuna ku u vendosën kalorësit albaneze dhe disa pjestarë të familjes të Gjergj Kastriotit.

1463- 1466: Në këto vite, një valë emigrantësh albanezë, zharkoi në brigjet e Italisë, ku filluan një jetë të re. Familje të shumta u sistemuan në Pulia e Molise, ku i dhanë jetë fshatrave Kampomarina, Kieuti, Kasalnuovo, Ururi, Faxhiano, Kazalvechio e Pulia, Portokanone, Shen Paolo, Santa Croce Maliano, Montinjano, Monteparano, Shen Giorgio, Rokaforcata, Shen Marciano, Shen Martino, Sternaria, Zollino etj. Nga 60 familje albaneze, që u vendosën në vitin 1462 në komunën Faxhiano në Pulja, në vitin 1545 u bënë 190 familje, ndërsa në vitin 1560, komuniteti arbëresh kishte 500 familje, madje me dekret mbretëror ishin përjashtuar nga taksa e oxhakut. Si pasojë epidemive, luftërave dhe migrimit të brendshëm, në Faxhiano ne vitin 1669, mbeten 123 familje arbëreshe. (Monografia - Faggiano: "Primo casale albanese nel tarantino"; Taranto 1930). Albanëzët në keto troje të reja, sidomos aty ku u vendosën si fise dhe në grupe familjesh, i ruajtën traditat, besimin ortodoks, madje në shumicën e këtyre komunave, banorët ende flasin gjuhën e të parëve, arbërishten. Në vitin 1866, gjatë një vizite në Rokaforzata, një historiani takoi një arbëreshe të moshuar e cila këndonte disa këngë në gjuhë shqipe dhe njera prej tyre ishte kënga e Shen Lazarit, të cilën pasi e degjoi disa herë, ai e transkriptoi dhe e botoi. Këtë tekst këngë po e prezantoj në vazhdim: "O Zoti, madhe Zoti/Se ka deka Lazarini/E Zoti nenja gjender/Vemmi Eklishi/E shohu Lazarini/E thirti Lazari ngridu/E Lazari ngridi uperbissi/neng pavi, neng favi/neng keshi. Transkriptimi në shqipen e sotme: O Zot, i madhi Zot/Ka vdekur Lazari/E ti Zot nuk u gjende/Ne shkojme ne Kishe/Te shohim Lazarin/E therrasim Lazar ngrihu/Dhe Lazari u ngrijt ne gjunje/ Nuk shihte, nuk fliste, nuk qeshte/.

1467: Në këtë vit, ushtria turke pushtoi shumë treva, çka nxiti valën e tretë të emigrimit të albanezëve. Shumë fise e grupe familjesh lanë trojet arbërore dhe emigruan në Itali. Ky fluks migrator kryesisht familje fisnikësh dhe kushërinj të Skenderbeut, shkuan Sicili, ku u bashkuan me komunitetet albaneze, që ishin vendosur vite më parë në ishull. Kjo masë e madhe refugjatësh, u nda në grupe dhe sipas familjeve u vendosën në komunat Kontessa Entellina, Mezzojoso dhe Palazo Adriano. Për të garantuar jetesën në trojet e reja, shumica e albanezëve u impenjuan me punët bujqësore e me blegtori, ndërsa një pjesë hynë në shërbimin e milicisë të mbretit, ku krijuan repartet e stratiotëve jo vetëm në Itali, por dhe në Francë, Bohemi, San Marino etj. Në fund të vitit 1467, ndër albanëzet, që zharkuan në Sicili, ishin fisnikët: duka Pietro Emanuele Pravatà, duka Zakaria Groppa, duka Pietro Kuçia, duka Pal Mansi, të cilët u sistemuan në pronat, që iu dhuroi mbreti Ferrante I i Napolit. Familjet e Zakaria Groppa dhe e Giorgio Mirespia (Gjergj Mirëshpia) shkuan në Palazo Adriano; dhespoti Cernojeviç në Sant Angelo Muxaro, konti Elia Mullisi në Piana Albanese, ndërsa kapedani Pal Mansi, u bashkua me bashkëvendësit e tij nga Kunavia, të vendosur vite më parë në feudin e Mezzojoso. Populli italian u rezervoi priti të përzemërti refugjatëve, që vinin nga Albania e martirizuar nga pushtuesit osmane. Kjo mikëpritje shprehte admirimin për heroizmin e këtij populli të vogël, që u rezistoi dyndjeve osmane, por ishte dhe mirënjohje për ndihmën e madhe që Skenderbeu i dha dinastisë Aragoneze, ashtu si nuk duhet nënvleftësuar dhe fakti si kjo mikëpritje ishte një llogari politike e mbretërive të Spanjes, Napolit, Frances etj, të cilat kishin interesa t'i merrnin në shërbimin e tyre këta luftëtarë stratiotë të shquar.

1468: Pas vdekjes të Gjergj Kastriotit, ndodhi eksodi i rreth i 300 000 albanezëve, që braktisën trojet e tyre dhe u vendosën në provinca të ndryshme të Italisë, Francës dhe Spanjës. Fillimisht, gjatë avancimit të ushtrisë osmane, popullata albaneze u ngjit në zonat e thella malore, por reprazaljet dhe masakrat e turqëve, një gjenocid mizor kundër albanezëve, e detyroi shumicën e popullit të braktisi vendin dhe të emigroi drejt territoreve të Mbretërisë Aragoneze, Dukatit të Milanos, në Torino, në Val D'Aosta, në San Maurizio, ne Urbino, në Toskana, në Venecia etj, etj.

(Vijon numrin e ardhshëm)

Nel nostra Paese c'è anche tanta "buona sanità"

Di MARIA TERESA CARNEVALI PISANI

Quando ci troviamo in ospedale i balia di mille in cognite e angosce siamo come spersonalizzati, ma alla presenza di un medico alle cui cure siamo affidati, le speranze si riaccendono. Un qualsiasi altro operatore sanitario che ci tratta con affabilità e rispetto, ci sembra un angelo. Ci sentiamo rassicurati e la malattia assume un altro decorso, più promettente. Ma perché funzioni veramente, tra malato e personale medico e sanitario ci deve essere una grande umanità, una grande empatia e fiducia reciproca altrimenti chiamata "alleanza terapeutica". Anche il malato deve sforzarsi di presentare al medico precise indicazioni sui sintomi da lui avvertiti. Nello specifico ho riscontrato tali caratteristiche nella fisioterapista Luisa, che tanto mi supporta e mi incoraggia con la sua costante e premurosa opera riabilitativa del miei arti inferiori in seguito gli interventi chirurgici. Altrettanto sostegno mi viene dal medico di famiglia, dottor Francesco Serafini dotato di grande umanità e umiltà, oltre che di notevole impegno professionale, basato sulla costante ricerca scientifica e solerzia nella soluzione del problema. Stessa dedizione di sua madre, mia indimenticata collega nell'insegnamento esercitato nella scuola primaria. Stesso senso del dovere e costante impegno. Sono indignata nel sentire parlare insistentemente di "mala sanità". Usare questo marchio generalizzato è ingiustificato e offende che chi lavora costantemente con coscienza. Mi sembra ora di riconoscere che nel nostra Paese c'è anche tanta "buona sanità" anzi, "molta di più! E di farla conoscere anche per ridare fiducia e serenità a chi ne deve fare ricorso. L'umanità non ha bisogno di spauracchi, ma di fiducia in chi svolge un lavoro tanto impegnativo e di tanta importanza.

Shekspiri, njohës i mirë i historisë shqiptare

Nga MSc. LEDIO XHOXHI

Kurator në Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë
(Shqipëri)

Uiliam Shekspiri e ngriti artin poetik në majat më të larta. Vepra shekspiriane është e admirueshme si tërësi në dhe në përbërësit e veçantë. Nuk ka aktor që nuk do dëshiron të luante në një pjesë të tij. William Shakespeare (shqip: Uiliam Shekspiri) është dramaturgu më i njohur anglez i cili lindi në vitin 1564 dhe vdiq më 1616.

Periudha e pjekurisë së Shekspirit (1595-1602) njihet si periudha e komedive të mëdha, një nga të cilat ishte "Nata e Dymbëdhjetë" (1601). Shekspiri nuk ka qenë kurrë në Ilirinë tonë, por ka shkruar për të në komedinë "Nata e dymbëdhjetë". Çfarë e ka tërhequr këtë gjeni të vendosë ngjarjet e veprave të tij të pavdekshme në brigjet e detit Adriatik? Brigje të cilat ai s'i ka shkelur kurrë! Më duket diçka e çuditshme kjo vëmendje e Shekspirit në sjelljen e skenave në brigjet e Adriatikut. "Nata e Dymbëdhjetë" u përkthye nga Vedat Kokona dhe u vu në skenën teatrale shqiptare më 1982.

Ashtu si shumë komedi të tjera të Shekspirit, edhe kjo komedi përqendrohet mbi identitetin e rremë. Në skenat hyrëse, personazhi kryesor, Viola, shpëton nga mbytja për shkak të fundosjes së anijes dhe del në bregdetin e Ilirisë. Ajo humbet lidhjet me vëllanë e saj binjak, Sebastianin, të cilin e mendon tashmë të vdekur. Tek ambjentohesh me skenat e ndryshme të kësaj komedie, të duket sikur dhe ajo, Viola, është nga Iliria. Orsini është Duka e Ilirisë, kapiteni i anijes është vendas, nga Iliria. Më pas Shekspiri na thotë se në komedi marrin pjesë zotërinj, priftërinj, detarë, policë, muzikantë etj.

Dhe Shekspiri vazhdon të sfaqojë: "Skena zhvillohet në një qytet të Ilirisë dhe në bregdetin që është aty pranë". Në aktin I, skena II, Viola pyet:

- Ç'është ky vend, o miq? - e kapiteni i përgjigjet: - Iliria, zonjë.


Pak më poshtë Viola e pyet kapitenin:

- E njeh këtë vend? - dhe kapiteni i thotë:

- E njoh shumë mirë, zonjë; tri orë larg në këmbë nga ky vend linda, u rrita. E akoma më tej Viola e pyet:

- Kush qeveris këtu? Kapiteni përsëri e sqaron se atë vend e qeveris një dukë fisnik nga natyra dhe emri, i quajtur Orsino. E sër Tobi i thotë se duka i ka shokët e rrallë në Iliri.

Iliria është vendi ku komedia "Nata e



dymbëdhjetë" është vendosur dhe Duka Orsino, personazhi kryesor mashkull, është sundimtari i atij vendi. Pse Shekspiri e vendosi shfaqjen e tij në Iliri dhe pse zgjedh emrin italian "Orsino"? Ku ishte Iliria e tij? Qëllimi i këtij studimi është për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, po kështu, për të provuar duke u referuar historisë, që Iliria e Shekspirit ishte një rajon i përcaktuar mirë në Adriatik dhe që gjatë periudhës bizantine ka sunduar një historikisht i vërtetë "Duka Orsino".

Shekspiri mund të ketë pasur në mendje bregdetin e Shqipërisë së sotme dhe mund të ketë mbledhur informacione nga marinarët ilire dhe tregtarët me banim në Londër. Për shkak se dramaturgu nuk e përshkruan vendin dhe për shkak se disa nga personazhet komike janë modeluar mbi personazhe reale angleze, si dhe atmosfera e shfaqjes me dashurinë e saj melankolike, tipike Shakespiriane, kritikët mund të pretendojnë se Iliria është vend që nuk ekziston dhe sundimtari i saj, Duka Orsino, një shpikje e tij.

ILIRIA ANTIKE (FAKTE HISTORIKE)

Territori i Ilirisë përfshinte Ballkanin Perëndimor, nga gadishulli Istra dhe lumenjtë Drava e Sava (degë të Danubit) në veri, deri te gjiri i Ambrakisë (Prevezë) në jug; nga detet Adriatik dhe Jon në perëndim deri te lumenjtë Morava e Vardari në Lindje. Gjatësia e kësaj treve (veri-jug), sipas romakëve, ishte 1.100 km. Bashkësia ilire jetonte në fise, të cilat kishin territoret e tyre. Aleksandër Stipçeviq flet për 70 fise ilire, por

numri i tyre duhet të jetë akoma më i madh.

Zhvillimi i shoqërisë ilire tërheqi vëmendjen e qytet-shteteve greke duke formuar kolonitë e tyre. Kolonia më e hershme u vendos në vitin 737 para Krishtit në ishullin e Korkyrës, që banohej atëhere nga liburnët. Një valë kolonistësh u vendosën në Dyrrah (Durrësi i sotëm) më 627 para Krishtit, nga këtej, në vitin 588 para Krishtit themeluan Apoloninë dhe më tej me radhë qytetet të tjera ilire.

Gjatë aktit 4, skena I: Feste, klouni në shërbim të Olivias, takon në rrugë Sebastianin, vëllain binjak, duke besuar se ai është Cesario, i kërkon për të shkuar në shtëpinë e Olivias. Sigurisht Sebastiani nuk e kupton se ai e ngatëroi me dikë tjetër dhe përpjet ta heq qafe klounin. Por Feste vazhdon me të tijën, kështu që Sebastiani shpërthen me acarim dhe i thotë: "grek i marrë, largohu nga unë".

Illirët flisnin gjuhën e tyre, ilirishten, por fatkeqësisht ilirishtja nuk ka ardhur deri në ditët tona në formë të shkruar. Gjurmë të ilirishtes ruhen në shqipen e sotme, në antroponimi dhe në toponimi, nëpër të gjithë territorin e sotëm shqipfolës. Ilirishtja ka qënë gjuha e folur ndër illirët, kurse greqishtja e vjetër dhe latinishtja më vonë, janë përdorur nga illirët si gjuhë të shkruara.

Arsyeja pse Sebastiani e quan gaztorin "i marrë" dhe pse duhet që një gaztor të jetë një "grek" nuk është shumë e qartë. Megjithatë, kuptojmë përdorimin e kësaj fraze në qoftë se pranojmë që Shekspiri kishte në mendjen e tij banorët e një vendi greqisht folës, që është Iliria Bizantine (ose Epiri), ku edhe greqishtja përdorej si gjuhë e shkruar apo dhe e folur. Frazja "grek i marrë" mbështet argumentin se Iliria (më saktë Epiri) është vendi ku Shekspiri mendoi të vendosë "Natën e Dymbëdhjetë".

Pas luftës së tretë iliro-romake (168-167 para Krishtit), shteti ilir u pushtua dhe u kthye përfundimisht në provincë të zakonshme romake. Pas pushtimit romak, illirët nuk u asimiluan si disa popuj të tjerë Evropianë e Ballkanikë, por ruajtën individualitetin etnik, gjuhën dhe kulturën e tyre. Gjatë shek. IV-VI pas Krishtit u thellua shumë kriza ekonomike, shoqërore dhe politike e Perandorisë Romake. Në fund të shek. IV pas Krishtit filluan dyndjet e bashkësive gjermanike, fiset gote (strogotët-gotët e Lindjes, vizigotët-gotët e Perëndimit).

ILIRIA MESJETARE (FAKTE HISTORIKE)

Në vitin 395 pas Krishtit, perandori Teodos i ndau Perandorinë Romake në dy pjesë: në Perandorinë

Romake të Perëndimit me qendër Romën dhe në Perandorinë Romake të Lindjes, të quajtur Perandoria Bizantine, me qendër Kostandinopojën (qytet i themeluar nga një koloni greke në vitin 660 para Krishtit me emrin "Bizantin", por i rithemeluar si Roma e re nga perandori Kostandini i Madh, iu dha emri Kostandinopojë).

Nga shek. IV-IX pas Krishtit, Perandoria Romake dhe më pas ajo Bizantine u përfshi nga dyndjet e mëdha të popujve hunë, avarë dhe sllavë. Sllavët sollën ndryshime rrënjësore sepse krijuan shtetet sllave në Ballkan dhe asimiluan popullsinë e pjesës veriore të Ilirisë. Kolonizimi sllav i Ballkanit solli rrudhjen e trevës ilire, e cila u kufizua në katërkëndëshin: Gryka e Kotorrit - Nish - malet e Pindit (në lindje të Janinës) - Artë.

Si rezultat i dyndjeve sllave, sundimi bizantin u shemb pothuajse në të gjithë Gadishullin Ballkanik. Në fillim të shek. IX, organizimi administrativ u bë mbi bazën e temave. Ato paraqiteshin si "shtete të vogla" brenda shtetit bizantin. Trevat shqiptare u ndanë në temën e Durrësit (nga Tivari deri në Vlorë), të Nikopojës (nga gjiri i Vlorës deri në gjirin e Ambrakisë), të Dalmacisë (krahinat e pjesës veriore), të Selanikut (krahinat e pjesës lindore dhe verilindore) të cilat më vonë u përfshinë në Temën e Shkupit. Në shek. XIII, në Temën e Nikopojës u formua një formacion i ri shtetëror me emrin Despotati i Epirit, si një principatë e pavarur bizantine me qendër Artën.

Nën presionin serb dhe përballë udhës së krerëve shqiptarë me anzhuinët e Napolit, qysh në vitet e para të shek. XIV, Perandoria Bizantine u ruajt pak a shumë në mënyrë të qëndrueshme në trevën që përfshinte viset e Myzeqesë, Vlorës, beratit, Këlcyrës, Skraparit, Ohrit, Korçës, Kolonjës e të Kosturit. Këto territore Perandoria Bizantine i oragnizoi në një njësi të veçantë politiko-administrative, në Despotatin e Beratit. Viset në jug të këtij despotati, territoret poshtë Vlorës dhe rrjedhës së lumit Vjosa vazhduan të bëjnë pjesë në Despotatin e Artës (Epirit).

Përfaqësues i drejtpërdrejtë i pushtetit bizantin në Despotatin e Beratit ishte qefalio, që ishte para së gjithash një funksionar ushtarak. Me qëllim që qefalio të mbahej sa më shumë nën kontroll, pushteti qendror e vuri atë nën vartësinë e një funksionari epror, i cili ushtronte pushtet të pafufizuar në despotat. Ata zgjidheshin gjithmonë nga rrethi familjar i perandorit dhe mbanin tituj të lartë, si dukas, despot, protovestiar.

(Vijon në faqen 23)

(Continua da pagina 4)

per il 15 marzo 1844. Le sue speranze andarono deluse perché la prevista sommossa si risolse in un fiasco clamoroso con una strascico tragico. Era un avvenimento che lo scosse in maniera particolare poiché coinvolgeva la comunità arbëresh cosentina e alla quale aveva tentato di partecipare con ogni mezzo disponibile. La infelice conclusione della sommossa con la scia di morti che si portò con sé, cui si aggiunsero i martiri dei fratelli Bandiera, lo scosse profondamente. Egli iniziò a dubitare che il governo borbonico fosse riformabile dall'interno, ma che l'unica via possibile era il suo abbattimento, un sentimento che doveva poi corroborarsi per gli eventi occorsi nel successivo 1848.

Nel 1845 riacquistò la libertà e continuò a restare a Napoli presso il fratello Vincenzo, per mantenersi in contatti con agli ambienti liberali e organizzare una nuova rivolta in Calabria. Il 1848 il sogno di poter costruire una monarchia costituzionale sembrava essere a portata di mano. Il 27 gennaio la centrale Via Toledo veniva invasa da una immensa folla festante che si recava davanti al Palazzo reale a chiedere la Costituzione. Il re impressionato da questa marea umana e dal clima di entusiasmo nei confronti della corona, decisa di firmarla chiamando gli elettori ad eleggere il Primo Parlamento napoletano. "Il popolo si era destato dal "secolare servaggio", come si scriveva sui periodici. Era una grande vittoria per Domenico Mauro che veniva eletto deputato con una votazione plebiscitaria, avendo ottenuto quasi il 50% dei voti nel suo collegio. Si trattava di un successo insperato che fu acclamato da una immensa folla e accompagnato da manifestazioni di giubilo e dalla speranza di poter finalmente inaugurare una era di crescita e di sviluppo nel rispetto delle libertà politiche fondamentali.

Fu solo una illusione. Il re fu chiamato a Vienna dalle potenze alleate e gli venne imposto di annullare la carta, mentre a Napoli affluivano i deputati eletti che dovevano riunirsi a Montelivoto per la sua approvazione. Lo "spergiuro reale", come venne definito, creò un clima di accesa rivalità nei confronti della monarchia, e a Napoli vennero innalzate barricate il 15 maggio per instaurare la Repubblica, mentre i deputati erano chiusi in Parlamento. Decisero di sciogliersi per evitare un bagno di sangue, ma ciò

Un patriota albanese

di ORESTE PARISE

non impedì l'intervento dei gendarmi intervenne la polizia per arrestare quelli che venivano considerati i più facinorosi. Domenico Mauro riesce a sfuggire alla cattura e rifugiarsi in Calabria, dove a Cosenza è nel frattempo scoppiata la rivolta e viene costituito un Comitato di Salute Pubblica. Vi facevano parte gli elementi più rappresentativi della provincia: Giuseppe Ricciardi, in qualità di presidente, lo stesso Mauro, Raffaele Valentini, Eugenio De Riso, Stanislao Lupinacci, Francesco Federici, Giovanni Mosciaro. In tutti i comuni viene affisso un infuocato proclama scritto da Domenico Mauro, con il quale si invitano i calabresi a rivoltarsi contro il governo borbonico. Successivamente lo stesso proclama viene stampato sul periodico "L'Italiano delle Calabrie". A difesa dei rivoltosi, dalla Sicilia arriva un esercito di volontari al comando del generale Ribotty. Domenico Mauro si reca a Paola a ricevere il corpo di spedizione siciliano e in quella occasione gli viene affidato l'incarico di Alto Commissario per il Distretto di Castrovillari con pieni poteri per predisporre la difesa della regione dall'attacco sferrato dall'esercito borbonico, al comando del generale Lanza, inviato dal re per ristabilire l'ordine in Calabria. Il Comitato arruola volontari da tutti i paesi della provincia, i giovani accorrono numerosi, soprattutto dai paesi albanesi dove il prestigio di Mauro era molto elevato ed egli esercitava una forte influenza personale. Egli assunse il comando di questo esercito raccoglietici, formato da migliaia di giovani con poche armi e munizioni costituite esclusivamente da quelle di cui disponevano nelle case, senza alcuna preparazione e inferiori comunque di numero rispetto alle truppe del generale Lanza. A questo si aggiungeva l'impreparazione militare dello stesso Domenico Mauro, che fidando nella sua intelligenza e nella cultura classica, con molta supponenza non tentava neanche di concordare una linea di azione con il generale Ribotty, che certamente aveva una maggiore esperienza e poteva predisporre un piano di difesa più adeguato alle condizioni del terreno e alle forze

in campo.

Lo stesso Ribotty guardava con molta sufficienza questo giovane arrogante, la cui unica arma era una supponenza difesa con una oratoria affascinante, ma incapace di una visione delle operazioni da compiere. "A Campotenese in opposizioni ai borbonici del gen. Lanza, le forze del Mauro fecero quanto era possibile", scrive Mario Borretti autore di una sua biografia, ma gli atti di eroismo nulla poterono contro le truppe del Lanza ed andarono incontro ad una rovinosa sconfitta. Negli scontri rimase ucciso anche Vincenzo Mauro, fratello di Domenico. Domenico Mauro fu persino accusato di tradimento per non essere riuscito a fermare l'esercito napoletano, lasciando sul terreno molti giovani calabresi, la maggioranza dei quali era arbëresh, che diedero un altro tributo di sangue. Bisognerebbe piuttosto parlare di arroganza e di incompetenza, poiché la disparità nel numero e negli armamenti avrebbe dovuto consigliare una condotta più prudente, evitando lo scontro in campo aperto. Scrive al proposito Francesco Tajani. "Siculi e Bruzi uniti, ma scarsi di armi e munizioni, con molti capi, quasi tutti nuovi al mestiere della guerra, dovevano precludere la via ai regì per ignote direzioni posti già in moto. I paesi albanesi concorsero tutti, Civita, Percile, Frassineto, San Basile, Lungro, Firmo, Spezzano costituiti potevano punti fermi di una linea sulla sinistra sponda del Crati, appoggiati ai monti, e mantenere una lunga guerra difensiva diretta a travagliare i nemici nelle valle, se concatenati si fossero tutti quanti ve ne sono tra le gole del Tanese e Cosenza."

La confusione provocata dagli ordini contraddittori e l'evidente inferiorità delle forze portarono a uno scoraggiamento di quei giovani che si risolse in una precipitosa fuga nel timore che si potesse concludere con una spaventosa strage. Nel frattempo nuove truppe arrivavano da Napoli comandate dal generale Busacca e non si riuscì ad impedire che si riunissero formando un corpo d'armata contro il quale qualsiasi tentativo di resistenza sarebbe stato inutile perché

troppo superiore per truppe, armamenti e capacità strategiche. I rivoltosi furono costretti a capitolare e sciogliere il Comitato di Salute Pubblica. "Molto fu se i siculi riuscirono ad imbarcarsi nei legni sul mare Ionio, e tutti gli armigeri sopra Cosenza ripiegarono," aggiunge il Tajani. Immediatamente fu una Corte Criminale per la "grande processura" contro i componenti del Comitato e gli insorti. Il 13 novembre 1853 Domenico Mauro, "uomo infernale e nemico di ogni governo", venne condannato a morte col terzo grado di pubblico esempio con l'accusa di cospirazioni continuate ed attentati al fine di distruggere e cambiare la forma del governo e di eccitare gli abitanti del regno ad armarsi contro l'autorità regia. La sentenza, dove veniva definito settario e agitatore politico, autore di un proclama "sommamente sovversivo ed incendiario", venne pronunciata dal procuratore generale, Gaetano Grimaldi. Molti altri furono condannati a pene severissime che dovevano servire da esempio e monito. Per dare maggiore pubblicità al processo di dispose che la sentenza venisse affissa in tutti i comuni del Regno e resa pubblica con regolare affissione e bando pubblico. Domenico Mauro però era riuscito a fuggire ancora una volta, imbarcandosi a Crotona, dove era arrivato insieme con i soldati siciliani del generale Ribotty. Si diresse alla volta di Corfù insieme al suo inseparabile compagno Eugenio De Riso e qualche altro, dove trovarono una favorevole accoglienza. Nell'isola greca si fermò poco tempo, poiché desiderava tornare in Italia. Prima si recò a Roma in soccorso della Repubblica e poi a Firenze per chiedere al primo ministro liberale Guerrazzi un aiuto per provocare una rivoluzione liberale nel Mezzogiorno, ricevendone una accoglienza fredda e formale. Si vide costretto a cercare asilo a Torino dove vi era una vasta schiera di fuoriusciti colpiti dalla reazione dei vari stati italiani. Tra di essi vi erano i calabresi Romeo, e Antonino Plutino, il siciliano arbëresh Francesco Crispi, che venivano sussidiati da un Comitato Centrale per l'Emigrazione, uno strumento mezzo escogitato dal conte di Cavour per attrarre i liberali italiani e convertirli alla causa sabauda. Il sussidio e qualche lavoro saltuario diedero al Mauro la possibilità di una dignitosa esistenza nella capitale sabauda e lo misero

(Continua a pagina 22)

Më jepni një motiv të rri në Shqipëri

Nga MANJOLA BREGASI-



Largimin nga Shqipëria nuk e kisha menduar kurrë, madje as në vitin 1997, kur nën emergjencën e kërcënimit për jetën, emigrimi shihej si e vetmja mundësi. Mbase e nxitur edhe nga prindërit që më përsërisnin vazhdimisht fjalën: "Do bëhet një ditë Shqipëria", vendosa të rri e madje të përpiqem që çdo ditë, të ndihmoj për ta bërë Shqipërinë dhe veten, ashtu siç prindërit më mësuuan, me punë të ndershme. Por sot, prindërit e mi ndjehen të penduar për fjalën që më ngulën në kokë për vite me radhë. Tani ata më thonë: "Nuk bëhet Shqipëria" dhe ju duket shumë vonë për çdo vendim tjetër. E kur thonë nuk bëhet Shqipëria, prindërit e mi nuk e kanë fjalën as për rroga apo pensione të mira dhe as për jetë luksi e makina të shtrenjta. Kur thonë "nuk bëhet Shqipëria", ata e kanë fjalën për vetë jetën. Ndaj këtë radhë nuk më ndaluan, kur vendosa të aplikoj lotarinë amerikane, edhe pse u kërkova një motiv për të qëndruar në Shqipëri. Për fat të keq askush nuk ma dha këtë motiv: as realiteti, as miqtë e tashmë as prindërit, që me mësuuan deri sot: se guri rëndon në vendin e vet. Por me sa duket, shqiptarët nuk duan të jenë më gurë që rëndojnë. Në një sondazh të realizuar nga Opinion.al vetëm pak ditë më parë, të pyetur nëse mendojnë të largohen nga Shqipëria drejt një vendi tjetër për të ardhme më të mirë, 91% e votuesve kanë thënë "po". Dhe e dini çfarë? Ky ka qenë një ndër sondazhet më të votuar në faqe, duke arritur një numër rekord prej 5 mijë pjesëmarrësish. Dëgjoj shumë miq që duan të ikin. Disa për të gjetur një punë që nuk e kanë, disa për të ardhmen e fëmijëve, disa për një jetë më të mirë pa stresse dhe telashe. Unë nuk kam asnjë nga këto arsye, sepse të gjitha më duken shumë përpara vetë jetës. Unë dua të iki, thjesht për të jetuar, sepse në Shqipëri jeta vlen shumë pak.

Disa javë më parë, përcolla në parajsë një njeri shumë të dashur për mua.

E dini pse? Sepse në orët e vona, një natë të mërkure ai pësoi infarkt të miokardit...Dhe fati nuk ishte me të. Sepse tashmë jemi nuk e di sa milionë shqiptarë që jetën tone ja kemi lënë në dorë fatit, edhe pse paguajmë sigurime, edhe pse na zhasin nga taksat, edhe pse na fitet për shëndetësi falas e nuk kemi ku të shkojmë. Dyert na përplasen në fytyrë nëse nuk kemi miq apo lekë të zgjidhim një hall. Por edhe kur paguajmë, edhe kur gjejmë miq, përsëri na bie në kokë. Shteti tek ne ka vdekur, ndaj fati është e vetmja derë ku mund të trokasim. Por atë natë, fati nuk qe me ne. E dini pse? Sepse në reanimacionin e kardiologjisë, dikush kishte lënë roje një praktikant, për më tepër të paafte. Një praktikanti i kardiologjisë, që për më shumë se tetë orë nuk arriti të diagnostikojë një pacient me infarkt, pavarësisht këmbënguljes së familjarëve për anamnezën. Nën "kujdesin" e këtij praktikanti, (që me siguri tani po i shkurton orët ndonjë pacient tjetër) ky njeri pësoi edhe dy infarkte të tjera. Kur mëngjesi zbardhi, ishte vonë për të ndërhyrë... Ishte vonë për të jetuar. Ky ishte mësimi më i hidhur që Shqipëria më dha mua dhe gjithë të afërmit të mi. Ky ishte mësimi më i kushtueshëm, që qëndrimi në Shqipëri na dha si kosto për besnikërinë, dashurinë apo parimet tona për vendin dhe jetën. Në një vend ku është vonë për të jetuar, por ka kohë për import mbetjesh, për shitje konçensionesh, për abuzime tenderash dhe për gjithë të tjerat unë nuk gjej dot më motivin, nuk gjej dot busullën, nuk gjej dot jetën. Të tjerat janë thjesht shtojca. Por nëse më jepni një motiv, unë do vazhdoj të rri në Shqipëri. Kur flas për motiv, nuk e kam fjalën për ujë, punësime apo për rrugë të pastra. Kur them motiv e kam fjalën për vetë jetën, me ose pa të tjerat, u mësuam tashmë. Për fat të keq, vazhdoj të besoj që në Shqipëri jeta vlen shumë pak, ndërsa për mua është më e çmuara.

Gazeta "Rrënjët", një vatër e zbulimit të historisë sonë

Të nderuar miq të redaksisë "Rrënjët"

Ndjenja e shqiptarizmit, atdhetarizmit, më ka obliguar për t'ju përsëritur dhe për t'ju falënderuar, ju o miq të nderuar të gazetës "Rrënjët". Në të njëjtën kohë e ndiej veten krenar, për bashkëpunimin që kam me ju. Puna juaj sa fisnike po edhe aq atdhetare është kuptimplotë, sepse ndonëse në dhe të huaj ju morët me vete ndjenjën e shqiptarizmit, atdhetarizmit, mençurinë kombëtare, idealin kombëtar dhe mbi të gjitha gjuhën e ëmbël e të bukur shqipe të Naimit. Nuk haruat porosinë e martirit të parë të gjuhës shqipe Petro Nini Luarasi: "Edhe 99 herë të rrezohemi përsëri do të ngrihemi". Por jo vetëm nuk u rëzuat, por triumfuat, sepse zoti ju kishte bekuar. Ju patët parasysh ideologun e Rilindjes sonë Kombëtare dhe udhëheqësin e Lidhjes së Prizrenit, që ndonëse i burgosur nga turqit në një letër drejtuar Mehmetit citonte: "Unë e mbolla këtë farë / Ka të tjerë shqiptarë / Që kërkojnë këtë farë / Ata kurrë se harrojnë / Abecenë do ta këndojnë.

Dhe ju e mbollët këtë farë atje në dhe të huaj dhe e kthyet në një fidanishtë. Njëpërmjet gazetës "Rrënjët" e keni kthyer në një vatër për zbulimin e rrënjëve të historisë sonë. Kjo për faktin se nëpër numrat e gazetës keni zbuluar madhështinë e heroit tonë kombëtar Skënderbeut, duke e renditur ndër pesë gjeneralët më të mëdhenj të kohës dhe duke e vërtetuar me fakte, të cilat për popullin tonë kanë qenë të panjohura. Dhe brenda kësaj vatre keni zbuluar dokumente të ndryshme si "harta" që pasqyrojnë trojet e të parëve tanë, duke na kujtuar atë plejadë trimash luftetarë me në krye plakun e mençur Ismail Qemalin, që shpalli pavarësinë.

Keni zbuluar hartën me kufinj të cinguar së Shqipërisë, atëherë kur shtetet e Evropës



vendosën për ta copëtuar, duke i hequr herë një jakë e herë një mëngë, për të plotësuar synimet shoviniste të shteteve fqinjë. Ja vlen të përmendim veprimtarinë e perandorit të parë të shtetit gjerman Otto Bismark. Ky burrë i shquar shteti dhe politikan i zoti, me këshillat që ju dha tre delegatëve të Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878 ka lojtur një rol të rëndësishëm për orientimin e lëvizjes kombëtare shqiptare. Nga biseda ndërmjet Bismarkut me Avdyl Frashërin, Ymer Prizrenin dhe Mehmet Vrionin ka mbetur në kujtesën tone fakti: Në kohën kur Avdyl Frashëri ju lut Bismarkut që t'a ndihmonte për njohjen e kombit shqiptar Bismarku i tha: -Më jepni një libër të shkruar në gjuhën shqipe. Avdyli nuk u kujtua, apo nuk dinte se në gjuhën shqipe ishte përkthyer "Dhiata e Re" prej Vangjel Meksit dhe qe botuar prej misionit evangjelist anglez më 1827 dhe prej

Kostandin Kristoforidhit më 1868, ju përgjigj: "Nuk kemi ndonjë libër të botuar në gjuhën shqipe në këto vite. Kemi vetëm disa libra shqip të shkruar dy-tre shekuj më parë prej priftërinjve katolikë". Atëherë Bismarku dha këtë sqarim: "Në Evropë, as ka, as do të ketë komb pa gjuhën e shkruar. Shqipëria do të jetë vetëm një shprehje gjeografike, po të mos shkruhet gjuha shqipe".

Këtë porosi të Bismarkut po përmbush gazeta "Rrënjët", e cila nëpërmjet shkrimeve të saj ka mundur të pasqyrojë me lagrampësi, mençuri, urtësi dhe me vizion të qartë çështjen kombëtare shqiptare, duke përdorur fakte domethënëse për lashtësinë dhe origjinën e popullit tonë, siç është shkrimi "10 mijë vjet nga zanafilla e shqiptarëve". Nuk mund të lë pa përmendur kontributin tuaj për të pasqyruar aftësitë drejtuese të shqiptarëve, siç është rasti i kryeministrit me origjinë shqiptare, që kanë drejtuar Greqinë. Po ashtu nëpërmjet artikujve për shpalljen e pavarësisë së Kosovës keni pasqyruar realitetin. Pra ju të nderuar miq të gazetës "Rrënjët" me shpirt atdhetar dhe human, me mençuri, me dashamirësi keni përcjellë të çdo lexues fakte historike. E vecanta është se ju per keto botime me pune të palodhur s'kini kerkuar asnjë gjë të huaj, apo jini perpjekur per lavdi, por vetem e vetem, qe çdo shqiptar te njohe trashegimime e vlerave historike dhe kulturore te trasmetuara brez pas brez se sic ka thene Ciceroni "Te mos njohesh ato, qe kane ndodhur para se te lindje, eshte te mbetesh kalama".

-Le tu shkojë puna mirë, sepse jemi të bindur se gjithë shqiptarët kudo që ndodhen do të na mbështesin me shumë kënaqësi.

Përzemërsisht, miku juaj
MIRGJIN FRASHËRI

KUJTOJMË DIPLOMATIN VANGJEL VLLAHO

Nga GENC LLUKANI, Tiranë

U bënë disa vjet që nuk e kemi në mes tonë diplomatit Vangjel Vllaho. Miqtë, të afërmit, bashkëshortja nuk e kanë më Vangjelin fjalëpaktë, por të zgjuar dhe miqësor. Ai gëzonte respekt në qarqet e intelektualëve, të diplomatëve të karrierës, por edhe tek njerëzit e thjeshtë, të cilët i donte dhe i respektonte. Peshtanakët kanë ditur të kultivojnë në çdo kohë hamoninë ndërfetare. Ata kanë gjetur gjuhën e mirëkuptimit dhe të tolerancës ndërmjet tyre. Peshtanakët janë shquar për krijimtari artistike. Bukuritë natyrore të fshatit kanë qenë burim i pashtershëm për të krijuar këngë, të cilat këndoheshin nëpër dasma e gosti familjare.

*O shokë ç'na mori malli
Për një degë dunice mali
Atje ku prehet sorkadhi,
Ku këndojnë ata bilbila
Në Peshtan, tutje nga Vilat.*

Këtë këngë e këndonte aq bukur Vangjel Vllaho. Z. Vllaho ka qënë diplomat karriere në disa Ambasada Diplomatike si në Romë, Sofje, Pragë,



si edhe në Misionin tonë pranë O.K.B-së. Nga viti 1993, deri sa doli në pension në vitin 1989 ka punuar në Degën e Kuadrit pranë Universitetit Bujqësor në Kamëz. Vangjel Vllaho ka shkruar shumë artikuj për probleme të ndryshme në shtypin e kohës. Në vitin 2006 botoi librin modest

"Përmes Shkrimeve", i cili nga mënyra e thjeshtë e trajtimit të ngjarjeve, pati ndikim të madh tek bashkëfshatarët. Kështu në fillim të vitit 2006 Vangjeli, ndërmori botimin e dytë të këtij libri. Në vitin 2009 ka botuar librat "Kujtime nga Goliku", dhe "90-vjetori i çeljes së shkollës së parë shqipe në Peshtan". Më 2010 ka botuar librin "Këngë në vite", në të cilin me fjalë zemre i këndon bukurisë natyrore të vendlindjes. Krijimtaria letrare e Vangjel Vllahos u mbyll më 2012 me librin "Te shkëmbi i Peshtanit", ku përshkruan me pasion dhe ndjenjë ngjarjet historike të Peshtanit.

Me anë të këtij shkrimi modest desha të kujtoj njeriun e mirë Vangjel Vllaho, i cili gjithë jetën është përpjekur për të forcuar unitetin dhe miqësinë ndërmjet bashkëfshatarëve. Kontributi i tij është vlerësuar duke u shpallur "Qytetar Nderi" i Tepelenës. Ky ishte vlerësimi më i madh për njeriun e mirë Vangjel Vllaho, i cili në moshë të njomë rroku pushkën dhe doli malit për të marrë pjesë në lëvizjen antifashiste nacional-çlirimtare. Pas çlirimit të vendit punoi pa u lodhur nëpër përfaqësitë diplomatike dhe në vitet e fundit të jetës nuk rreshti së shkruari për vendlindjen dhe bashkëfshatarët. I përjetshën qoftë kujtimi i tij.

(Continua da pagina 21)

in contatto con gli ambienti liberali di orientamento monarchico che facevano capo al primo ministro.

Il soggiorno torinese mise a dura prova il suo repubblicanesimo, e fini per convincersi che solo uno stato monarchico unitario, sotto l'egida sabauda avrebbe potuto dare la libertà al Sud, che era il suo pensiero fisso. Con gli altri emigrati preparava continuamente piani per promuovere il sollevamento del Sud, e per questo ebbero anche degli abboccamenti con lo stesso Cavour. I suoi sentimenti repubblicani che aveva espresso con molto vigore sui giornali torinesi portarono a un decreto di espulsione, che non venne eseguito poiché nel frattempo egli si unì al gruppo di fuoriusciti che a Genova preparavano la spedizione garibaldina. Il 5 maggio del 1860 si imbarca con Garibaldi alla volta di Marsala, partecipando alla marcia trionfale verso Napoli. E' presente nelle battaglie di Calatafimi e Milazzo e il generale lo premia nominandolo prima capitano e successivamente Giudice del Consiglio Permanente di Guerra dell'Esercito Garibaldino. Al passaggio in Calabria, prima favorisce la capitolazione delle truppe borboniche a Soveria Mannelli e poi con il carisma di cui gode presso gli arbëresh, e ne provoca un rilevante afflusso nell'esercito garibaldino: centinaia di loro ripongono sul generale la loro ansia di libertà ed equità sociale.

La sua missione sembra compiuta con l'arrivo di Vittorio Emanuele e la formazione dello Stato unitario costituzionale. Ma le delusioni sono molte tante ed amare. Fin dallo scioglimento dell'esercito borbonico si intravedono le prime difficoltà per le palese

Un patriota albanese

discriminazioni ai danni dei meridionali. I garibaldini vengono rispediti a casa senza alcun benservito e si assiste a una restaurazione delle vecchie gerarchie sociali. Domenico Mauro si dedica appassionatamente all'attività politica schierandosi nell'ala sinistra contro governo liberale che si schiera apertamente a difesa delle classi privilegiate con provvedimenti fiscali punitivi nei confronti dei più deboli. Egli denuncia i soprusi e gli errori della unificazione che assomiglia più a una conquista coloniale che alla formazione di un moderno stato democratico. "Le controversie per l'inserimento dell'esercito meridionale con l'assorbimento dei garibaldini nell'esercito nazionale e l'amarezza del Mauro e di tanti altri suoi simili nel constatare che le carezze speranze nel futuro Stato italiano erano state mal riposte e la considerazione che lo scetticismo degli anni passati, trovava nel presente la sua più valida giustificazione", scrive Mario Borretti." Si presenta e viene eletto per due legislature a Lucera e stabilisce la sua abitazione a Firenze, diventata la capitale del Regno, e vi risiede anche quando non è più membro del Parlamento, e viene nominato Prefetto del Regno.

Muore per un carcinoma alla mascella destra il 17 gennaio 1873, all'età di 61 anni.

Il suo pensiero politico non ha mai avuto la forza di un progetto programmatico, e spesso cambia opinione cercando di adattare le sue idee alle

circostanze, ma gli viene riconosciuta una grande onestà intellettuale. Le sue prese di posizione possono ritenersi poco convincenti ma non sono mai dettate da interessi personali. E' uno dei pochi membri del parlamento a rendersi conto del grave stato di disagio del sud che subisce l'unificazione e viene mortificato per le decisioni che si rivelano sempre contrarie ai propri interessi. Il suo rifiuto di lasciarsi corrompere dalla sirene del potere gli consente di guadagnare una larga popolarità, ma il dorato esilio fiorentino gli impedisce di dare un contributo significativo al miglioramento delle condizioni della sua terra che era stata una costante della sua attività politica e letteraria. Domenico Mauro è uno scrittore molto prolifico, ma la maggior parte dei suoi manoscritti non sono mai stati pubblicati. Tra le principali opere pubblicate si annoverano il poema Errico del 1843, il saggio Vittorio Emanuele e Mazzini, Genova, Ponthenier, 1851 e Concetto e forma della Divina Commedia, Napoli, Stabilimento tipografico degli scienziati, letterati ed artisti, 1862, che ebbe una grande fortuna in particolare all'estero. Francesco De Sanctis ne traccia un ritratto molto lusinghiero. «Era un uomo semplice, che non parlava mai di sé; stimava naturali tutte le azioni che il mondo chiama eroiche, quasi egli non sapesse o non potesse fare altrimenti. Non aveva mai creduto che compiere il proprio dovere fosse scala a ricompense».

Prezantohet në Parlamentin Evropian projekti i autostradës Durrës-Prishtinë-Medvegjë-Nish drejt Evropës

Shkruan ASLLAN DIBRANI

Në parlamentin evropian në Bruksel u prezantua projekti i autostradës Durrës - Prishtinë - Medvegjë - Nish. AFEDS (Forum Shqiptar për zhvillimin ekonomik në Serbi) Forumin për bashkëpunim ndërkuftar (FBN) me përkrahjen e shumë institucioneve tash e disa muaj janë duke lobuar në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare që ky projekt të kalojë nëpër Medvegjë. Rëndësia e këtij projekti është shumë e madhe për Luginën e Preshevës.

Ka kohë në të gjitha instancat politike, shoqërore, organizata qeveritare dhe jo qeveritare po diskutohet për ndërtimin e autostradës Durrës - Prishtinë - Nish, që do të lidhë tri shtetet dhe do të ndikojë në nxitjen e zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik mes tyre. Në projektin fillestar, parashikohet që autostrada të kalojë nëpër Merdarë nga e cila është një gabim strategjik në sferën politike dhe ekonomike. Ndërkohë, "Forum Shqiptar për Zhvillim Ekonomik në Serbi (AFEDS) i themeluar nga kompania "MedVita Development", me seli në "Banjen e Sjarinës", KK Medvegjë ka prezantuar një draft projekt të ri, ku kërkohet që autostrada të kalojë nga Medvegja dhe jo nga Merdara e cila nuk ka interes as Kosova as Serbia, por edhe kostoja është më e vogël dhe është fitimprurëse për rajonin e tri komunave të atjeshme dhe etimeteve që jetojnë shqiptarë dhe serb, por edhe për Gollakun si rajon me i pa zhvilluar. Ky draft para disa ditësh fitoj përkrahjen e eurodeputetit dhe koordinatori për politikë të jashtme, Z. Knut W. Fleckenstein, si dhe kryetar i komitetit për bashkëpunim mes Kosovës, Serbisë, Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës dhe Mali i Zi.

Kësaj i parapriu edhe takimi me kryetarin e Aleancës Kosovare të Bizneseve z Agim Shahini në kabinetin e tij me bashkëpunëtorët e Forumit Shqiptar për zhvillim ekonomik në Serbi (AFEDS) ku fokus kryesorë kishim projektin e autostradës Nish - Prishtinë i cili do të mundë të sjellë shumë përfitime ekonomike si për Kosovën, por edhe për Shqipërinë dhe Serbinë. U trokit edhe neper disa dyer ndërkombëtare dhe evropiane, që ky projekti nga Leskoc për në Medvegjë dhe drejt Prishtinës. Për këtë projekt edhe qeveria e Serbisë ka dhënë sinjal pozitiv ne vitin e kaluar në instancat ndërkombëtare për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni e pikërisht edhe për Autostradën ne këtë relacion. Për këtë projekt është prononcuar edhe kryeministri Isa Mustafa, nga e cila e priti delegacionin e këtij forumi të biznesmenëve nga komunat Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc i udhëhequr nga z.Muharrem Salih një biznesmen i dëshmuar ne Itali... Lobimi dhe takime të tilla, patën edhe me organizmat e menaxhmentit politik me Shaip Kamberi, nënkryetari i Preshevës, Xhelal Memeti, kryetari i Forumit për Zhvillim Ekonomik, Muharrem Salihu, koordinatori për Politikë të Jashtme, Aziz Aziri, si dhe Muharrem Zejnullahu, është biseduar për fuqizimin e koordinimit në funksion të zhvillimit



Pamje e delegacionit të Forumi Shqiptar për zhvillimin ekonomik në Serbi i udhëhequr nga Muharrem Salihu, të pritur në Parlamentin e Evropës nga z.Knut W. Fleckenstein kryetar i komitetit për bashkëpunim mes Kosovës, Serbisë, Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës dhe Mali i Zi.

ekonomik, infrastrukturor, social dhe kulturor të tri komunave. Përkrahje të tilla kanë arritur edhe nga partitë politike ne Shqipëri, Kosve dhe Serbi por edhe nga Lobi Euro - Atlantik Shqiptar në Evrope e udhëhequr nga Skënderbeg Klaiqi po edhe Asllan Dibrani përfaqësues i mediave të këtij Lobi.

Ne duhet ti përshëndesim aktivitetet e tilla që përkojnë fillimisht me interesin politik dhe kombëtar me pretekst te veçanët zhvillimit ekonomik dhe avancimin e proceseve dhe zhvillimin te kësaj treve te pa zhvilluar si ne Serbi po ashtu edhe në Kosovë, rezulton se primarja ishte Autostrada Durrës - Prishtinë - Medvegjë - Nish, drejt Evropës. "Forumit Shqiptar për Zhvillim Ekonomik në Serbi në nismën e ndërmarrë, për realizimin e autostradës Durrës - Prishtinë - Medvegjë - Leskoc - Nish po i bashkohen njëzëri edhe organizata të ndryshme shqiptare kudo në botë, personalitete nga fusha të ndryshme, individë

dhe qytetarë nga trojet shqiptare dhe diaspora. Mendime të tilla dhe aktivitete janë duke u bërë edhe nga qytetin e Leskocit dhe qeveritë lokale të kësaj treve për këtë Autostradë për ta ruajtur dhe bilancin e popullatës për mos shpërngulje nga këto zona qofte shqiptar apo serb.

Ne saje te këtyre aktiviteteve të njëpasnjëshme u arrit qe ky projekt të shtrohet edhe në Parlamentin e Evropës, nga e cila ky projekt, po e përmirëson gabimin e Leadershipit kosovar qe e kishin fut gabimisht këtë Projekt te në drejtim te Merdara, duke i lënë vëllezërit tanë në këto tri komuna pa rrugë. Ky shkrim le të mbetet si mesazh dhe thirrje individëve, organizatave, qeverive, organizatave qeveritare dhe jo qeveritare dhe institucioneve të ndryshme në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi që veprojnë në vende të ndryshme të botës, për shumë mbështetje, inkurajim, ndihmë dhe bashkërendim të aksioneve tona, për realizimin e projektit të autostradës Durrës - Prishtinë - Medvegjë - Leskoc - Nish. Ky mesazh le te jete po ashtu si thirrje edhe Parlamentit të tri shteteve Shqipërisë, Serbisë dhe te Kosovës, qe sa me pare ta aprovojne këtë projekt në interesin e tri shteteve dhe te rajonit ballkanik. Thirje e vecant i bejme edhe Parlamentit Evropian qe ky kërkesë të aprovohet sa më parë, që po ashtu do të jetë edhe një nder pikat me strategjike, për ta stabilizuar edhe gjendjen politike në rajon. Për në fund ta ndihmojmë AEFDS, që po organizon edhe një peticion Online për përkrahjen e projektit të autostradës Durrës - Prishtinë - Medvegjë - Leskoc - Nish. Delegacioni i ynë i kryesuar nga zoti Muharrem Salihu, edhe sot po zhvillon takime te ngjeshura ne Parlamentin Evropian nga e cil ane ditet ne vijim do tu njoftojmë për këtë projekt. Projekti është në harmoni edhe me planet e Bashkimit Evropian për zhvillimin e Ballkanit perëndimor...



Projekt i dorëzuar dje ne Parlamentin e Evropës nga këshilli i Forumit Shqiptar i udhëhequr me zotin Muharrem Salihun

Toka e Kosovës, peshqesh vizash!

nga Mehmet BİSLIMI, Wiesendangen

... "Raporti i Komisionit për matjen e territorit të Kosovës ka konstatuar se Kosova nuk humb territor me marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi!"... Caktimi i saktë i pikave kufitare të Republikën së Kosovës me fqinjët, para së gjithash, është obligim i një shteti që mëton integritet Evropiane dhe më tej drejt NATO-së dhe OKB-së e kështu me radhë. Është obligim i institucioneve tona për të shënuar saktë pikat kufitare me fqinjët tanë, pa i dëmtuar as tokat e tyre dhe as tokat tona. Kjo dhe vetëm kjo pastaj është fqinjësi e qëndrueshme dhe pa pretendime territoriale ndaj njëri-tjetrit.

Gëzon fakti që Republika e Malit të Zi dhe Republika e Kosova nuk kanë pretendime të tilla ndaj njëra tjetrës, andaj shtrohet pyetja: pse kërkohet me kaq ngulm të falën tokat tona?, Është shumë i qëndrueshëm fakti se Kosova ka nevojë për mbështetje nga fqinjët tanë, por jo edhe me kushtëzimin e faljes se tokave tona, gjoja në emër të lëvizjes së lirë të qytetarëve tanë, pra përfitim vizash, apo më mirë të themi përfitim të shëtitjeve të qytetarëve tanë nëpër Evropë e gjetiu pa pasur të drejt pune dhe qëndrimi e rregullimi letrash e qëndrimi atje. Ky do të ishte edhe obligim legjitim i Qeverisë dhe i institucioneve tona: qytetarët tanë t'i punësojë, të ju sigurojë një jetë më të mirë, t'i mbroj me ligj para diskriminimit, nepotizmit dhe korrupsionit të paparë dhe dëgjuar ndonjë herë.

Në asnjë rrethanë nuk qëndron fakti, edhe njëherë në asnjë rrethanë se Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi është kusht për liberalizimin e vizave. Jo, ky është vetëm një mashtrim i radhës, është një rutinë e ripërsëritur që sa herë, nga kori i kukuvajkave që bëjnë vezë në strofulllë e Qeverisë sonë, natyrisht pa fajin e tyre, përdërisa sovranin i ka legalizuar veprimet e tyre me votën e vet! Madje edhe për të falur tokat tona gjithandej nga Mali i Zi, Maqedonia e Serbia dhe krejt në fund sipërfaqja e Kosovës do të mbetet me 7 mijë kilometra katrorë! Pastaj këta prapë, për mes një komisioni tjetër, do të thonë se: Kosova nuk ka humbur asgjë, ngase, sipas matjeve të fundit, Kosova kishte kaq kilometra katrorë. Njëjtë, sikur thoshin dikur, kur u suprimuma me dhunë Kushtetuta e Kosovës nga pushtuesi serb, dhe paria vasale e atëhershme thoshin se Kosova nuk po humb asgjë!

Kosova ka interes parësor në forcimin e sovranitetit dhe integritetit të shtetit tonë, në rrugëtimin e saj drejt integriteteve euroatlantike. Ne duhet të ecim përpara në këtë forcim të sovranitetit tonë dhe shënimit të kufirit, por gjithnjë duke qenë vigjilent që tokat tona të mos çënohen dhe të mos jepen peshqesh e përlesh-pa pardon! Kosovën dhe popullin shqiptar në përgjithësi, nuk e nderon falja dhe copëtimi i tokave tona, por mbrojtja dhe ruajtja e tyre, po aq sa kemi edhe obligim të ruajmë fqinjësinë e mirë me të gjithë ata që na respektojnë e na ruajnë edhe ne si shtet fqinjë. Kosova nuk ka pretendime territoriale ndaj askujt dhe nuk duhet të lejojë një gjë të tillë as ndaj territorit të vet. Komisioni i lartpërmendur nuk ka bërë ma shumë se atë që i ka rekomanduar Qeveria e Kosovës, pra që të deklarohet se Kosova nuk po humb territor, jo, në fakt Kosova po falë territor nga se ka më bollëk (Posi!).

Shekspiri, njohës i mirë i historisë shqiptare

(Vijon nga faqja 21)

Despotati fqinjë, ai i Artës (Epirit), vazhdonte të ishte që nga viti 1204 një formacion i pavarur. Despotët e tij bizantino-italianë nga familjet Engjëlli e Orsini, gjatë viteve 1270-1330, u përpoqën të ruanin pushtetin e tyre kundrejt perandorëve të Bizantit, të cilët këmbëngulnin të quanin despotatin si "tokë të tyre", ndërsa despotët e tij si "vasalë" të perandorëve bizantine. Për të siguruar mbështetje ndaj presionit bizantin, despoti Niqifori I Engjëlli pranoi, më 1294, të bëhej vasal i anzhuinëve të Napolit. Më 1320, despoti tjetër, Nikolla Orsini, kërkoi t'i vinte tokat e tij nën mbrojtjen e Venedikut, duke njohur këtë për kryezot. Pothuaj të gjithë këta, pas Mihal II Engjëlli (1230-1268), ishin martuar me princesha nga oborri bizantin. Më 4 tetor 1416 Karl Toko (vasal i mbretërisë së Napolit, sundimtar i ishullit të Qefalonisë dhe pasardhës i kontëve nga familja Orsini të Qefalonisë) hyri në Artë duke i rrëmbyer zotërimet Muriq Shtatës, me pretendimin për tu bërë siç kanë qenë një shekull më parë, familja Orsini.

ORSINI, KONT DHE DUKË.

Siç kuptohet, gjatë shek. XIV, gjatë Perandorisë Bizantine, në Shqipëri kanë ekzistuar disa sundimtarë feudale me pushtet të pakufizuar për krahina të caktuara. Njëri nga të shumtët ka qenë edhe emri Orsini, e përmendur në komedinë e Shekspirit. Nikolla Orsini sundoi si despot, ai ishte Duka i Epirit (Iliria e lashtë). Në fillim të shek. XV, Desapotati i Artës u qeveris nga pasardhësit e Orsini, Toko-Orsini.

Në vendosjen e "Natës së Dymbëdhjetë" në Iliri, Shekspiri nuk kishte ndër mend të krijonte një botë fantazie. Zgjedhja nga Shekspiri e emrit "Orsino" si sundimtar i një shteti që në kohën e tij ishte i njohur si Iliria (ose Epiri), është rrënjësor thellë në histori, ajo është një referencë e saktë e ngjarjeve historike. Emri Orsino ka një origjinë historike, krerët e këtij emri kanë ekzistuar në histori dhe Shekspiri kishte njohuri të sakta e të pamohueshme nga Iliria, tashmë pjesë e Perandorisë Bizantine.

Kush ishin Orsinët e Epirit? Ata ishin anëtarë të një dege të Italisë Jugore, familje dominuese Orsini

që, me linjat e saj të shumta, për shekuj me radhë ndikoi në historinë e Italisë, duke përfshirë ato në gadishullin e Ballkanit, që nga kohët bizantine. Emri Orsino i takon historisë së Epirit, pjesë së Ilirisë në Perandorinë Bizantine. Përmendja e emrit Orsini në "Natën e Dymbëdhjetë" është dëshmi jo vetëm për njohuritë e Shekspirit për ekzistencën e Orsinëve të Epirit por edhe për titujt e tij. Në Aktin I, Orsino quhet "Dukë". Princat vasalë me këtë emër kanë ekzistuar në histori dhe Shekspiri kishte njohuri të mira nga Iliria Bizantine e kohës.

NË VEND TË MBYLLJES: SUBJEKTI "NATA E DYMBËDHJETË"

Komedia përmban dy plane: një mbyetje anijeje dhe dy binjakët me satirat e tyre dhe personazhet e tjera të lidhura midis tyre.

Në brigjet e Ilirisë pas një shtrëngate mbytet një anije në të cilën udhëtonte Viola dhe vëllai i saj binjak, Sebastiani. Pas daljes në breg, ajo mendon se vëllai i saj ishte mbytur dhe vendos të shkojë

për të punuar në shtëpinë e Orsinos e maskuar si burrë me emrin e saj të ri Cesario. Orsino e dërgon Violën/Cesarion për t'i shprehur Olivias dashurinë e tij. Mirëpo Olivia që mendon se Viola është mashkull bie në dashuri me të.

Ndërkohë Sebastiani është gjallë pasi ka shpëtuar nga mbytja e anijes, por mendon se motra e tij Viola ka vdekur. Ai arrin në brigjet e Ilirisë i shoqëruar me Antonion. Sër Andriu, duke parë afekcionin e Olivias ndaj Cesarit e fton këtë të fundit në duel. Ndërkohë në duel shfaqet Sebastiani dhe jo Cesari. Olivia i kërkon atij të martohen bashkë, ndërkohë që Sebastiani as nuk e njeh atë. Ndërkohë Antonio është arrestuar nga rojet e Orsinos dhe i kërkon Violës ndihmë duke kujtuar se është Sebastiani. Ai mendon se Sebastiani e tradhëtoi sepse Viola thoshte se nuk e njhte fare këtë njeri. Aty ajo u përmend se vëllai i saj mund të ishte gjallë.

Sekreti zbulohet kur dy binjakët dalin para Orsinos dhe Olivias. Orsino lidhet me Violën ndërsa Olivia me Sebastianin.

Antishqiptarizmi si profesion fitimprurës

Nga ISMAIL KADARE

(Vijon nga faqja 16)

një mënyrë ose një tjetër do të rrezatojë e do të kthehet në një realitet. Imazhin e mirë ose të keq për një popull nuk mund ta krijojnë për një kohë të gjatë as zyrtarët e tij, por as renegatët e tij; atë s'mund ta krijojnë as nacionalistët e ekzaltuar, por as vulgu i egër e i verbër. Aq më pak mund ta krijojnë atë diplomatët mëndjelehtë, gazetarët e pabësë, dënuncuesit, psikopatët dhe paranojakët e dëhur për lavdi.

Njeriu shqiptar, i lodhur nga kalimet e bëfta prej vetmbrojtjes drejt vetëpërbaltjes, dhe e kundërta, ka nevojë më tepër se kurrë për rifitim e drejtpeshimit shpirtëror. Drejtpeshimi nuk rigjendet duke përdorur përndezjen nacionaliste si kundërhelm ndaj vetpërcimit, e aq më pak duke e përdorur këtë të fundit si balsam kundër kapardisjes. Për të shmangur kalimin nga një dush i nxehtë në një dush të ftohtë, njeriu shqiptar ka nevojë sot për orjentim të saktë. Disa pyetje të thjeshta, por themelore e bazë, çohen sot përpara tij: ç'popull jemi? Domethënë, a jemi si të tjerët?

A kemi mëkatë për të larë, a kemi borxhe për të paguar? A jemi vërtetë fatkeqë apo ashtu na duket, apo ashtu na pëlqen të shfaqemi përpara vetes dhe botës? Të gjitha këto pyetje mund të formulohen në një motëzim edhe më të thjeshtë: ne shqiptarët, pas dymijë vjetësh ekzistencë, tani në prag të mijëvjeçarit të tretë a i kemi ende aftësitë trupore e shpirtërore për të vazhduar të jetojmë si komb, apo koha jonë ka kaluar?

Pa rënë në kurrfarë optimizmi të kotë, mund të thuhet pa droje se, pikërisht sot, shqiptarët, pavarësisht nga lëngata që u ka rënë e përpigjet t'i vërë poshtë, kanë shanset më të mëdha për të zënë përfundimisht vendin që prej kohësh e kanë merituar në familjen e popujve. Madje, kjo lëngatë e kjo krusmë e tmerrshme është ndoshta shënja me e sigurtë për një të ardhme plot shpresë. Në jetën e shumë popujve janë të njohura këto gremina, pas të cilave kanë ardhur ngritjet, disa herë marramëndëse.

Le të kthehemi te pyetjet e thjeshta themelore. Fat i ndonësë në është bërë zakon ta mallkojmë, na ka caktuar ne shqiptarëve të jetojmë në një nga zonat më të bukura të Europës. Europa vetë, ndërkaq së bashku me ShBA-në, është tani për tani lagjia më luksoze e botës. Ne harrojmë shpesh këtë, harrojmë që ky vend, sharjet ndaj të cilit i kemi në maj të gjuhës, ky vend pra, i vendosur midis Venetikut, Romës e Athinës ka një përbërje gjeografike të mrekullueshme, se ai ka një klimë të admirueshme, se ka pasuri natyrore të shumta, se ka ndoshta plazhet më të bukura të kontinentit. Ne harrojmë ç'do të thotë ankthi shekullor i vëndeve që nuk kanë dalje në det, pa përmendur vëndet e izoluara në thellësi të kontinenteve, pa përmendur trojet e gjëra të kësaj bote të mbushura me shkure, shkretëtirat e trishtim, e që mbulojnë tri të katërtat e rruzullit tokësor. Në i harrojmë këto dhe, meqënëse jemi midis një kopshti plot me shtete pasanike, na pëlqen të qahemi që nuk jemi si ata.

Ne vuajmë nga kompleksi i vogëlsisë dhe harrojmë se shtati i popullit shqiptar, pavarësisht nga prerja e trojeve të tij, nuk është aspak i vogël në këtë gadishull, se ai është përafërsisht i barabartë me shtatin e grekëve, të sërbeve e të bullgarëve. Përsëritja gjer në lodhje e shprehjes « Shqipëri e vockël », « popull i vogël », s'është veçse shprehje e një dëshire për të fshehur përkurrjen e mëtejshme të këtij populli. Ndërkaq, porsa diku del në pah ndonjë mendim, ndonjë program ose ndonjë pyetje: përse shqiptarët, ndryshe nga popujt e tjerë, duhet të jetojnë në ndarë, aty për aty harrohet përcimi për vogëlsinë dhe kumbon shprehja « Shqipëria e madhe ». Kjo shprehje përsëritet më një farë tmerri, si diçka e rrezikshme, thua se në këtë botë vetëm 8 ose 9 milionë shqiptarët po të jetojnë bashkë bëhen të rrezikshëm për botën!

E ndërkaq, askush nuk thotë, sipas kësaj llogjike, se 90 million gjermanët e bashkuar janë të rrezikshëm, e aq më pak askush nuk thotë se 250 million rusët, bashkë me bombat e tyre bërthamore janë kërcënim për të tjerët. Në qoftëse s'duhet të vuajmë as nga kompleks i « vedit të mallkuar », as nga ai i vogëlsisë numerike, shqiptarët aq më pak kanë njohur kompleksin e racës. Jo vetëm që në botën e sotme të çliruar nga paragjykimet raciste ata paraqiten një popull i shëndetshëm, si gjithë të tjerët, por edhe në kushtet e dallimeve e doktrinave raciste, duke qënë ndër të rrallët popuj të Europës që nuk u prekën, përkundrazi u lajkatuan prej këtyre doktrinave, shqiptarët, vetvetiu mbetën jashtë këtij trazimi.

Merita e tyre është se ndërkaq ata nuk u dehen



nga lajkat raciste dhe përveç theksimit ndoshta të kapardisjes, teoria e racave s'pati pasoje në Shqipëri. Në sferën shpirtërore, në zotërimin apo krijimin e vlerave, shqiptarët s'kanë pasur kurrë arsye t'i kenë lakmi apo smirë të tjerët, aq më pak kanë arsye sot për një gjë të tillë. Shqiptarët janë krijuesit e bartësit e një prej gjuhëve themelore të njerëzimit, një gjuhë që ka vëndin e saj të paluajtshëm midis dhjetë-dymbëdhjetë gjuhëve kryesore të botës. Një nga vëndet e para të krishtera të Europës, Shqipëria ka qënë rrjedhimisht truall fillestar i qytetimit perëndimor evropian. Nga himni i madh i krishtërimit « Te Deum », i shkruar nga një peshkop shqiptar mbi një mijë e pesëqind vjet më parë, të mbrojesit te qytetimit perëndimor, Gjergj Kastrioti, personazhi më sublim e më i njohur në botë, jo vetëm i shqiptarëve, por i krejt popujve të Ballkanit, i cilësuar si « atlet i Krishtit », e gjer te murgesha shqiptare Nënë Tereza, gruaja shqiptare më e famshme e botës së sotme, kalon si një fill i ndritur dëshmia e këtij qytetimi, kaq shumë e kaq me këmbëngulje të mohuar nga dashakeqët e kombit shqiptar.

Dhe kjo është e kuptueshme: duhej fshirë kjo dëshmi për t'iu hapur rruga shpifjeve e shtrëmbërimeve të përbindëshme, për të ardhur gjer te teza e mbrapshtë se shqiptarët, jo vetëm s'kanë të bëjnë me qytetimin evropian, por janë varrmihës të tij. Gjithashtu në këtë llogjikë të mbrapshtë shpjegohen sulmet që iu bëhen vitet e fundit, prej vetë renegatëve shqiptarë tashmë, pikërisht gjuhës shqipe, figurës sublimë të Gjergj Kastriotit, i cili u quajt « hajdut kuajsh dhe agent i italianëve », si dhe krejt traditës kulturore shqiptare të djeshme e të sotme.

Paroksizmi i këtyre sulmeve ishte pranvera e vitit 1997, kur turmat e vulgut shqiptar, të nxitura, veç të tjerash edhe nga këta intelektualë renegatë, u vunë kazmën dëshmive të çmuara të qytetimit shqiptar, arkivave, teatrove antike, muzeut Gjergj Kastriotit!

Për të vazhduar me vlerat shpirtërore të krijuara nga ky popull, le të kujtojmë poezinë orale shumëshekullore, kodet zakonore, ritet antike, muzikën, koreografinë, kostumet e mahnitshme, për të ardhur gjer te letërsia shqipe. Kjo e fundit, duke u futur në klubin e zgjedhur të letrave të mëdha të botës, u bë veçanërisht e bezdishme për ithtarët e tezës së shqiptarët janë të paaftë për kulturë. Ndaj, ashtu si krejt qytetimi shqiptar, ajo do të pësonte sulmet e dëshpëruara e vulgare të antishqiptarizmit. Në këtë rast do të ndodhin veprime të turpshme, që asnjë vënd, sadopak dinjitoz, nuk do t'i lejonte kurrsësi. Endacakë të huaj, ata që s'i njeh kush e nuk i pyet kush në vënd të vet, mesuës fshati nga Kalabria apo nga Gjermania e jugut ftohen në Shqipëri për të hedhur baltë mbi letërsinë shqipe e kulturën shqiptare. Ky racizëm kulturor antishqiptar, i pashëmbull në botën e sotme, u bë i mundur për shkak të kundërpatriotizmit shqiptar. Të dy ishin ndër faktorët themelor që mundësuan rrënimin në mënyrë të turpshme të shtetit shqiptar, të ushtrisë, të policisë e të krejt ngrehinës shtetërore.

Racizmi kulturor antishqiptar merr pamje edhe më të shëmtuar e të papranueshme. Kur kujtojmë se vetë shqiptarët s'kanë kurrfarë përcimi ndaj kulturës së të tjerëve. Mungesa e racizmit dhe e shovinizmit të shqiptarët, pjellë e natyrshme e mëndësisë së tyre të hapur e miqësore ndaj të huajve, ndaj mikut, bashkë me tolerancën fetare,

tolerancë e thellë, e vërtetë, e papudrosur nga kurrfarë konformizmi, janë, ashtu siç u tha më lart, cilësi të tjera themelore, që dëshmojnë për një nivel qytetrimi të këtij populli kaq të sulmuar për të kundërtën.

Për fat të keq, ashtu si të gjithë popujt, shqiptarët kanë cenat dhe veset e tyre, po aq të forta, ndoshta sa virtutet, po ajmë, me spektakolare se ato. Ndryshe nga hebrejtë e disa popuj të tjerë, që janë sildarë e të lidhur me njeri-tjetrin, shqiptarët mezi ç'presin rastin për t'u përcarë. Natyra e tyre tejet individualiste është xehë e pafundme për të pjellë egoizmin, ambicijen, smirën dhe etjen për karrierë. Këndej rrjedh vaniteti, kapardisja e neveritshme e sedra e sëmurë. Këto cilësi të natyrës njerëzore që ndeshen kudo, bëhen veçanërisht të rrezikshme të shqiptarët, për shkak të traditës së shkurtër të jetës nën një shtet shqiptar. Prej tyre rrjedh një keqkuptim tragjik për lirinë dhe për shtetin. Pa u pajtuar dot me atë ligj themelor që lirinë e njeriut të veçuar e vë detyrimisht në raport me lirinë e të tjerëve, shqiptari shpesh e ka të vështirë të kuptojë se liria njerëzore, ndryshe nga liria absolute e kafshëve, është madhështore pikërisht ngaqë është e vështirë, domethënë e kufizuar nga ligji. Këtë vijmë keqkuptimë për demokracinë, për vetë shtetin dhe ngrehinat e tij.

Koncepti i gjymtë për shtetin, zbehja e tij përpara tërheqjes fisnore apo klanike çon disa herë në konceptin po aq të gjymtë për kombin, kur krahinorizmi kthehet në rival të kombit. Kjo është kushtëzuar, me sa duket, nga jetesa shumëshekullore nën Perandorinë Osmane, pra, nën një shtet që nuk ishte i tyre, rrjedhimisht ndaj të cilit s'mund të kishin as nderim e as dhëmbshuri, Periudha e Pavarsisë, ajo e Republikës në fillim e pastaj ajo e Mbretërisë, ishte relativisht e shkurtër, kurse gjatë sundimit të egër komunist, koncepti i shtetit u zbeh përsëri nën peshën e diçkaje të parokshme, të huaj e në fund të fundit, të shpëlarë prej çdo ngjyrimi kombëtar, që ishte Partia Komuniste. (f38)

SHQIPËRIA DREJT RINGRITJES

Poetika shqiptare, qoftë ajo e lashta, popullorja, qoftë ajo e poetëve të mëvonshëm, ka krijuar dy klishe bazë për cilësimin e Shqipërisë. Në poezinë gojore, Shqipëria quhet zakonisht « nuse ». Për poetët shqiptare ajo është më tepër « zonjë ». Është me interes të hetohet se ç'fshihet prapa këtij emërtimi të ndryshëm. Me sa duket, për këndvështrimin popullor Shqipëria është ende e re, pra « nuse » dhe si e tillë ajo e ka jetën kryesisht përpara. Për poetët, duke qënë « zonjë e rëndë », ajo e ka jetuar shkëlqimin e saj. Madje Fan Noli shkon edhe më larg kur e quan « veshjë », « e ve, e gjorë mbretëreshë pa kurorë ».

Kemi të bëjmë me dy trajtime, njeri drejt së ardhmes, tjetri drejt së shkuarës. Naimi në vjershën « Shpreh » u përpoq t'i bashkonte të dyja në vargjet:

« Lum kush të rrojë, ta shohë zonjë ».

Ndërkaq, duhet thënë se të gjithë poetët që e përfytyruan Shqipërinë si zonjë, e bënë këtë me qëllim fare të hapur: t'i nxisin shqiptarët t'i kthejnë dinjitetin e nderin e humbur, pra ta ribëjnë « zonjë », siç ka qënë dikur.

Po a ka qënë ndonjëherë Shqipëria «zonjë»? E bërë ndryshe, pyetja do të tingëllonte kështu: Kush ka të drejtë, populli apo poetët?

Me fjalë të tjera, ka qënë nuse apo zonjë Shqipëria? Apo, edhe nuse edhe zonjë? Me sa duket, është kjo e fundit që do të mbetet. Edhe nëse nuk ka qënë zonjë në realitet, ajo ka qënë e tillë në trurin e poetëve të saj. Pra, në një realitet po aq të fortë, sa edhe ai që shpalolet trupërisht përpara nesh. Poetët shqiptarë, në të vërtetë, duke e quajtur Shqipërinë zonje, u nisën nga një shestim, nga një projekt i së ardhmës. Ata krijuan imazhin e saj, atë që duhej të vinte dhe, për ta bërë sa më të besueshëm atë imazh, për t'u dhënë shpresë bashkëkombësve të vet, ngulnin këmbë që kjo nuk është një shajni, një fantazmë, por përsëritje e një të kaluarë. Me imazhin e «zonjës» ata luftuan një portretizim të tretë të Shqipërisë, një pamje të përbaltur, të pjellë nga vulgu shqiptar: atë të «Shqipërisë së mallkuar», të « Shqipërisë kuçkë », të Shqipërisë së sëmurë. Ishte ky imazh që u shfaq si një ethe e keqe vitet e fundit, sidomos në marsin e zi të vitit 1997. Poetët shqiptarë, sidomos rilindasit, e njihnin mirë këtë cen të njeriut shqiptar: kalimi nga përndezja e entuziazmi në ligështim shpirtëror. Ndaj ata, me të gjitha kabanat, donin të mbanin lart moralin shqiptar.

Thyerja e këtij morali në vitet 90, ishte këmbana e zezë që paralajmëroi rrezikun e thyerjes në mes të krejt kombit shqiptar. Ringritja e Shqipërisë nuk mund të fillojë veçse nga ngritja e moralit, pra nga shëndoshja shpirtërore e saj. Populli shqiptar duhet të bëjë që të heshtin qyqet, që tash ka kohë po i parandjellin veç fatkeqësi dhe vdekje. Ato qyqet duhet të heshtin, në radhë të parë, brënda tij e pastaj, natyrisht, rreth e rrotull. Shëndoshja shpirtërore do ta qetësojë nervozizmin e tij të skajshëm, që nuk është veçse një shënjë lodhjeje. Kjo do të bëjë që mëndësia e tij të kthellohet e të jetë e aftë të shestojë strategjinë e tij themelore: Jetën e përbashkët në atdhe. Ky qëllim madhor është aspirata më e ligjshme për një popull. Asnjë, asnjë manipulim apo tregëti politike, asnjë trysni shtetesh.lobesh, apo organizmash ndërkombëtarë nuk mund ta pengojë kombin shqiptar të kryejë atë që të gjitha kombet e tjera të Europës, plotësisht apo gati plotësisht, e kanë kryer: bashkimin e tyre.

Me këtë akt, populli shqiptar nuk synon asgjë të pazakontë e nuk kërkon asgjë të veçantë: ai kërkon veç normalitetin e vet. Ky normalitet është dhunuar pa mëshirë e ai duhet të qortohet. Në familjen e popujve evropian kombi shqiptar është i vetmi sot që është shenjuar për të keq. Ndërsa të gjithë ecin në një mënyrë normale, ai, i prerë mizorisht, është i detyruar të bëjë rrugën si një i gjymtuar. Një njeri i vetëm, që lëçitet (ndahet) kështu nga të tjerët, egërsohet, e jo, madje, një popull i tërë. Populli shqiptar as ka kryer krime e as ka fajë për të larë përpara botës. Ndonëse ka dymijë vjet që ekziston në këtë botë, ai as ka sulmuar kënd, as ka pjellë doktrina për zhdukjen e të tjerëve.

Shprehje të tilla si «Shqipëria e madhe» janë një tallje e një cinizëm i pashëmbull në botën e sotme. Shqipëria e tukur në 28000 kilometrat e saj, është e kërcënuar të fajësohet si « madhe », në qoftë se do të arrijë 45000 ose 50000 kilometra, e shteteve të tjera, me shtrirje të përbindshme prej miliona kilometrash katrorë, shtete që kanë bërë krime të frikshme ndaj botës, që kanë pjellë teori të zeza si murtajat, që kërcënojnë njerëzimin më armë bërthamore, nuk quhen «të mëdha». Si organizmi që kërkon jetën e vet natyrale, kombi shqiptar kërkon normalizimin e vet trupor e shpirtëror. Pengimi i tij është thjesht një krim. Ndiha që mund t'i jepet është detyrë humane dhe historike. Kombi shqiptar, pavarësisht nga imazhi i shfytëruar që jep, ka shumë rezerva dashurije e sinqeriteti në brëndësinë e vet. Europa e sotme, sado e kompletuar të duket, ka gjithëmonë nevojë për dashurinë e popujve të vegjël, shpesh të haruar.

Mijëvjeçari i dytë ka qënë për shqiptarët tepër i rëndë. Në këtë mijëvjeçar dy shekuj kanë qënë vazhdimisht tronditës për të: i pesëmbëdhjetë dhe i njëzetë. Në të pesëmbëdhjetin ata humbën lirinë, e rifituan, për ta humbur përsëri. E megjithatë, ata dolën nga ky shekull me një ngarkesë shpirtërore heroike që do t'i ushqente gjatë pesë shekujve pushtimi të Perandorisë Osmane. Në shekullin e njëzetë, historia e tyre ishte edhe më e trazuar dhe aspak fatlume. Janë të gjitha gjasat që mijëvjeçari i tretë, pavarësisht nga tronditja e sotme e Shqipërisë, të fillojë mbarë. I mbarë për ata që, ndonëse e kanë quajtur vetën «bij të shqipes», gjer më sot nuk janë ngjitur dot kurrë në lartësinë e dëshiruar, veç në ëndrat e tyre. E megjithatë, ndonëse krahët disa herë u janë thyer, ata ende vazhdojnë ta quajnë veten njëllor si më parë. Kjo këmbëngulje dëshmon, në fund të fundit, besnikëri ndaj kodit të moçëm dhe dëshirë për t'iu bindur urdhërit të tij. (f 41- 46)